
Zani i Naltë

Themeluar më 1923 - Viti II (XVI) - Nr. 6 (199) ISSN: 2305-655X

SHKËNCË ISLAME | SOCIOLOGJË | PSIKOLOGJË | LETËRSI | HISTORI | MORAL | LITERATURË KOMBËTARE



90 vjet
"Zani i Naltë"



NUMRI
ISSUE **6** 2014

Botues:
Komuniteti Mysliman i Shqipërisë

Zani i Naltë

Revistë shkencore dhe kulturore

VITI II (XVI) 2014 NR. 6 (159)

Merret me shkenca islame, sociologji, filozofi, psikologji,
histori, gjuhësi, letërsi, moral dhe literaturë kombëtare

www.zaninalte.al

Tiranë 2014

Revistë shkencore dhe kulturore

Zani i Naltë

Organ i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë

Themeluar në tetor 1923

Rifilluar në tetor 2012 VIII II (XVI), janar, shkurt, mars 2014, nr. 6 (159)

Nën kujdesin: H. Selim Muça

Drejtor & Kryeredaktor: Dok. Genti Kruja

Bordi editorial: Dok. Klodian Shehi
Dok. Skender Bruçaj
M.A. Ali Zaimi
Dr. Ferdinand Gjana
Prof. Dr. Qazim Qazimi
Prof. Dr. Ayhan Tekines
Prof. Dr. Njazi Kazazi
Prof. Dr. Hajri Shehu

Redaktor: M.A. Andrin Rasha

Fushat: Shkencat Islame

Tefsir
Hadith
Fikh
Sociologji
Filozofi
Gjuhësi
Letërsi
Psikologji
Histori
Kulturë
Art, etj.

Realizimi grafik: Bledar Xama
Shpëtim Bashmili

Fotoja në kopertinë: Xhamia Kubelije, Kavajë

Adresa: KMSH, Rr. George W. Bush, Nr. 50,
Tiranë - Shqipëri

e-mail: info@zanimalte.al

web: www.zanimalte.al



Përmbajtja

Editorial

1. Jetë të gjatë “Zanit të Naltë” - **Besnik Mustafaj**.....5

Shkenca Islame

2. Shkronjat e Kur’anit dhe shqiptimi i tyre - II
- **Elton Karaj, Universiteti Bedër, Tiranë**.....8
3. “Ne do të shpallim ty (Muhammed) fjalë të rëndë (të madhe)”
- **Prof. Dr. Ahmed Abbadi, Marok**.....16

Studime

4. Kontributi i ulemasë shqiptare në Maqedoni për shkollën dhe gjuhën shqipe - **Prof. Dr. Avzi Mustafa, Shkup, Maqedoni**.....22
5. Përdorimi i emrave myslimanë në Shqipëri, krahasim me tre periudha historike
- **Ilir Akshija, Spitali Universitar, Tiranë**.....32

Gjuhë-letërsi

6. Perjetësimi i Nezim Beratit mes divanit të tij shqip
- **Prof. Assoc. Dr. Rahim Ombashi - Universiteti Bedër, Tiranë**.....48
7. Said Najdeni dhe fillimet e arsimit shqip në Dibër
- **Dr. Mois Kamberi, Durrës**.....63
8. Kontributi i klerikëve shqiptarë për shkollën, gjuhën dhe shkrimin shqip
- **Xhemal Balla, Tiranë**.....72

Jurisprudencë Islame

9. Liria në sistemin politik të Islamit - **MA. Redi Shehu, Tiranë**.....78

Shkenca Komunikimi

10. Komunikimi përmes objekteve të kultit islam - II - **M.A. Ferit Lika**.....86

Personalitete

11. Daut Boriçi - Personalitet i shquar i historisë, kulturës dhe i arsimit shqiptar
- **Prof. dr. Njazi Kazazi, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër**.....96

Përkthime

12. Shpata Islame - Pse, a ende dyshoni se feja islame është përhapur me shpatë?!
Lexoni dhe do të dini të besoni!
- **Përktheu Prof. Dr. Hajri Shehu**.....102

Retrospektivë

13. “Zani i Naltë” – Revistë e orientimit drejt reformave dhe progresit shoqëror
- **Adem Bala**.....107

Aktivite

14. “Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar”
- **Prof. As. Dr. Gentiana Skura, Universiteti i Tiranës**.....110
15. Dy fjalë për një botim të veçantë shkencor -
- **Dr. Tonin Çobani, Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit, Tiranë**.....112

Abstracts

16. Abstracts in English.....114
17. Rregullat e shkrimit.....120

Jetë të gjatë “Zanit të Naltë”

Besnik Mustafaj

“Zani i Naltë”, revistë shkencore dhe kulturore, botim i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, mbushi në fund të kësaj vjeshte 90 vjet. Njësoj si 100-vjetori i “Hyllit të Dritës”, edhe ky 90-vjetor i “Zanit të Naltë” përbën një ngjarje të rëndësishme së veçantë për historinë dhe aktualitetin e kulturës dhe të mendimit shqiptar. Ashtu si “Hylli i Dritës” dhe si shumë gjëra të tjera të mira, të themeluara nga etërit e shqiptarizmit bashkë me pavarësimin e Shqipërisë për të shoqëruar e përkujdesur mëkëmbjen mendore dhe shpirtërore të kombit shqiptar, edhe “Zani i Naltë” pati tragjedinë e vet gjysmëshekullore për shkak të regjimit fashist e mandej atij komunist. Por nuk vdiq, siç nuk vdesin kurrë gjërat e mira e të ndershme, ku mishërohet ndërgjegjja dhe ëndrra për paqe dhe prosperitet e kombit. Qysh në lindjen e saj, kjo revistë u përcaktua si tribunë për “shkencën islame, sociologjinë, psikologjinë, letërsinë, historinë, moralin, literaturën kombëtare”. Me të njëjtin qëllim të lartë, besnikërisht, vjen edhe e rilindur. Ky është një lajm i gëzueshëm për të gjithë shqiptarët.

Rilindja e kësaj reviste shpreh pa dyshim një nevojë të kohës. Kurrë në historinë e botës sonë nuk është folur e shkruar kaq shumë për Islamin sa

sot. Fakt është se në këtë det fjalësh të thëna e të shtypura rreth Islamit, zërat e myslimanëve të vërtetë përbëjnë vetëm ca përrenj, të cilët më së shpeshti përmblyhen nga zallamahia pa u vënë re. Do pranuar se një vëmendje kaq e madhe dhe mbarëbotërore ndaj Islamit dëshmon rëndësinë e jashtëzakonshme që ka fituar qytetërimi islam në botën e sotme. Ama do pranuar po ashtu, sado që me keqardhje të thellë, se kjo vëmendje, në pjesën e vet mbisunduese, nuk ushqehet nga një kureshtje dhe dëshirë e ndershme për të kuptuar se ç’është qytetërimi islam, për të ndërtuar pastaj politika kulturore, sociale dhe ekonomike me bartësit e këtij qytetërimi, në interes të përbashkët të njerëzimit, apo për të ndërtuar marrëdhënie diplomatike dhe njerëzore miqësore. Është një pakicë, kam parasysh këtu pa dallim fundamentalistët kristianë dhe myslimanë, të cilët bërtasin aq shumë, sa jo rrallë arrijnë ta turbullojnë arsyen e shëndoshë të njerëzimit të sotëm. “Zani i Naltë” rikthehet për t’iu bashkuar arsyes së shëndoshë, e cila, edhe pse nuk bërtet, është e do të jetë në fjalë të fundit e pathyeshme, sepse ka me vete të vërtetën.

Rilindja e kësaj reviste, parë në qerthullin e familjes sonë shqiptare, tregon se Komuniteti Mysliman i

Shqipërisë ka tashmë brenda vetes forca intelektuale të bollshme dhe të devotshme si dhe me një nivel shumë të lartë dijesh për të ushqyer një revistë si kjo, ku jo vetëm paraqitet një informacion i pasur e i gjerë shkencor e kulturor, por edhe zhvillohet e do të zhvillohet më mirë në të ardhmen një debat i shëndetshëm idesh dhe pikëpamjesh mbi historinë, besimin, sociologjinë, psikologjinë, letërsinë, moralin dhe në përgjithësi mbi problematikat e mëdha me të cilat përballlet kombi. Pra, është një tregues i gëzueshëm për të gjithë shqiptarët fakti se Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka potenciale të tilla dijetarësh, të pjekur, të lidhur, ashtu si paraardhësit e tyre, me fatet e atdheut, të shkolluar mirë, me një mendje të hapur, intelektualisht të ndershëm dhe të gatshëm të shprehen përpara gjithë opinionit publik, duke bërë që “Zani i Naltë”, edhe pse botim me përkatësi ndaj Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, t’i drejtohet me trajtesat e veta krejt shoqërisë shqiptare dhe më gjerë.

Kjo revistë, jam i bindur, ashtu si në zanafillën e saj, do të shërbejë në radhë të parë për të rritur besimin e myslimanëve të sinqertë shqiptarë të feja e tyre e trashëguar tashmë prej brezash. Rritja e besimit të feja e tyre është një nga sfidat më të rëndësishme që ka përpara sigurisht Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, siç është kjo në përgjithësi një nga sfidat më të mprehta për mbarë botën e sotme myslimane. E tillë, kjo revistë nuk drejtohet kurrsesi kundër besimeve të tjera. Përkundrazi. Ashtu siç është në traditën e saj të pasur, kjo revistë vetëm do e pasurojë gjuhën e dialogut në emër të mirëkuptimit me të tjerët. “Zani i Naltë” do të vazhdojë

kështu të shërbejë për të treguar fytyrën e vërtetë të “Islamit shqiptar” si një Islam modern, si një Islam paqtues dhe integrues përkundër të gjitha përpjekjeve të islamofobëve, të cilët përpiqen verbërisht ta dezinformojnë opinionin publik, përpiqen ta diskreditojnë Islamin në përgjithësi dhe “Islamin shqiptar” në veçanti, pa marrë parasysh dëmet e mëdha që mund t’i shkaktojnë kohezionit të shoqërisë sonë. Islamofobët, veç të këqijave të tjera, ushqejnë drejtpërdrejt terrorizmin islamik. Kjo e vërtetë nuk duhet harruar kurrë. Si të tillë, islamofobët nuk janë vetëm armiq të myslimanëve të vërtetë. Ata janë mirëfilli armiq të njerëzimit.

Duke njohur trashëgiminë editoriale të kësaj reviste gjatë gjashtëmbëdhjetë viteve të jetës së saj para luftës, duke njohur frymën që zotëron në Komunitetin Mysliman Shqiptar në ditët tona, duke njohur personalitetin e drejtorit të saj të sotëm, Dr. Genti Kruja dhe të shumë autorëve që shkruajnë në të, mbetem i bindur se “Zani i Naltë” do të jetë një zë i fuqishëm dhe parimor në përballjen pa kompromis kundër islamofobisë dhe kundër të gjitha fobive të tjera, të cilat i fryjnë zjarrin të urrejtjes dhe synojnë të përçajnë njerëzimin për arsye të përkatësive të ndryshme fetare, etnike apo kulturore. “Zani i Naltë” ka pasur dhe do të ketë për mision mirëkuptimin në emër të jetesës së përbashkët në harmoni.

Në thelbin e vet “Zani i Naltë” u lind 90 vjet më parë si revistë thellësisht atdhetare. Ajo ka ndihmuar haptas në rrënjosjen e dashurisë për atdheun të shqiptarët në përgjithësi, të myslimanët në veçanti, si rruga e vetme për formësimin e vetëdijes dhe të

identitetit kombëtar. Është me vlerë ta kujtojmë këtë gjen të “Zanit të Naltë”, sidomos në kohën që jetojmë, një kohë e keqkuptimeve të mëdha identitare, kur atdheu jo gjithmonë ka vendin që do të duhej të kishte në mendjen dhe në zemrën e njeriut. Besimi i myslimanit shqiptar te Libri i Shenjtë nuk është nxjerrje në harresë e as nënvleftësim i shenjtërisë së atdheut. Përkundrazi, është rivlerësim i tij. Le të kujtojmë plot nderim me këtë rast amanetin e Hafiz Ali Korçës: “Zot të na rrojë atdheu e kombësija / aqë sa të na rrojë edhe gjithçka”. Ky është mësimi i madh që vjen nga themeluesit e “Zanit të Naltë” nëntë dekada më parë për ta vazhduar si trashëgimi të patjetërsueshme ata që e bëjnë sot revistën, me qëllimin për ta shndërruar këtë tribunë para së gjithash në një burim vital të energjisë së atdhedashurisë. Pjesë jetike e dashurisë së shqiptarit për vendin e vet sot është ëndrra e tij evropiane. Rilindja e “Zanit të Naltë” i ka rrënjët te brohoritma e studentëve të ngritur kundër diktaturës në dhjetor 1990: “E duam Shqipërinë si gjithë Europa”. “Zani i Naltë” do të dijë t’i shërbejë kësaj aspirate madhështore të rinisë shqiptare.

Nisur sa nga trashëgimia e saj, aq edhe nga mendësia e atyre që përkuajdesen sot për të, unë jam i bindur se kjo revistë do të shërbejë fuqimisht për të vendosur mbi një bazë edhe më të strukturuar e më intelektuale dialogun e Islamit me besimet e tjera, në emër të interesave të përbashkëta, që janë kohezioni i shoqërisë shqiptare dhe uniteti kombëtar. Në qoftë se kjo do të bëhej një revistë për të ushqyer komunitarizmin, apo edhe më keq, një revistë sektare, atëherë nuk do të kishte vlerë, madje do të bëhej

e dëmshme më së pari për myslimanët e mandej për të gjithë shqiptarët. Por “Zani i Naltë” rilindi si një revistë pikërisht në këtë qëllim, për t’i shërbyer hapjes së mendimit të “Islamit shqiptar” dhe të Islamit universal sigurisht, sepse “Islami shqiptar” nuk është jashtë Islamit universal. Dialogun me të tjerët, në emër të interesave të përbashkëta për të bashkëjetuar në paqe e në harmoni, duke sqaruar si keqkuptimet ashtu edhe provokimet, e ushqen vetë Kur’anin. Ata që rreken të thonë që Islami shqiptar, kaq i hapur dhe mirëkuptues ndaj besimeve të tjera, është një përjashtim nga fryma e Kur’anit, ose nuk e njohin Kur’anin, ose nxiten nga prapamendime të mbrapshta. Islami shqiptar është plotësisht në frymën e Kur’anit. Dhe këtu buron fuqia e tij.

Kjo revistë do të thellojë e pasurojë dimensionin e vet ekumenik, që do të thotë se do të thithë në faqet e veta pa komplekse përjashtuese sigurisht mendimin e njerëzve më të shquar shqiptarë të kohës dhe të traditës, por edhe të mbarë botës, që nuk janë myslimanë doemos. Pra, duke qenë një revistë ndershmerisht ekumenike, ajo do të zgjerojë pareshtur horizontin e vet si tribunë intelektuale mbarëkombëtare dhe universale, por edhe do të justifikojë më mirë përcaktimin që ka qysh në origjinën e saj si një revistë shkencore dhe kulturore. E shpalosur si një revistë thelbësisht ekumenike, ashtu siç është ekumenike vetë jeta e shqiptarit sot dhe në traditë, me informacionet, idetë dhe analizat e veta “Zani i Naltë” do të përbëjë në vazhdimësi dhe në rritje një kontribut origjinal e shumë të çmuar për kulturën shqiptare, por edhe për kulturën e njerëzimit në përgjithësi.



SHKRONJAT E KUR'ANIT DHE SHQIPTIMI I TYRE – II

MA. Elton Karaj
Universiteti Bedër
Departamenti i Shkencave Islame

Abstrakt

Texhvidi është shkencë që trajton dhe analizon në thellësi leximin e germave të Librit të Shenjtë, Kur'anit. Ajo është një nga shkencat më të trajtuara dhe analizuar thellë e më thellë ndër shekuj, për shkak të rëndësisë që ka. Leximi i Kur'anit është një nga kushtet e adhurimit thelbësor të myslimanit dhe për më tepër ai është një adhurim më vete. Nga ky këndvështrim besimtarët kanë treguar kujdes të madh në studimin teorik dhe praktikimin e njohurive që na ofron shkencë e texhvidit.

i. Veçoritë që nuk kanë të kundërt

Shkronjat kanë edhe disa veçori të tjera, për të cilat nuk mund të mendohet e kundërta. Nuk kanë një antonim. Këto veçori i përkasin vetëm disa shkronjave. Ato janë si në vijim:

1) Safir – الصَّفِيرُ

Safir do të thotë “të fërshëllesh, të mbulosh, të thërrasësh kafshën drejt ujit, etj”.¹ Në texhvid, safiri është shqiptimi i shkronjës me zë të mprehtë ose si zëri i gjarprit. Shkronjat që kanë këtë veçori janë: (3 shkronja) ز س ص

Kjo veçori tregon fortësinë e zërit të këtyre shkronjave. Ndër to shkronja më e fortë është sad-i (ص), pastaj ze-ja (ز) dhe në fund sin-i (س).

1. Temel, *po aty*, fq. 116.

Nëse nuk do të ishte veçoria safir, mahrexhi i shkronjës sin (س) do të ngatërrohej me atë të shkronjës the (ث) dhe mahrexhi i shkronjës ze (ز) me atë të dhe-së (ذ).²

Ndryshe quhen el-hurufu el-eslije (الْحُرُوفُ الْأَسْلِيَّةُ), d.m.th, shkronjat e majës së gjuhës.³

2) Tefeshshi – التَّفَشِّي

Tefeshshi në leksik do të thotë “zgjerim, përhapje dhe shpërndarje”.⁴ Është veçoria e shkronjës shin (ش), zëri i së cilës shpërndahet në brendësi të gojës. Nëse këtë shkronjë e lexojmë

2. Abdulhamid, *po aty*, fq. 91.

3. Temel, *po aty*, fq. 64. Shih: Ibn el-Xhezeri, *en-Neshr*, I, 198.

4. Temel, *po aty*, fq. 131.

duke e nxjerrë zërin e saj midis gjuhës dhe qiellzës, ajo del më qartë dhe më saktë. (1 shkronjë)

Gradët e veçorisë tefesh-shi

Gradat e veçorisë tefeshshi janë tri si më poshtë:

1 - Ajo është më e theksuar kur shin-i (ش) është me shedde si ، الشَّيْطَانِ ، الشَّاكِرِينَ.

2 - Është mesatarisht e theksuar kur shin-i është me sukun si ، الشُّدُّ ، الشُّرَى .

3 - Më pak e theksuar kur shin-i është i shoqëruar me hareke si ، يَعْشَى ، شَهَادَةً ، شَيْئًا⁵.

3) Istitale – الْأَسْطَلَّةُ

Istitale do të thotë “të zgjasësh”. Në terminologji është një nga veçoritë e shkronjës dad (ض), zëri i së cilës zgjatet për gjatë gjithë mahrexhit. Qëllimi kryesor i kësaj veçorie është që shkronja dad (ض) të mos shqiptohet as nga mahrexhi i shkronjës ta (ط) dhe as nga ai i shkronjës dha (ظ).

Istitale është zgjatja e anësore së gjuhës nga fillimi i kësaj anësoreje deri në mahrexhin e lam-it (ل)⁶. (një shkronjë)

4) Inhiraf – الْإِنْجِرَافُ

Inhiraf në leksik do të thotë “devijim në një drejtim të caktuar”. Në terminologji, është veçoria e shkronjave lam (ل) dhe rra (ر), gjatë leximit të së cilave maja e gjuhës dhe pjesët anësore të saj prekin qiellzën. Kjo veçori ndodhet midis shiddetit dhe rihuetit⁷, megjithatë ajo dallohet më qartë kur shkronjat i lexojmë të forta. (2 shkronja)

5) Tekrir – التَّكْرِيرُ

Kuptimi i fjalës tekrire është “të

kthesh mbrapsht diçka një ose më shumë herë”. Në terminologji, është dridhja e gjuhës duke u mbështetur fort në qiellzë gjatë shqiptimit të shkronjës rra (ر). Tekriri është një veçori e pandarë e kësaj shkronje.⁸ D.m.th, duhet të zbatohet qoftë kur lexohet e butë, qoftë kur lexohet e fortë.⁹

Mungesa e tekririt bën që shkronja rra (ر) të shqiptohet si “rë”-ja e alfabetit të gjuhës shqipe dhe e kundërta, d.m.th, ekzagjerimi në tekrire duke zgjeruar hapësirën midis majës së gjuhës dhe qiellzës nxjerr në pah shkronjën “rre” të alfabetit shqip.

6) Kalkale – الْكَلَالَةُ

Fjala kalkale në leksik do të thotë “të gjallërohesh, të lëvizësh, të thërrasësh”.¹⁰ Në texhvid, kalkaleja është veçoria e shkronjave, të cilat kur i lexojmë me sukun, mahrexhi i tyre nuk mbahet i fiksuar, por luhet pak nga vëndi i tij përkatës. Shkronjat e kalkalesë janë:

ك ب ج د ط ق (pesë shkronja) فَطْبُ جَدٍ : ب ج د ط ق

Këtë veçori e kanë vetëm këto shkronja, kështu që kur shkronjat e tjera janë me sukun, mahrexhi i tyre nuk luhet dhe as nuk lexohen sikur të kenë hareke.

Gradat e kalkalesë

Autori i Tejsirit e ndan kalkalenë në tri grada në bazë të theksimit të saj:

1 – Kalkaleja më e fortë: Në rast se kalkaleja do të realizohet në një shkronjë me shedde, si أَشَقُّ ، الْحَجُّ ، الْحَقُّ ، etj. Këtu kjo veçori realizohet duke e mbërthyer

8. Temel, *po aty*, fq. 132.

9. Për më tepër informacion rreth fortësisë dhe butësisë së shkronjës rra ju këshillojmë të shfletoni një libër texhvidi ku zakonisht mund të gjeni një kapitull enkas për leximin e kësaj shkronje.

10. Temel, *po aty*, fq. 83.

5. Abdulhamid, *po aty*, fq. 93.

6. Abdulhamid, *po aty*, fq. 95.

7. Temel, *po aty*, fq. 75-76.

zërin në krye gjatë sheddës dhe duke e liruuar atë më pas me karakteristikën e kalkalesë.

2 – *Kalkale e fortë*: Në rast se shkronja e kalkalesë ndodhet pa shedde në fund të fjalës në të cilën ndalojmë, si *الْفَلَقُ*, *لَمْ يَلِدْ*, etj.

3 – *Kalkale e butë*: Në rast se shkronja e kalkalesë ndodhet e shoqëruar me sukun në një vend ku nuk bëjmë ndalesë, qoftë kjo mes të fjalës, apo në fund të fjalës, si *أَفْتَطَمُونَ*, *قَدْ سَمِعَ* etj.¹¹

7) *Gunne – الْغُنَّةُ*

Gunne do të thotë “zë i pëllumbit dhe kumrisë”. Është zëri që del nga pjesa ku lidhet hunda me gojën.¹² Kjo veçori e shkronjave nun (ن) dhe mim (م) dallohet në disa raste të veçanta. Prandaj, gunne është emërtuar edhe si “nun (ن) i butë”.¹³ Gunne zbatohet gjithmonë në shkronjat mim dhe nun, dhe në raste të caktuara në uau dhe je. Zëri i gunnes zgjatet 1-1,5 elf, ose 2 hareke. (2+2 *shkronja*)

Gradat e gunnes

Gunnen mund ta klasifikojmë në pesë grada:

1 – *Më e plota*: Në rast se vjen nun-i ose mim-i me shedde, si *أَنَّ*, *أُمَّ*.

2 – *E plota*: Në rast se vjen idgam meal gunne në shkronjat uau (و) dhe je (ي), si *مِنْ وَالٍ*, *مَنْ يَعْمَلُ*.

3 – *E pakët*: Në rast të ihfasë së nun-it (ن), ihfasë së mim-it (م) dhe iklabit, si *مِنْ سَيِّءٍ*, *فَأَهْلَكْنَاهُمْ بِذُنُوبِهِمْ*, *مِنْ بَعْدٍ*.

4 – *E mangët*: Në rast se nun-i (ن) ose mim-i (م) janë të shoqëruara me sukun, si *مِنْ عَلٍ*, *أَنْعَمْتَ*.

5 – *Më e mangëta*: Në rast se nun-i

(ن) ose mim-i (م) janë të shoqëruara me hareke pa shedde, si *تَلُّوْا*.¹⁴

a) **Veçoritë sipas fortësisë**

Veçoritë absolute që u trajtuan më sipër mund të ndahen në dy grupe për nga këndvështrimi i fortësisë së tyre:

1 – Veçoritë e buta: Xhehr, shiddet, isti’la, itbak, ismat, hafij, safir, gunne, tefeshshi,

2 – Veçoritë e forta: Hems, rihuet, istifal, infitah, idhlak, dhuhur, kalkale, istitale.

Këtu arritëm në fundin e veçorive të shkronjave të gjuhës arabe. Si përfundim duhet të theksojmë se në të njëjtën shkronjë mund të ketë tipare të forta ose të buta. Sa më shumë veçori të forta të ketë shkronja, aq më e fortë është edhe vetë ajo në shqiptim. E njëjta gjë është e vlefshme edhe për të kundërtën. Sa më tepër tipare të buta të ketë shkronja, aq më e butë është edhe vetë ajo në shqiptim. Kjo është e kuptueshme, por ka rëndësi të theksohet, në mënyrë që t’i njohim sa më mirë shkronjat.

3. Shkronjat dhe veçoritë e tyre përkatëse

Çdo shkronjë ka veçoritë e saj, me anë të të cilave ne arrijmë që ta dallojmë atë dhe të kuptojmë mënyrën se si ajo shqiptohet. Këto janë paraqitur në listën e mëposhtme.

ء: Shiddet, xhehr, istifâl, ismât, infitâh.

ب: Kalkale, shiddet, xhehr, istifâl, idhlâk, infitâh.

ت: Shiddet, hems, istifâl, ismât, infitâh.

ث: Ismât, hems, rihuet, istifâl, infitâh.

11. Abdulhamid, *po aty*, fq. 99.

12. Shih mahrexhin “hajshum”.

13. Temel, *po aty*, fq. 53.

14. Abdulhamid, *po aty*, fq. 110-111.

ج: Kalkale, shiddet, xhehr, ismât, istifâl, infitâh.

ح: Ismât, hems, rihuet, istifâl, infitâh.

خ: Isti'la, ismât, hems, rihuet, infitâh.

د: Kalkale, shiddet, xhehr, ismât, istifâl, infitâh.

ذ: Xhehr, ismât, rihuet, istifâl, infitâh.

ر: Xhehr, tekrrir, bejnijje, isti'lâ (istifâl), idhlâk, infitâh.

ز: Xhehr, safir, ismât, rihuet, istifâl, infitâh.

س: Safir, ismât, hems, rihuet, istifâl, infitâh.

ش: Tefeshshî, ismât, hems, rihuet, istifâl, infitâh.

ص: Itbâk, isti'lâ, safir, ismât, hems, rihuet.

ض: Xhehr, itbâk, isti'lâ, istitâle, ismât, rihuet¹⁵.

ط: Kalkale, shiddet, xhehr, itbâk, isti'lâ, ismât.

ظ: Xhehr, itbâk, isti'lâ, ismât, rihuet.

ع: Xhehr, bejnijje, ismât, istifâl, infitâh.

غ: Isti'la, ismât, xhehr, rihuet, infitâh.

ف: Hems, rihuet, istifâl, idhlâk, infitâh.

ق: Kalkale, shiddet, xhehr, isti'lâ, ismât, infitâh.

15. Shohim që shkronja dad (ض) ka veçorinë e rihuetit e cila do të thoshte që kur e lexojmë shkronjën mesukûn na rrjedh zëri. Ndryshe nga praktikimi i shumicës së lexuesve të Kur'anit të cilët e lexojnë këtë shkronjë me veçorinë shiddet e cila është e kundërta e rihuetit. Duhet patur kujdes me leximin e kësaj shkronje sepse është theksuar edhe si *es'abu'l-hurûf* (shkronja më e vështirë në shqiptim). Për më shumë informacion shikoni: el-Hamed, Ganim Kadduri, Dr., *Ebhâth fi ilmi'l-Texhvid*, Dar Ammar, Umman 2002, fq. 146-166.

ك: Shiddet, ismât, hems, istifâl, infitâh.

ل: Xhehr, bejnijje, istifâl, idhlâk, infitâh.

م: Xhehr, gunne, bejnijje, istifâl, idhlâk, infitâh.

ن: Xhehr, gunne, bejnijje, istifâl, idhlâk, infitâh.

ه: Hems, rihuet, istifâl, ismât, infitâh.

و: Xhehr, rihuet, istifâl, idhlâk, infitâh.

ي: Xhehr, ismât, rihuet, istifâl, infitâh.

Në bazë të këtyre veçorive dijetarët kanë formuluar një poemë ku përmendet radhitja e shkronjave sipas fortësisë:

أقوى الحروف الطَّاءُ وضادُّ مجمَعَه... والظَّاءُ ثم القافُ وهَي الخائِمَه
قويُّها جيمٌ و دالٌّ ثم رَا... صادُّ وزايٌّ ثم غَيْنٌ قَرَّرا
وأوسطُ همزٍ وباءٌ تا أَلِفٌ... خاءٌ وذالٌّ عَيْنٌ كافٌ ثم قَفْ
وأضعفُ الحروفِ ناءٌ حاءٌ... والثَّوْنُ والميمُ وفاءٌ هاءٌ
ضَعِيفُها سينٌ وشينٌ لَامٌ... والواوُ والياءُ هَي الخِتَامُ

“Më e forta e shkronjave është ta-ja, dad-i, dha-ja, pastaj kaf-i si përfundim,

Të fortat janë xhim-i, del-i, pastaj rra-ja, sad-i dhe ze-ja, më pas gajn-i në përfundim,

Të mesmet janë hemze-ja dhe be-ja, te-ja, elif-i, ha-ja (ح) dhe dhel-i, ajn-i, kef-i dhe ndalo,

Dhe shkronjat më të dobëta (buta) the-ja, ha-ja (ح) dhe nun-i e mim-i, fe-ja be-ja,


Të dobëtat sin-i e shin-i, lam-i, uau-i dhe si përfundim je-ja.”¹⁶

Pra radhitja e shkronjave nga më e forta tek më e buta (nga djathtas majtas) është kështu:

ط ض ظ ق ج د ر ص ز غ ء ب ت ا خ
ذ ع ك س ش ل و ي ث ح ن م ف ه

16. Muhammed Mekki, *po aty*, fq. 63.

4. Skema e veçorive absolute



SHQIPTIMI I SHKRONJAVE

Për shkak se të gjitha shkronjat e alfabetit arab janë bashkëtingëllore, shqiptimi i tyre realizohet me shoqërimin e një nga zanoreve fet’ha, damme dhe kesra, ose me sukun. Megjithatë shqiptimi më i saktë i tyre dallohet gjatë leximit me sukun.

Këtu ne do të trajtojmë shkurtimisht leximin e shkronjave të shoqëruara me zanore ose sukun.

1. Hareketë (Zanoret) - الحركات

Në çdo gjuhë leximin e shkronjave bashkëtingëllore e bëjnë të mundur zanoret. Vetëm se në gjuhën arabe, ndryshe nga gjuhët e tjera, zanoret nuk shkruhen si

shkronja por tregohen me tre shenja. Ato janë fet'ha, kesra dhe damme.

Ahmed b. Et-Tibi:

وَكُلُّ مَضْمُومٍ فَلَنْ يَتَمَّ... إِلَّا بِضَمِّ الشَّفَتَيْنِ ضَمًّا وَذُو
 انْخِفَاضٍ بِانْخِفَاضٍ لِلْفَمِّ... يَتَمُّ وَالْمَفْتُوحُ بِالْفَتْحِ أَفْهَمُ
 إِذِ الحُرُوفِ إِنْ تَكُنْ مُحَرَّكَةً... يَشْرِكُهَا مَخْرَجُ أَصْلِ الحَرَكَةِ
 أَي مَخْرَجُ الوَاوِ وَمَخْرَجُ الأَلِفِ... وَالبَاءُ فِي مَخْرَجِهَا الَّذِي عُرِفَ
 فَإِنْ تَرَى القَارِئَ لَنْ تَنْطَلِقَا... شِفَاهُهُ بِالصَّمِّ كُنْ مُحَقِّقًا
 بِأَنَّهُ مُتَقِصٌّ مَا ضَمًّا... وَالوَاجِبُ النُّطْقُ بِهِ مُتَمًّا
 كَذَلِكَ ذُو فَتْحٍ وَذُو كَسْرٍ يَجِبُ... إِتْمَامُ كُلِّ مِنْهُمَا أَفْهَمُهُ نُصِبَ

Përkthimi:

Çdo shkronjë e shoqëruar me damme nuk plotësohet, vetëm se duke i mbledhur dhe zgjatur tërësisht përpara buzët,

Gjithashtu (kesra) realizohet duke drejtuar zërin për poshtë dhe fet'ha duke hapur gojën,

Kur shkronjat janë me zanore, i shoqëron ato mahrexhi origjinal i harekeve,

Dmth, mahrexhi i nau-it, elif-it dhe je-së ; në mahrexhet e tyre që dimë,

Nëse shëh lexuesin të mos i zbatojë këto duke mos i mbledhur dhe zgjatur buzët në damme, atëherë tregohu i përpiktë,

Sepse ai e ka lexuar të mangët dammen, kurse detyra e tij është t'i shqiptojë me përkishmëri,

E njëjta gjë vlen edhe për fet'han dhe kesran. Kupto, që të veprosh drejtë!¹⁷

1) *Fet'ha* – اَلْفَتْحَةُ: është një vijë e pjerrët që vendoset mbi shkronjë: _____ . Më parë shkronjat i ndamë në të buta dhe të forta. Sipas kësaj, zëri i zanores fet'ha që ndodhet mbi shkronjat e buta shqiptohet midis “e”-së dhe “a”-së; kurse kur ndodhet mbi shkronjat e forta zëri i saj është si një “a” e qartë.

Në fakt, kjo zanore është forma

17. et-Tibi, *po aty*, fq. 9.

e shkurtër e shkronjës elif, e cila është shkronjë zgjatëse. Për këtë arsye, siç mund të shikojmë edhe më sipër, Imam Ahmed et-Tibi thotë që origjinali i zanoreve janë format e tyre zgjatëse Atëherë, origjinali i zanores fet'ha është elifi, ai i zanores kesra është shkronja je (ي) dhe origjinali i zanores damme është shkronja uau (و).

Është quajtur fet'ha, e cila do të thotë hapje, sepse gjatë shqiptimit të kësaj zanoreje hapet goja e njeriut.

2) *Kesra* – اَلْكَسْرَةُ: është një vijë e pjerrët që vendoset nën shkronjë: _____ . Zëri i zanores kesra është si një “i” e qartë dhe nuk ka dallim se nën cilën shkronjë vendoset.

3) *Damme* – اَلضَّمَّةُ: është një formë tjetër e ngjashme me shkronjën uau (و) që vendoset mbi shkronjë: _____ . Zëri i zanores damme është si një “u” e qartë dhe nuk ka dallim se mbi cilën shkronjë vendoset.

Është quajtur damme, e cila do të thotë mbledhje, sepse gjatë shqiptimit të saj duhen mbledhur dhe zgjatur buzët përpara. Edhe damme është forma e shkurtër e shkronjës uau. Për këtë arsye edhe Imam et-Tibi tërheq vëmendjen duke theksuar se shkronja uau dhe zanorja damme shqiptohet vetëm duke i mbledhur e njëkohësisht duke i zgjatur përpara buzët.

Ahmed et-Tibi:

وَعِنْدَ نُطْقِ الحَرَكَاتِ فَاحْذَرَا... نَقْصًا أَوْ اشْبَاعًا أَوْ أَنْ تُعْمِرًا
 يَمْزِجُ بَعْضُهَا بِصَوْتِ بَعْضٍ... أَوْ يَسْكُونُ فَهُوَ غَيْرُ مَرَضِي

Përkthimi:

Gjatë shqiptimit të zanoreve ka kujdes, se mos e shkurton, ose e zgjat tepër ose e ndërron, Duke ngatërruar zërat me njëri-tjetrin

ose me sukunin. Gjë që është e papranueshme¹⁸

Një nga gabimet që mund të bëjë lexuesi i Kur'anit është të zgjasë ose shkurtojë zërin e zanores. Ky është një gabim që bëhet zakonisht në leximet e shpejta ose në ato tepër të ngadalta. Aq sa ndonjëherë duket sikur shkronjën me zanore e lexon me sukun, ose e kundërta, sikur të jetë e shoqëruar me shkronjë zgjatëse. Këto janë gabime prej të cilave duhet të ruhet çdo lexues.

2. Sukûn - السُّكُونُ

Sukuni (سُ) ka formën e një rrethi të vogël dhe shkronja, mbi të cilën vendoset, lexohet e pashoqëruar me asnjë zanore. Pra lexohet vetëm zëri i bashkëtingëllores. P.sh: وَالْفَجْرُ (uel'fexhr).

Ahmed et-Tibi:

وَحَقَّقِ السُّكُونَ فِيمَا سَكْنَا ... وَلَا تُحَرِّكْهُ كَ: أَنْعَمْتَ اهْدَنَا
وَهَكَذَا: الْمَغْضُوبَ مَعَ ظَلَلْنَا ... وَنَحْوِهِ، وَاللَّامَ أَظْهَرْنَا

Përkthimi:

*Tregohu i përpiktë në leximin me sukun dhe mos e lexo sikur të jetë me hareke si أَنْعَمْتَ اهْدَنَا*¹⁹

ashtu është edhe ظَلَلْنَا الْمَغْضُوبِ me *etj*, dhe lam-in shqiptoje me idh'har²⁰

Shënim: Shkronjat e gjuhës arabe janë të shoqëruara edhe me shedde ose tenvin, por këto tema e kalojnë kufirin e këtij artikulli, për këtë arsye nuk janë trajtuar këtu. Për më tepër informacion mund të shfletohet një libër texhvidi ku mund të gjenden detaje edhe në lidhje me sheden dhe tenvinin.

18. et-Tibi, *po aty*, fq. 8.

19. et-Tibi, *po aty*, fq. 9.

20. Dmth, lam-i duhet shqiptuar nga mahrexhi i saj origjinal, pa ndikimin e asgjëje tjetër.

3. Shedde - الشَّدَّةُ

Shedde bën të mundur që një shkronjë të mos lexohet njëshe por dyshe (dopjo). Kjo veti nuk ndodhet në gjuhën shqipe për këtë arsye duhet të kemi kujdes në shqiptim e saj në mënyrë të drejtë. Për të qenë më të saktë duhet që këtë mënyrë të lexuari ta dëgjojmë nga një mësues i Kur'anit. Shedde vendoset mbi shkronjë: (سُ). Gjatë leximit me shedde duhen pasur parasysh disa pika.

Në uakf, d.m.th, në rast ndalese:

i. Nëse shkronja në të cilën ne ndalojmë leximin tonë është me shedde atëherë duhet ta theksojmë këtë veçori.

ii. Nëse shkronja në të cilën ndalojmë leximin është një prej pesë shkronjave të kalkalesë dhe vjen me shedde, duhet theksuar edhe shedde edhe kalkaleja.

P.sh: وَتَبَّ < وَتَبَّ

iii. Nëse shkronjat në të cilat ne ndalojmë janë nun (ن) ose mim (م) atëherë duhet theksuar veçoria e tyre gunne.

P.sh: فِي النَّيْمِ < فِي النَّيْمِ

مِنْهُنَّ < مِنْهُنَّ

iv. Duhet pasur më shumë kujdes nëse shkronja me shedde në të cilën ndalojmë leximin tonë është ajn (ع) ose dad (ض).

4. Shkronjat zgjatëse - الْمُدَوِّدُ

Shkronjat zgjatëse në alfabetin e gjuhës arabe janë tre: elif (ا), uau (و) dhe je (ي). Secila prej këtyre shkronjave zgjat zërin e zanoreve të tyre përkatëse: elif për zanoren fet'ha, uau për zanoren damme dhe je për zanoren kesra.

Këto shkronja nuk e ndryshojnë absolutisht zërin e harekeve, vetëm sa e

zgjasin atë. P.sh: صَا (sâ), صِي (sî) dhe صُو (sû), etj.

Në këtë çështje ka vetëm një përjashtim sipas së cilës zërin e fet'has ndonjëherë e zgjat shkronja je (ي), gjë që ndodh për shkak të rregullave të gjuhës arabe. Kjo je quhet elif maksure dhe zëri i fet'has nuk pëson asnjë ndryshim. Thjesht në vend të shkronjës elif është vendosur shkronja je (ي).

PËRFUNDIM

Në këtë artikull, trajtuam në një formë, deri diku, të detajuar shqiptimin e shkronjave të gjuhës së Kur'anit dhe tiparet e tyre, të cilat na i kanë diktuar dijetarët e texhvidit dhe kiraetit. Rëndësia e temave në fjalë është e padiskutueshme. Teoria në lidhje me diçka që duhet patjetër praktikuar nuk të zgjidh çdo këndvështrim të saj, por tradita jonë na ka treguar që pa teori dija nuk mund të ruhet. Megjithatë, në rastin tonë teoria është gjysma e punës dhe praktika gjysma tjetër.

Në ditët e sotme, ashtu siç ka qenë ndër shekuj, ana e praktikës dhe e transmetimit vetëm gojarisht të germave arabe mbizotëron. Kjo ka bërë që për shkak të dallimeve krahinore, të kemi edhe dallime, sado të vogla, por të rëndësishme, në shqiptimin e shkronjave të Kur'anit. Madje ndonjëherë përballemi edhe me dallime në rregullat e texhvidit. Besojmë, që nga punimi ynë kuptohet qartë, që analizimi në detaje i veprave themelore të hershme, duke i bashkangjitur atyre edhe ato të vonshmet, do të nxjerrë në dritë të saktën pa kurrfarë dyshimi apo dallimi. Dhe më e rëndësishmja, do na pasurojë e korrigjojë në leximin e saktë të Kur'anit Famëlartë.

Shënim: Duhet të bëjmë një korrigjim në përkufizimin e mahrexhit të shkronjës dad (ض). Forma e saktë është si më poshtë:

“Duke prekur me pjesën anësore të gjuhës dhëmbët që nisin pas dhëmbëve të syrit në anën e djathtë ose të majtë, do të shqiptojmë shkronjën *dâd* (ض). Ajo mund të shqiptohet duke përdorur anën e djathtë ose të majtë, ose të dyja njëherësh, por më e përdorura është ana e majtë për shkak se është edhe më e thjeshtë.”

Bibliografi

Abdulhamid, Suad, *Tejsir er-Rabman fi Texhvid el-Kur'an*, t'hk: Ahmed Ahmed Mustafa Ebu Hasen dhe Mahmud Emin Tantau, Dar et-Takua, Kajro 2009.

et-Tîbî, Shihabuddin Ahmed b. Ahmed,, *Mandhume el-Mufid fi Ilm et-Texhvid*, t'hk: Ejmen Rushdi Suvejd

el-Hamed, Ganim Kadduri, Dr., *Ebbâth fi ilmi't-Texhvid*, Dar Ammar, Umman 2002.

Ibn el-Xhezeri, Shemsuddin Muhammed b. Muhammed b. Jusuf, *el-Mukaddime el-Xhezzerijje*, Dar el-Mugni 2001.

-----, *en-Nesbr fi el-Kiraet el-Asbr*, t'hk: Ali Muhammed ed-Debba', Dar el-Kutub el-Ilmijje, I-II, Bejrut (pa datë).

-----, *et-Temhid fi Ilm et-Texhvid*, Mektebe el-Mearif, Rijad 1985.

Ebu el-Uefa, Alijullah b. Ali, *el-Kaul es-Sedid fi Ilm et-Texhvid*, Dar el-Uefa, Mansura 2003.

Abdussemi' esh-Shafii, Ahmed Mahmud, *el-Uafi ti Kejjfjeti Tertil ekl-Kur'an el-Kerim*, Dar el-Kutub el-Ilmijje, Bejrut 2000.

el-Hamed, Ganim Kadduri, Dr., *Ebbâth fi ilmi't-Texhvid*, Dar Ammar, Umman 2002.

Tuğral, Rahim, *Ana Hatlaryla Kur'an Tecvidi*, İlahiyat Fakültesi Vakfi Yayınları, Izmir 2001.

Temel, Nihat, *Kiraat ve Tecvid Istılabları*, İFAV yay., Botimi 2, Stamboll 2009.

“Ne do të shpallim ty (Muhammed) fjalë të rëndë (të madhe)”

Prof. Dr. Ahmed Abbadi

President i Ligës Muhamedane të Dijetarëve, Marok

Abstrakt

Ajeti: ﴿إِنَّا سَنُلْقِي عَلَيْكَ قَوْلًا ثَقِيلًا﴾ “Ne do të shpallim Ty (Muhammed) fjalë të rëndë (të madhe)”, përmban një koncept të rëndësishëm, që është koncepti i vënies, vendosjes (shpalljes)...

I zbriti të Dërguarit të Allahut, që ai t`ua komunikojë, interpretojë njerëzve të tjerë. Me kalimin e fjalës me peshë (të rëndë) tek Profeti i nderuar a.s. deri në botët e tjera dhe me kalimin e fjalës me peshë nga vetë Profeti a.s., e cila i jepte vuajtje mbi vuajtje, me zbritjen e kësaj fjale të rëndë, të cilën Ai e zbriti me ndihmën e Allahut. Kështu kemi arritur te përcaktimet tona multidimensionale, me shembuj të shumtë, duke qenë të aftë për ta pranuar dhe dëgjuar edhe nga qartësia e fortë e barrës së fjalës peshë në personalitetin e Profetit të nderuar.

Kjo është një dëshmi prej dëshmimeve të Kur’anit Famëlartë, që dëshmon se njeriu është me vlerë dhe peshë me këtë fjalë të shpallur nga Allahu (xh.sh.):

﴿إِنَّا سَنُلْقِي عَلَيْكَ قَوْلًا ثَقِيلًا﴾

“Ne do të shpallim Ty (Muhammed) fjalë të rëndë (të madhe)”.¹

Ky ajet përmban një koncept të rëndësishëm, që është koncepti i vënies, vendosjes (shpalljes) dhe vënia në Kur’anin Famëlartë, shfaqet me pikëpamjen e zbulimit (stolisë), duke u bazuar në ajetin Kur’anor:

﴿فَلَوْلَا أَلْقَىٰ عَلَيْهِ آسُورَةٌ مِّنْ ذَهَبٍ أَوْ جَاءَ مَعَهُ الْمَلَائِكَةُ مُقْتَرِينَ﴾

“Përse nuk i janë vënë atij byzzylykë nga ari, ose të kenë ardhur me të engjëjt shoqërues?”² “Esavire” do të thotë stoli. Siç e dimë përdoret për zbulim, duke argumentuar me fjalët e Allahut (xh.sh.) kur thotë:

﴿يُحِلُّونَ فِيهَا مِنْ أَنَاوِرٍ مِّنْ ذَهَبٍ وَأُلُوفًا وَيَنَاسُهُمْ فِيهَا حَرِيرٌ﴾

“...aty stolisen ata me rrahë të artë e me xhevahire, e petkat e tyre janë të mëndafshhta”.³

Po ashtu fjala “Ilka” vjen në kuptimin e hedhjes, Allahu (xh.sh.) në Kur’anin Famëlartë thotë:

﴿وَأَوْحَيْنَا إِلَىٰ مُوسَىٰ أَنْ أَلْقِ عَصَاكَ فَإِذَا هِيَ تَلْقَفُ مَا يَأْفِكُونَ﴾

2. Ez-Zuhruf: 53.

3. El-Haxh: 23.

1. El-Muzemmil: 5.

“E Ne e frymëzuan Musain (duke i thënë): Hidhe shkopin tënd!” Kur ja, ai gëlltiste ato që e kishin magjepsur”.⁴ Pra vënia këtu ka ardhur me kuptimin se shpallja i vulos, i godit të gjitha të pavërtetat:

﴿بَلْ نَقْذِفُ بِالْحَقِّ عَلَى الْبَاطِلِ فَيَدْمَغُهُ فَإِذَا هُوَ زَاهِقٌ﴾

“Përkundrazj, Ne të pavërtetën e godasim me të vërtetën dhe ajo (e vërteta) triumfon mbi të, ndërsa ajo (gënjeshtra) zhduket...”.⁵ Me fjalën “Ilka” kuptojmë vënien e stolisë dhe vulosjes. Mirëpo sa i përket kuptimit të fjalës vënie për Profetin (a.s.) nxirren edhe kuptime e pikëpamje tjera.

Fjala me peshë (e rëndë) për të cilën flet Allahu (xh.sh.) thotë:

﴿لَوْ أَرَدْنَا هَذَا الْقُرْآنَ عَلَى جَبَلٍ لَرَأَيْنَاهُ خَاشِعًا مُتَصَدِّعًا مِّنْ خَشْيَةِ اللَّهِ﴾

“Sikur Ne ta zbrisnim këtë Kur’an mbi ndonjë kodër, do ta shihje atë të strukur e të çarë prej frikës nga Allahu”.⁶

I zbriti të Dërguarit të Allahut, që ai t’ua komunikojë, interpretojë njerëzve të tjerë. Me kalimin e fjalës me peshë (të rëndë) tek Profeti i nderuar (a.s.) deri në botët e tjera dhe me kalimin e fjalës me peshë nga vetë Profeti (a.s.), e cila i jepte vuajtje mbi vuajtje, me zbritjen e kësaj fjale të rëndë, të cilën Ai e zbriti me ndihmën e Allahut. Kështu kemi arritur te përcaktimet tona multidimensionale, me shembuj të shumtë, duke qenë të aftë për ta pranuar dhe dëgjuar edhe nga qartësia e fortë e barrës së fjalës peshë në personalitetin e Profetit të nderuar. Kur i zbriti kaptina El-En’am Profeti (a.s.) ishte mbi kafshën e tij, e cila u begatua dhe u dëgjuan kërcitjet e eshtrave. Transmetohet nga Zejd

ibn Thabit se Profeti (a.s.) ia diktoi atij ajetin:

﴿لَا يَسْتَوِي الْقَاعِدُونَ مِنَ الْمُؤْمِنِينَ غَيْرُ أُولِي الضَّرَرِ وَالْمُجَاهِدُونَ فِي سَبِيلِ اللَّهِ﴾

“Nuk janë të barabartë ata besimtarë, që rrinë në shtëpitë e tyre, përveç të paafteve, dhe ata që luftojnë në rrugën e Allahut”, - tha. Pastaj erdhi Ibn Umme Mektum. Edhe ai më diktonte mua dhe tha: - O i dërguari i Allahut, sikur të kisha mundësi të dilja në xhihad, do dilja – dhe ai ishte i verbër. Atëherë Allahu i Madhërisëm ia zbriti të dërguarit të Tij (paqja qoftë mbi të!). Kur këmba e tij ishte mbi këmbën time, u rëndua aq shumë mbi mua sa që u frikova se do ma thyente kofshën (kockën) time; pastaj u qetësua dhe Allahu (xh.sh.) ia zbriti:

﴿غَيْرُ أُولِي الضَّرَرِ﴾ “përveç të paafteve”.⁸

Nga të gjitha këto kuptojmë se vetë i Dërguari i Allahut vuante ndjeshmërisht dhe kuptimisht prej peshës së fjalës së rëndë, të begatë e fisnike.

Të Dërguarit të Allahut i vinin shpallje edhe në ditë shumë të ftohta dhe atij i rridhnin djersë nga balli që shkëlqenin si margaritarë, pra djersa e të Dërguarit të Allahut ishte margaritar shumë i vlerësuar.

Tregon Aisheja (r.a.) kur thotë se: “E kam parë të Dërguarin e Allahut duke zbritur shpallja në ditë shumë të ftohta dhe Atë të këputur, thyer nga lodhja, ndërsa nga balli i tij i rridhnin djersë.”⁹

Pesha shpirtërore

Kuptimi i peshës në këtë aspekt fisnik simbolizon peshën shpirtërore, sepse kjo fjalë është fjalë e Atij, prandaj

4. El-A’raf: 117.

5. El-Enbija: 18.

6. El-Hashr: 21.

7. En-Nisa: 95.

8. Transmeton Buhariu.

9. Transmeton Buhariu.

përfshin të gjitha dijet, thotë Allahu i Lartmadhëruar:

﴿نَحْنُ نَقُصُّ عَلَيْكَ أَحْسَنَ الْقَصَصِ بِمَا أَوْحَيْنَا إِلَيْكَ هَذَا الْقُرْآنَ﴾

“Ne të rrëfejme ty (Muhammed) më të bukurin rrëfim përmes shpalljes së këtij Kur’ani.”¹⁰, po ashtu thotë:

﴿اللَّهُ نَزَّلَ أَحْسَنَ الْحَدِيثِ كِتَابًا مُتَشَابِهًا مَثَابِي﴾

“All-llahu ka shpallur Fjalën më të bukur (Kur’anin) në formën e një libri, pjesët e të cilit i ngjasojnë njëra-tjetrës dhe përsëriten.”¹¹, po ashtu thotë:

﴿وَاتَّبِعُوا أَحْسَنَ مَا أُنزِلَ إِلَيْكُمْ مِنْ رَبِّكُمْ﴾

“Ndiqni më të mirën e asaj që ju është shpallur nga Zoti juaj”.¹² Pra kjo fjalë është fjala më e zgjedhur, çfarë ka prej urtësive në ekzistencë.

Shkalla superiore arrin në “më të mirë” ku Allahu (xh.sh.), tek i Cili janë depot e ekzistencës dhe çfarë ka në to dhe çfarë ka qenë në to. Dhe jo vetëm çfarë ka qenë në to, por edhe si ka qenë, dhe jo vetëm si ka qenë, por dhe si do të jetë në të ardhmen. Allahu (xh.sh.) na përzgjedh ne më të mirën e këtij thesari, na përzgjedh neve shenjat më të mira, shembujt më të mirë. Që të shohim, vështrojmë me përpikmëri, korrektësi edhe këtë simbolikë, ju paraqesim krahasimin (shembullin) në vazhdim, ndërsa për Allahun është krahasimi më i lartë. Kur flet ndonjë person i mençur me profesion të caktuar, patjetër që fjalët e tij do të jenë të karakterizuara nga përqendrimi, po ashtu të karakterizuara nga njohuri të shumta, duke u pasuar me karakterizim të rëndë. Nuk është fjala e personit apo personave pa eksperiencë në fusha jo të

specializuara, ashtu sikur fjala e personit apo personave me eksperiencë në fushën e tyre. Atëherë, si do të ishte çështja e fjalës së Krijuesit dhe pronarit të gjithësisë? Fjala e Allahut (xh.sh.) është e rëndë në aspektin shpirtëror, po ashtu është e rëndë edhe në aspektin e vlerës së saj. Vërtet ajo është fjalë, që nëse merret nga ana e këtij njeriu dhe ngrihet shkallë - shkallë nga të dyja anët, ashtu siç ka thënë i Dërguari i Allahut: “Ai që lexon Kur’an është sikurse ka arritur gradën e Profetëve, përjashto atë se atij nuk i vjen shpallje”, pra ngrihet vlera e tij. Kështu ishin edhe shokët e Profetit (a.s.). Nëse njëri prej tyre mësonte përmendsh EZ-ZEHRAVEJNI (Suren Bekare dhe Ali Imran) ngrihet në sytë e njerëzve. Këtë e argumentojmë prej hadithit të cilin e transmeton Enes Bin Malik (r.a.). Transmetohet nga Enesi se një njeri shkruante për Profetin (a.s.) dhe ai e lexonte suren Bekare dhe Ali Imran. Ai njeri, nëse e lexon kaptinën Bekare dhe Ali Imran, ngrihet para nesh, do të thotë i ngrihet fama.¹³ Sepse kjo urtësi, e cila përmendet në Kur’anin Fisnik, ky mendim, dhe kjo aftësi për udhëzimin, e cila është rruga e drejtë, kur të bashkohet ngrihet në tërësi, ngrihet mes vetes. Dhe vërtet vlera e bashkuesit dhe graduesit ngrihet. Dhe bëhet i lartë pa marrë parasysh se a e njohin, e kuptojnë njerëzit apo jo atë. Sikurse rëndësia (pesha) në këtë kontekst fisnik tregon rëndësinë, vlerën nga aspekti i efektivitetit. Duke zgjeruar efektivitetin në hapjen e rrugëve, ndriçimin e rrugëve dhe duke marrë me dorën e njeriut përmes shumicës efikasitetin, produktivitetin e mençurisë dhe urtësisë.

10. Jusuf: 3.

11. Ez-Zumer: 23.

12. Ez-Zumer: 55.

13. Transmeton Imam Ahmedi.

Pesha, aftësi mbi asgjësimin

Prej kuptimeve të peshës (rëndësisë) në këtë dëshmi të bekuar, është edhe kuptimi i peshës në aftësinë e asgjësimit, për këtë Allahu xh.sh. në librin e tij faktet e tyre i quajti fakte të asgjësuarra ku thotë:

﴿ وَالَّذِينَ يُحَاجُّونَ فِي اللَّهِ مِنْ بَعْدِ مَا اسْتُجِيبَ لَهُ حُجَّتُهُمْ دَاجِضَةً ﴾

“Ata që kundërshtojnë fenë e All-llahut pasi që asaj i janë përgjigjur (njerëzit), faktet e tyre janë të asgjësuarra”.¹⁴ Pra ajo është e asgjësuar për rëndësinë (peshën) e fjalës, sepse kur zbret kjo fjalë e rëndë, e asgjëson të pavërtetën, duke e anuluar mashtrimin, devijimin, të kotën, të prishurën, të gabuarën. Të gjitha këto i asgjëson duke i mbaruar dhe sajuar. Pra rëndësia (pesha) në këtë ajet fisnik ka ardhur edhe me këtë kuptim.

Pesha në aspektin e ndërprerjes dhe favorizimit

Po ashtu prej kuptimeve të larta të fjalës së rëndë në këtë aspekt, pesha në aspektin e ndërprerjes. Kur njerëzit janë të ndarë në diskutim, hulumtim mësojnë dhe polemizojnë dhe pastaj vjen fjala e Allahut (xh.sh.), që e pret fjalën e çdo folësi tjetër. Ka peshën dhe përmbajtjen e saj për të tërhequr të gjitha këto metodologji përcaktuese, që e bëjnë atë të aftë për ndërprerje, që do të thotë ndërprerje në çdo gabim dhe çdo gënjeshtër (falsifikim).

Po ashtu prej kuptimeve të peshës në këtë kuptim të lartë, peshën e kësaj fjale në aspektin e favorizimit e argumenton fjala e të Dërguarit të Allahut kur thotë: “Kush lexon një shkronjë nga libri i Allahut ka nga një shpërblim, dhe ky shpërblim dhjetëfishohet. Nuk them se

14. Esh-Shura: 16.

‘Elif Lam Mimi’ është një shkronjë, por Elifi është një shkronjë, Lami është një shkronjë dhe Mimi është një shkronjë.”¹⁵ I thuhet lexuesit të kësaj fjale të rëndë për Ditën e Kijametit: “Atij që lexon Kur’an do ti thuhet Ditën e Kijametit: Lexo Kur’an ashtu siç lexoje në dynja dhe vendi yt në Xhennet do të jetë, tek ajeti i fundit që do të ndalesh.”¹⁶

Ndërsa ai që punon me të ka përgatitur Xhennetin me të mirat e tij ku të dojë. Allahu (xh.sh.) në lidhje me ata që punojnë sipas kësaj fjale të rëndë thotë:

﴿ وَقَالُوا الْحَمْدُ لِلَّهِ الَّذِي صَدَقَنَا وَعُدَّهُ وَأَوْرَثَنَا الْأَرْضَ نَتَبَوَّأُ مِنَ الْجَنَّةِ حَيْثُ نَشَاءُ فَنِعْمَ أَجْرُ الْعَامِلِينَ ﴾

“E ata (të Xhennetit) thanë: ‘Falënderuar qoftë All-llahu, i cili premtimin e Vet e bëri realitet ndaj nesh dhe na e la në disponim tokën e Xhennetit që të vendosemi aty ku të duam! Sa shpërblim i mirë është ndaj atyre që vepruan drejt!’.”¹⁷ Kjo është fjalë e rëndë në peshoren e mirësive:

Thotë Allahu (xh.sh.):

﴿ وَالْوَزْنُ يَوْمَئِذٍ الْحَقُّ فَمَنْ ثَقُلَتْ مَوَازِينُهُ فَأُولَئِكَ هُمُ الْمُفْلِحُونَ . وَمَنْ خَفَّتْ مَوَازِينُهُ فَأُولَئِكَ الَّذِينَ خَسِرُوا أَنفُسَهُمْ بِمَا كَانُوا بِآيَاتِنَا يَظْلِمُونَ ﴾

“Peshimi (i veprave), atë ditë do të jetë i drejtë. Ata që u rëndon peshorja me vepra të mira, do të jenë të shpëtuar; kurse ata që e kanë të lehtë peshoren me vepra të mira, do të humbin veten e tyre, për shkak se mohuan shpalljet Tona.”¹⁸ Fjalë me peshë në peshoren e Allahut (xh.sh.) ku peshon krahu i atij që u nderua me këtë fjalë dhe u ngrit në gradat më të larta, pastaj punoi me të në kushtet më të favorshme të të mirave edhe nga aspekti i shpërblimit madhështor.

15. Transmeton Buhariju.

16. Transmeton Ebu Davudi.

17. Ez-Zumer: 74.

18. El-A’râf: 8-9.

Pesha për nga aspekti dhe aftësia e saj në shërimin e zemrave

Kjo fjalë po ashtu është e rëndë nga aspekti i shërimit të zemrave dhe ringjalljes së tyre, thotë Allahu (xh.sh.):

﴿ وَنَزَّلُ مِنَ الْقُرْآنِ مَا هُوَ شِفَاءٌ وَرَحْمَةٌ لِّلْمُؤْمِنِينَ ﴾

“Ne shpallim nga Kur’ani atë që është shërim dhe mëshirë për besimtarët.”¹⁹ Kur të vendoset kjo fjalë në zemrën e besimtarit ose besimtares, nuk mund ta luftojë diçka tjetër këtë fjalë të rëndë, prej dyshimeve, epsheve, armiqësive, helmeve apo diçka tjetër, ku kjo fjalë e bekuar e mbush zemrën dhe i nënshtrohet (bindet) asaj dhe nuk lë vend për diçka tjetër, duke argumentuar me fjalën e Allahut të madhëruar:

﴿ وَلِيَعْلَمَ الَّذِينَ أُوتُوا الْعِلْمَ أَنَّهُ الْحَقُّ مِن رَّبِّكَ فَيُؤْمِنُوا بِهِ فَتُخَفِّتَ لَهُ قُلُوبُهُمْ ﴾

“E, edhe për ta vërtetuar të diturit se me të vërtetë ai (Kur’ani) është realisht prej Zotit tënd dhe kështu t’i besojnë atij (Kur’anit) dhe (zëmrat e tyre) të binden ndaj tij.”²⁰

Pesha nga aspekti i mundësisë së përvojës së njeriut

Rëndësia, pesha e kësaj fjale nga aspekti i mundësisë së përvojës së njeriut, kur thotë Allahu (xh.sh.):

﴿ فَاعْتَبِرُوا يَا أُولِيَ الْبَصَارِ ﴾

“Pra merrni përvojë o ju të zotët e mendjes?”²¹ Anija e tij nuk ka mundësi të paraqesë thënie të dyshimta me gabime, ku ajo ka aftësi që të hapë rrugën e ndarë të saj nga një breg (vend) në tjetrin, prej bregut të injorancës në bregun e diturisë, nga bregu i humbjes në bregun e udhëzimit, nga bregu i dyshimit në bregun e vërtetë, ajo është një anije e

aftë me emrin e Allahut Fuqiptotë, që i hap ujërat e ndara nëpër këto brigje me peshën e saj, dhe anija sa më e rëndë që ishte, kishte mundësi t’i hapë, çelë, çajë valët e detit:

﴿ وَجَرَيْنَ بِهِم بِرِيحٍ طَيِّبَةٍ ﴾ “që lundrojnë me ta (me udhëtarët) me anë të një ere të lehtë”.²²

Pesha dhe zgjedhja në momentet e krahasimit me librat e mëparshëm

Po ashtu prej kuptimeve të peshës në këtë vështrim fisnik, pesha (Kur’ani) dhe përparësia e zgjedhjes në momentet e krahasimit me librat e zbritur më parë, Allahu (xh.sh.) librin e Musait dhe Harunit (a.s.) e quajti كِتَابَ الْمُؤْتَمِنِينَ libri i qartë:

﴿ وَأَتَيْنَاهُمَا الْكِتَابَ الْمُؤْتَمِنِينَ ﴾ “Atyre të dyve u dhamë librin e përsosur e të qartë”.²³

Ndërsa Kur’anin Famëlartë e quajti Libër të kuptueshëm:

﴿ طَسَّ تِلْكَ آيَاتُ الْقُرْآنِ وَكِتَابٍ مُّبِينٍ ﴾

“Ta, Sinë. Këto janë ajete të Kur’anit dhe të librit të kuptueshëm”.²⁴ Për këtë, ky Kur’an është prijësi i librave dhe me të i ishte dërguar Muhammedit (paqja qoftë mbi Të), me peshën e fjalës, e cila iu zbrit atij. Ai është prijësi (imami), të cilin e nderoi Allahu (xh.sh.) si Prijës të të gjithë Profetëve mbarë, siç u vërtetua me ngjarjen e Israsë dhe Miraxhit të bekuar, ku transmeton Muslimi nga Hadithi i Israsë thënie e Profetit (paqja qoftë mbi Të), ku thotë: “Kur isha në mesin e tyre... kur hyri koha e namazit u dola imam atyre.” Kjo është fjalë me peshë (e rëndë) në krahasim me dërgesat e mëhershme.

Pesha në bisedën e njeriut me veten e tij

19. El-Isrâ: 82.

20. El-Haxhxh: 54.

21. El-Hashr: 2.

22. Junus: 22.

23. Es-Saffat: 117.

24. En-Neml: 1.

Kjo fjalë po ashtu është me peshë edhe në bisedën e njeriut me veten e tij. Njeriu nuk është një njësi e vetme, por ai është një bashkim i njëjësive të tjera, ai ka shpirt, ka nefsin, ka pronën, ka shokun, ka djaj prej Xhindeve dhe njerëzve, ka sfera të tjera, ka inspirime të këtyre zërave, të cilat ndikojnë në brendinë e njeriut, kur paraqesin dhe tregojnë nëse është i barabartë nga aspekti i peshës dhe posedimit të saj brenda vetes së njeriut. Dhe në kontekstin e të gjitha këtyre njëjësive përbërëse të tij, kur ndërhyjnë kjo fjalë me peshë me të vërtetë qetësimi vjen në zemrën e njeriut dhe nuk mbetet asnjë shqetësim, ashtu siç ka thënë Allahu (xh.sh.):

﴿ فِيهِ شُرَكَاءٌ مُّشْتَاكِسُونَ ﴾ “në posedimin e të cilat tshin ortakë pa marrëveshje mes vete...”²⁵ Mirëpo do të jetë paqe për hir të Allahut, Zotin e të gjithë botëve dhe do të bëhen më të aftë që të hyjnë të gjithë në paqe, thotë Allahu (xh.sh.):

﴿ وَإِنَّمَا يَرْجِعُكَ مِنَ الشَّيْطَانِ نَزْعٌ فَاسْتَعِذْ بِاللَّهِ إِنَّهُ سَمِيعٌ عَلِيمٌ . إِنَّ الَّذِينَ اتَّقَوْا إِذَا مَسَّهُمْ طَائِفٌ مِّنَ الشَّيْطَانِ تَذَكَّرُوا فَإِذَا هُمْ مُبْصِرُونَ . وَإِخْوَانُهُمْ يَمُدُّوهُمْ فِي الْعَاقِبَةِ لَمَّا لَا يَفْصِرُونَ . وَإِذَا لَمْ يَأْتِهِمْ بَأْيَةٌ قَالُوا لَوْلَا اجْتَبَيْنَاهَا قُلْ إِنَّمَا اتَّبَعْتُ مَا يُوحَىٰ إِلَيَّ مِن رَّبِّي هَلْ أَهْلًا بِصَائِرٍ مِّن رَّبِّكُمْ وَهُدًى وَرَحْمَةً لِّقَوْمٍ يُؤْمِنُونَ . وَإِذَا قُرِئَ الْقُرْآنُ فَاسْتَمِعُوا لَهُ وَأَنْصِتُوا لَعَلَّكُمْ تُرْحَمُونَ ﴾

“E nëse të godet shejtani me ndonjë ves, ti kërko strehim te Allahu, sepse vërtet Ai dëgjon dhe di. Vërtet ata që janë të ruajtur, kur i prek ndonjë iluzion nga djalli, ata përkujtojnë (Allahun), dhe atëherë shohin (të vërtetën). E vëllezërit e tyre (jo të ruajturit) i përkrabin (shejtanët) për në humbje dhe nuk u ndahen. Dhe ti kur nuk u sjell atyre ndonjë mrekulli (që e kërkojnë) thonë: “përse ti nuk e trillove vetë?” Thuaj: “Unë (nuk trilloj) i përmbahem vetëm asaj që më shpallet nga Zoti Im, ky (Kur’an) është argument (me të cilin ndriçohen

25. Ez-Zumer: 29.

zëmrat) nga Zoti juaj, është udhërrëfyes dhe mëshirë për popullin që beson. Kur lexohet Kur’ani, ju dëgjojeni atë (me vëmendje) dhe beshtni, në mënyrë që të fitoni mëshirë”²⁶

Pesha për nga aspekti i sfidimit

E përfundoj këtë fjalë në lidhje me fjalën peshë, duke treguar se prej kuptimeve të fjalës peshë, në aspektin e sfidimit me të cilën fjalë Allahu (xh.sh.) sfidoi xhindet dhe njerëzit:

﴿ وَإِن كُنْتُمْ فِي رَيْبٍ مِّمَّا نَزَّلْنَا عَلَىٰ عَبْدِنَا فَأْتُوا بِسُورَةٍ مِّن مِّثْلِهِ وَادْعُوا شُهَدَاءَكُمْ مِّن دُونِ اللَّهِ إِنْ كُنْتُمْ صَادِقِينَ ﴾
“E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë sillni ju një kaptinë të ngjashme si ai (Kur’an) dhe thërrisni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotërat) pos Allahut, nëse jeni të singertë (në thëniet tuaja se Kur’ani nuk është prej Zotit)”²⁷

Ky sfidim ekziston prej katërmbëdhjetë shekujsh dhe historia e ka dëshmuar, çfarë u ndodhi atyre që me vetet e tyre u munduan ta sfidojnë Kur’anin në këtë çështje dhe ta kalojnë këtë fjalë me peshë. Për këtë, kjo fjalë me peshë ka edhe të tjera kuptime të shumta, kjo fjalë është ilaç, është qetësim, prehje, shërim dhe kjo është një Rukje e bekuar, e cila kur futet në brendësinë e njeriut me peshën e saj i zgjidh të gjitha shqetësimet dhe sëmundjet:

﴿ قُلْ هُوَ الَّذِي آمَنُوا هُدًى وَبِشْفَاءٍ ﴾ “Thuaj ai është për besimtarët udhëzues e shëruar.”²⁸

Lusim Allahun (xh.sh.) të na shërojë me këtë fjalë me peshë (të rëndë) nga të gjitha sëmundjet, nga të gjitha fatkeqësitë e jashtme dhe të brendshme. Amin!

Përktheu: Veton Nuhi TULLA

26. El-A’râf: 200-204.

27. El-Bekare: 23.

28. Fussilet: 44.

Kontributi i ulemasë shqiptare në Maqedoni për shkollën dhe gjuhën shqipe

Prof. Dr. Avzi Mustafa
Shkup, Maqedoni

Abstrakt

Në gjithë rrjedhën e ngjarjeve që përcaktojnë fatin e Shqipërisë e të shqiptarëve gjatë historisë, pa dyshim, gjejnë vend të merituar edhe ulemaja shqiptare nga territori i Maqedonisë së sotme, që duhet të zënë vend në analet e historisë, që është pjesë e kontributit e të lavdisë shqiptare.

Në rrethanat e ndryshme, ulematë shqiptarë, që në shumicën dërmuese të rasteve ishin edhe mësues në shkollat e kategorive të ndryshme, shqubën për një qëndrim dinjitar, ata kurrë nuk lejuan që besimi, feja të bëheshin pengesë në përparimin e popullit tonë. Ata e kishin kuptuar shumë mirë edhe hadithin e Pejgamberit tonë, që kudo ata e përsëritnin në dy gjuhë arabisht dhe shqip “Hubul vatan min el iman” (“Dashuria për atdheun është prej besimit”). Sidomos periudha e Rilindjes kombëtare, që ishte edhe një lëvizje iluministe, që kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes kombëtare, ndikoi që feja të mos bëhet pengesë, por përkundrazi të vibet në shërbim të kombit.

Në gjithë rrjedhën e ngjarjeve që përcaktojnë fatin e Shqipërisë e të shqiptarëve gjatë historisë, pa dyshim, gjejnë vend të merituar edhe ulemaja shqiptare nga territori i Maqedonisë së sotme që duhet të zënë vend në analet e historisë, që është pjesë e kontributit e të lavdisë shqiptare, që gjithsesi në çdo përvjetor të Pavarësisë së Shqipërisë duhet të kujtohen e të nderohen.

Në Maqedoni që nga shekulli XV që kur hapen edhe xhamitë e para si objekte kulti për popullatën që predikonin Islamin, jo si besim fisi, por si një qytetërim kohe. Edhe pse Islami për nga koncepti predikon vëllazërim botëror, në asnjë çast kjo fe nuk i cenon

instinktët e mira të natyrës së njeriut, por përkundrazi i forcon dhe i drejton.

Instinktët natyrorë janë nga më të ndryshmit, por instinkti i dashurisë ndaj atdheut, gjuhës me të cilën lindesh dhe vdes me ato dhe se janë tipare të identitetit të çdo kombi. Ulematë fetare shqiptare këtë më së miri e kuptuan në momentet më të vështira kur popullit tonë i kanosej rreziku i asimilimit nga sllavët e helenët, ruajtja e gjuhës dhe kombit ishte një refren i lutjeve të përditshme.

Shkollimi kudo që shtrihej Perandoria Osmane ishte në gjuhën e perandorisë dhe nuk kishte dyshim se hoxhallarët që kryenin edhe profesionin e mualimëve nëpër shkolla, në fillim

vinin nga viset e perandorisë. Kështu që me nevojën e madhe që e kërkonte koha ishin të detyruar që të hapnin shkolla edhe në trevat ku banorët ishin të kombësive të ndryshme.

Në zhvillimin e shkollës dhe arsimit nën Perandorinë qartë dallohen dy periudha. Periudha e parë që kap kohën prej vendosjes së Perandorisë në këto treva, e deri në gjysmën e shekullit XIX, që shkollat mbartin po të njëjtat tipare të sistemit feudalo – skolasik në aspektin pedagogjik, në zbatimin e metodave të punës, që bazohet ekskluzivisht në përmbajtjet religjioze. Periudha e dytë që nga shumë historianë të arsimit quhet periudha e “modernizimit” të shkollave ku në plan-programet krahas përmbajtjes religjioze – shoqërore hyjnë edhe përmbajtje nga lëndët natyrore.

Perandoria Osmane nuk e kishte të rregulluar me ligje jetën arsimore deri në vitet 40 të shekullit XIX. Të gjitha shkollat ishin në dorë të konfesionit, por kjo nuk do të thotë se sulltanati nuk mbante llogari për këto shkolla që ishin produkt i tyre.

Shkollat më masive që u hapen me ardhjen e Perandorisë ishin shkollat e ashtuquajtura mejtepe. Në fillim hapeshin në qytete e pastaj edhe në vendbanimet më të mëdha e vonë edhe pranë çdo xhamie. Krahas mejtepeve në qytetet e mëdha hapeshin edhe shkolla të quajtur shkolla të rangut të lartë, si ruzhdijet e medresetë. Shkollat islame që i hapi pushteti osman me përhapje më të madhe ishin mejtepet, ku mësimin zhvillohej zakonisht nga imamët që quheshin nga populli mulla ose hafiz¹.

1. Shefik Osmani, Fjalor i pedagogjisë, botoi “8 Nëntori” 1983, 416.

Mejtepet sipas disa të dhënave nga Salnamet (vjetarët), por edhe Evlia Çelebija udhëpërshkruesi më i madh i Perandorisë na sjell informacione edhe për territorin e sotëm të Maqedonisë. Vetëm në Shkup kanë punuar 70 mejtepe, 9 shkolla për përvetësimin e Kur’anit dhe 6 medrese, 9 imarete. Medresetë më të njohura kanë qenë ajo e Sulltan Muratit, Jahja Pashës, Isak Pashës, Isa Pashës, Mustafa Pashës dhe Zadesë dhe ishin ndërtuar “në pjesën më të madhe të qytetit të banorëve që flasin gjuhën e Rumelisë dhe gjuhën shqipe”.² Përveç Shkupit edhe Kumanova ka pasur xhami, teqe e medrese, Velesi një xhami e një mejtep, Prilepi dy xhami mejtepe e medrese.³

Po ashtu edhe Manastiri si qendër administrative, e ekonomike dhe kulturore arsimore përmend 9 medrese, prej të cilave më e madhja dhe më e bukura ka qenë ajo e Dylbend-kadiut. Të dhëna ka edhe për Tetovën, Gostivarin, Kërçovën Resnjën, Dibrenë, Ohrin, Strugën, Krushevën etj. të cilat kanë kryer një veprimtari të pasur kulturo-arsimore⁴

Në mejtepe mësimin e organizonin vetë imamët e xhamive që në fillim vinin hoxhë-mualimë që nga populli quheshin ixhazetli ose “Hoxhallarë të Stambollit”.⁵ Këto shkolla vetëfinancoheshin nga njerëz të vendit dhe vakëfet. Medresetë po ashtu vetëfinancoheshin me ndihmën e njerëzve të pasur e të vakëfeve.

2. Evlija Çelebija Putopis, Odlomci o Jugoslovenskim yemljama, Sarajevo, 1979, f. 288.

3. Po aty, f. 304-305.

4. Shih :Nexhat Abazi, Zhvillimi arsimit dhe i mendimit pedagogjik shqiptar në Maqedoni (1830-1912, Tetovë, 1997, f. 26-28.

5. Feti Mehdiu, Kërçovarët për Kërçoven, Asdereni, Shkup, 2009, f. 10.



Shkup, 1934

Shkollat fillore (iptidaije) turqisht në bazë të një vjetari lëshuar nga ministri i arsimit të përgjithshëm (Merif selnamase 1898) në vilajetin e Manastirit kanë funksionuar 451 shkolla të tilla, në vilajetin e Kosovës vetëm në Shkup kanë funksionuar 24 ruzhdije, në Manastir 17, kurse shkolla të mesme (idadije) 2 brenda në Manastir dhe një në Shkup. Këto të dhëna i dhashë me të vetmin qëllim që të tregoj se të gjithë mualimët kishin ndjekur medresetë nëpër qytetet e ndryshme të vendit, kurse dikush edhe studimet e larta në Stamboll.

Në këto rrethana ulematë shqiptarë që në shumicën dërmuese të rasteve ishin edhe mësues në shkollat e kategorive të ndryshme, shquhen për një qëndrim dinjitar, ata kurrë nuk lejuan që besimi, feja të bëheshin pengesë në përparimin e popullit tonë. Ata e kishin kuptuar shumë mirë edhe hadithin e Pejgamberit tonë që kudo ata e përsëritnin në dy gjuhë arabisht dhe shqip “HUBUL VATAN MIN EL IMAN” (“Dashuria për atdheun është prej besimit”). Sidomos periudha e Rilindjes kombëtare që ishte edhe një lëvizje iluministe që kishte për qëllim ngritjen e vetëdijes kombëtare ndikoi që feja të mos bëhet pengesë, por përkundrazi të vihet në shërbim të kombit.

Lufta për gjuhën dhe shkollën shqipe, që populli ynë e ka zhvilluar me shekuj, përfaqëson faqet më të ndritura, por edhe më të përgjakura të historisë sonë kombëtare. Rilindësit, duke kuptuar kompleksitetin e momenteve historike për ta ruajtur qenien e identitetit kombëtar, dhanë kushtimin se pa rrokur armën e shkrimit nuk mund të mbijetosh e të futesh në rrugën e progresit, të lirisë e të pavarësisë.

Pas kushtetutës 1846, dhe si rrjedhojë e dekretit sulltanor, lejohej hapja e shkollave laike shtetërore, çka i hapte dyert fillimit të lëvizjeve për arsim e kulturë. “Duke qenë se për pjesën myslimane lejohej vetëm përdorimi i alfabetit arab, intelektualët shqiptarë myslimanë të kohës u munduan që përmes këtij alfabeti të përhapnin mësimin e gjuhës shqipe, si mjet të përparimit dhe të ngritjes kulturore”.⁶

Që në vitin 1868 u mblohdën patriotët shqiptarë mu në qendër të Perandorisë, në Stamboll, dhe vendosën: “Duhet ta shkruajmë gjuhën shqipe, duhet të zgjedhim ato germa që përcjellin tingullin më lehtë, tingullin e bukur të gjuhës sonë. Dhe, germat të jenë shqip!”⁷. Për këtë arsye Sami Frashëri shkruan: “S’mund të ketë Shqipëri pa shqiptarë, s’mund të ketë shqiptarë pa gjuhë shqipe, s’mund të ketë gjuhë shqipe pa shkolla në të cilat të mësohet shqipja”.⁸

Në një gazetë të periudhës së Rilindjes kombëtare me titull “Zëri i Shqipërisë” që botohej në Athinë në

6. Islam Dizdari, po aty,

7. Avzi Mustafa, Studime dhe artikuj, UISHM, 2012, Shkup.

8. Sami Frashëri, “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të bëhet”, Tiranë, 1962, f. 68.

vitin 1879 me titull: “Për gjuhën shqipe” do të shkruaj kështu: “...shqiptarët duhet të fitojnë më parë lirinë e tyre që të veprojnë si të duan ata vetë dhe si është e drejta e tyre, e pastaj ato do të kenë lehtësi dhe kohë që të ia vënë mendjen zhvillimit të tyre dhe në përgjithësi edukimit të tyre.”⁹

Personalitetet e kulturës sonë islame edhe pse ishin në vëmendje të përhershme në ligjërata e me fetvatë e tyre, ato dhanë kontribut të çmueshëm ku shumica dërmuese e myderrizëve ishin shqiptarë, të cilët pavarësisht nga kultura e tyre orientale, punonin me nxënës shqiptarë, që dinin vetëm gjuhën amtare. “Prandaj, siç e kanë vënë në dukje edhe studiues të ndryshëm, diskutimet, bisadat, shpjegimet bëheshin në gjuhën shqipe. E nuk kishte si të ngjiste ndryshe në një mjedis krejt shqiptar, ku nuk ka pasur asnjëherë asnjë komunitet të huaj”.¹⁰

Edhe pse shumica e fetarëve ishin shkolluar në institutet e larta fetare në Stamboll, ato kurrë nuk e mohuan kombin dhe gjuhën dhe sot përmenden, si shkrimtarë, teologë e filozofë të rafinuar. Mendoj se mjafton të përmendim disa nga ata që mbi supet e tyre mbanin fatin e kombit e të gjuhës siç ishin: Hoxhë Tahsini, Hoxhë Kadria, Vehbi Efendia, Hafiz Ali Korça, Jusuf Oruçi e shumë të tjerë.

Gjuha shqipe kurrë nuk është ndalur nga goja e ulemave, ajo ka pas jetë të gjallë si nëpër xhamitë ashtu edhe nëpër

mejtepet, sepse nuk kishte si të ishte ndryshe kur besimi dhe dituritë nuk mund të hyjnë në zemër e të transformohen në njohje intuitive pa gjuhën amtare. Këtë na e dokumenton Jashar Erebara shënuar në “Kulturën Islame” nëpërmjet një rrëfimi që daton aty kah vitet 1871. Në një xhami në Elbasan një hoxhë ka dhënë këshilla për gra gjatë vaazit të tij. Një tregtar venecian që do të shkonte për në Stamboll, qëlloi që nja dy net të qëndronte në Elbasan. Duke shëtitur me përkthyesin nëpër rrugët e Elbasanit vërejti shumë gra pranë një xhamie dhe pyeti çka janë këto gra në xhami? Përkthyesi sikur deshi t’ia humb vëmendjen duke i treguar diçka tjetër, por ai insistonte dhe më në fund i tha “Janë tue ndigjue këshilla fetare”, ai përsëri pyeti në ç’gjuhë? Përgjigja ishte në gjuhë shqipe.¹¹

Në mungesë të shkollave në gjuhën amtare e të shkrimit shqip, hoxhallarët nëpërmjet fjalës së gjallë, kudo nëpër odat shqiptare, që ishte një universitet, krahas shembujve të cituar arabisht ato bënë edhe përkthimin edhe në gjuhën shqipe, shumë hadithe që i komentonin e i lidhshin me zakonet e me traditën e shqiptarëve. Ato që kryenin punën e mualimëve dhe u mësonin fëmijëve shkronjat arabe, apo për t’i konkretizuar dhe për t’i mbajtur mend më lehtë fëmijëve ua shpjegonin me shumë figura që u përngjanin sendeve e ua thonin shqip¹². Në xhamitë kur ato flisnin në gjuhën e Pejgamberit tonë ua këndonin këtë gjuhë edhe në gjuhën shqipe, në vaazet e tyre nga shumë hoxhallarë është derdhë atdhedashuria.

9. “Zëri i Shqipërisë, Athinë, 1879, nr. 4, (shih Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare”, vëllimi I (1879-1908).

10. Islam Dizdari, Kontributi i ulemasë shqiptare për shkollën, për gjuhën dhe për shkrimin shqip.

11. Kultura islame, organ i Komunitetit Shqiptar Mysliman, nr. 5,6,7 1942, f. 191.

12. Avzi Mustafa, Studime dhe artikuj, UISHM, Shkup, 2012.

Këto ishin faktorët që gjuha dhe shkollimi në shkollat e perandorisë ishin përpjekjet për t'ia përshtatur popullit shqiptar në gjuhën e vetë. Pas viteve 30 të shekullit XIX filluan të hapen edhe shkollat shtetërore turke, si iptidaijet (fillore), ruzhdijet (gjimnazet e ulëta), idadijet (gjimnazet e mesme), daruh mualimin (shkollat normale)¹³. Po në këtë kohë kemi edhe kërkesa e sidomos në Sulltanijet, që edhe gjuha shqipe të mësohej në shkolla krahas gjuhës osmane.

Periudha e viteve 1908-1912 është ajo më e rëndësishme për gjuhën dhe shkollën shqipe. Në këtë periudhë kemi kërkesa haptazi si nga nxënësit, ashtu edhe nga disa besimtarë myslimanë, që kërkonin që gjuha shqipe të mësohej në shkollë. Si në çdo vend të Shqipërisë, ashtu edhe në Shqipërinë Lindore, gjegjësisht në pjesët e Maqedonisë së sotme dolën disa patriotë myslimanë, që kërkonin që gjuha shqipe jo të mësohej si lëndë mësimore, por i gjithë mësimi të zhvillohej në gjuhën shqipe.

Nga kjo që kemi hulumtuar dhe nga ajo që është shkruar dalin se ulemaja shqiptare në Maqedoni ndahej në dy taborë, në ulema që kërkonin shkollë në gjuhë shqipe me alfabetin latin dhe ulema që kërkonte shkollë dhe gjuhë shqipe me alfabetin osman.

Në këtë kohë si çështje e pazgjidhur ishte alfabeti i gjuhës shqipe. Kjo ngjarje kulturore e shqiptarëve pa marrë parasysh e kujt profili i takon ishte një ndër çështjet shumë me rëndësi. Fanatikët në çdo mënyrë

13. Shih Jashar Rexhepagiq, Zhvillimi i arsimit dhe sistemit shkollor të kombësisë shqiptare në terrtorin e Jugosllavisë së sotme deri më 1018, Prishtinë, 1968, f. 114

mundonin që të luajnë kartën e fesë mbanin qëndrim se “shkronjat latine janë në kundërshtim me fenë islame”. U munduan në çdo mënyrë që të pengojnë dhe të dezinformojnë popullatën e pashkolluar. Mirëpo kjo nuk u shkoi për dore sepse një pjesë e ulemasë fetare u ngritën dhe me argumente e mbrojtën ABC-në shqipe.

Krahas trajtimeve të besimit Islam shumë personalitete të kësaj fushe vepronin për ngritjen e vetëdijes kombëtare, në bashkimin e popullit pa dallim feje, për shërbesë fetare në gjuhën shqipe, pavarësi të plotë etj.

Një personalitet nga Rinnica e Rekës së Dibrës me emrin Vildan Faik, i cili një kohë të gjatë ka vepruar në Üsküdar, në një lagje të Stambollit. Më vonë kthehet në Dibër dhe aty e kryen punën e hoxhës, ndërsa bëhet edhe një ndër anëtarët aktivë të klubit “Bashkimi”, madje merr pjesë në Kongresin e Alfabetit në Manastir dhe është përkrahës i shkronjave latine. Sipas Dr. Hasan Kaleshit, ai njihet me një fjalim të zjarrtë dhe patriotik, që e mbajti para delegatëve të Kongresit të Manastirit ku tha: “Kur’ani nuk ka asnjë lidhje me alfabetin”¹⁴.

Haxhi Vildan efendiu pasi e demaskoi sundimin e Portës së Lartë dhe e lëvdoi kushtetutën, ai e thkesoi nevojën e bashkimit të shqiptarëve, të cilat tani do të bashkohen edhe me një alfabet, e alfabeti – tha haxhi Vildani – është një vegël e fuqishme që i përshtatet më së miri gjuhës së tij,

14. Dr. Hasan Kaeshi, Neki problem izucuvanja kulturne istorije Pologa za vreme turskog perioda, I Nucnen sobir, Gostivar, 22-23.10.1971, f. 186.

prandaj shqiptarët e zgjedhin alfabetin shqip. Turqit gjithashtu nuk kishin shkronja për ta shkruar gjuhën e tyre – ata i kanë adaptuar shkronjat arabe. Sa për drejtimin se si lypsej të shkruhej – nga e majta në të djathtë, apo nga e djathta në të majtë – kjo nuk është punë me rëndësi. Sa i përket fesë, ajo i takon zemrës së njeriut, kështu që secili është i lirë t'i ketë pikëpamjet e veta.

Një prej përfaqësuesve të ulemas shqiptare është tetovari Rexhep Xhudi, i biri i Nuredin Vokës. Voka që kërkonte në shkollat shqipe të përdorej alfabetit latin, dhe bashkë me klubin e oficerëve të Vlorës ndërmerr një fushatë të gjerë në favor të alfabetit arab. Voka e adaptoi alfabetin arab për shqipen dhe mund të themi me sukses të plotë. Por ky nuk është kundër gjuhës dhe shkollës amtare. Këtë më së miri e dëshon në faqen e parë që është shkruar turqisht se alfabeti i kushtohet “popullit të zgjuar shqiptar që fëmijët të shkruajnë dhe të lexojnë në gjuhën e vet amnore, kështuqë të arrihet një përparim material e shpirtëror”. Në fund të librit kemi fjalët: “Është konstatuar se me këto germa, që janë rezultat i studimeve të gjata, mund të lexohet shumë mirë”. Vetëm duhet një përvojë. Fundi i fundit, a nuk ndodhi kështu me çdo gjuhë tjetër. Për ta përhapur sa më tepër alfabetin e tij, Voka boton më 1911, prapë në Stamboll librin “*Arnavutça mufesal ilmihal*” (Libri i hollësishtëm i mësimave fetare në shqip).

Mirëpo, vepra më interesante e më e rëndësishme e Vokës është padyshim *Mendime*, botuar në Stamboll më 1911. “Meqtevet t'i hapim, ene në mos mundshim me mbarue binaja

të mëdhaja, kolibe me kashtue, veç fëminë me e mbledh e me e këndue:

“Mos rrim, mos rrim, po i madh e i vogël me vrap të këndojm e të mëcojm”.

*“Sot dynjaja osh ba qetir, sall me pushke e me thik nuk po fitohet, po po libet edhe kalem e kendim, fjal e mendim”.*¹⁵

Voka nëse ishte për alfabetin turko-arab ai nuk ishte kundër shkollës e gjuhës shqipe e as kundër popullit shqiptar. Unë do të përmend edhe një mendim të Vokës në lidhje me fenë dhe etnopsikologjinë e shqiptarëve ku ky bënë një duel shumë të ashpër me delegatin e serbëve të osmanlinjve të Vilajetit të Kosovës Glisha Elezoviqin në Parlamentin Osman rreth rolit të besës të shqiptarët.¹⁶

Gjithashtu mjaft me rëndësi është edhe anekdota që e kamë shënuar nga një ish-nxënës i Rexhep Vokës, kur ai e mbron kombin shqiptar si komb më vete. “Një mik turk i Rexhep Vokës vjen në Tetovë, shëtisin tërë Tetovën, takohej me njerëz bisedonin. Kur kthehet në Stamboll këtë e pyesin për përshtypjet e tij në Tetovë. Ai tregon dhe e përshkruan Tetovën ashtu siç është e bukur, por ai ka vërejtur diçka që nuk i ka pëlqyer, populli në shumicë nuk ishte mysliman sepse ato nuk dinin turqisht. Atëherë Rexhep Voka luan pak prej vendit dhe me një kollitje të hollë e pyet mikun, o mik sipas teje edhe Muhamedi (a.s.) nuk na paska qenë mysliman se edhe ai nuk ka ditë turçe”.¹⁷

15. Rexhep Voka, *Mendime*, f. 14.

16. Hasan Kaleshi, *Albanska alamiada knizhevnost, Prilozi za orientalnu filologiju*, Sarajevë, 1970, f. 49-62.

17. Avzi Mustafa, *Figura mësuësish shqiptar, I*, BKSH, Tetovë, 1975.

Kjo anekdotë tregon se gjuhën amtare shqipe dhe shkollën asnjë herë nuk i ka injoruar. Çështja e shkronjave është si te të gjithë që kanë krijuar alfabetet. Te ai nuk kemi as edhe mendimin e pedagogëve të shekullit XX që kërkonin se feja nuk duhet të bëjë dallime; arsimit është arsimit, ngado që të vijë, nga Lindja apo Perëndimi.”¹⁸

Islami asnjëherë nuk ka qenë pengesë e dijes dhe përparimit, por përkundrazi ka ndihmuar dhe mobilizuar pjesën më të shëndoshë të popullit shqiptar. Një kontribut të veçantë në ndërtimin e shtetit shqiptar kanë dhënë ulematë islam dhe pikërisht ka qenë i madh ndikimi i tyre në kulturën kombëtare.

Said Najdeni ose siç e quanin bashkëqytetarët Hoxh Vogëli (Voka) sepse me fjalët e ëmbla ua vakte zemrat shqiptarëve, arsimimin në gjuhën amtare dhe përhapjen e diturive çdo herë e përsëriste para xhemitit dhe kudo që ndodhej. “Me dituri të mendjes t’u vijmë kundër armiqve që i kemi rreth e rrotull, d.m.th. me lartësinë e diturisë t’i presim e t’ua lëmë zbrazët armët, që janë duke u përdor kundër nesh”¹⁹. Ky fetar patriot për përhapjen e gjuhës dhe shkollës shqipe botoi një “Abetare të gjuhës shqipe” në vitin 1900, adaptuar në të “folmen gegnisht” në Sofje. Po ashtu hapi edhe një shkollë klandestinë në gjuhën shqipe ku i mësoi shumë dibranë. I edukuar në urtësinë e Kur’anit dhe në dhe me patriotizmin shqiptar atij i ofronin shumë poste e para, por ai

publikisht deklaronte se “nuk vuan për poste e para, por për shqiptari”.²⁰

Një fetar patriot mysliman shqiptar që ka lënë gjurmë të pashlyeshme është edhe Vehbi Dibra (Agolli) që dallohej si një nga mendimtarët e mëdhenj, një njeri me intuitë largpamëse dhe njeri i mexhliseve dhe odave. Ky nuk nguronte ta thotë të drejtën dhe të vërtetën, qoftë ajo edhe e hidhur. Në Dibër kishin ardhur pesë pashallarë e hafizllarë turq dhe ishin mbledhur në Dibër të gjithë burrat e përmendur, midis të cilëve merrte pjesë edhe Vehbi Dibra. Në mes bisedimeve e pyetjeve, që u bënë dibranëve në mexhli u prek edhe çështja e alfabetit. Për këtë ata iu drejtuan Vehbi efendiut se çfarë mendimi ka për shkronjat shqipe. Ai e kuptoi nga pyetja qëllimin e turqve, por ai pa ndrojtje dhe me qetësi u foli edhe për gjuhën shqipe dhe për alfabetin, “duke thënë se tashmë ekziston alfabeti i Stambollit që doli në mars të vitit 1879”, të cilin ai e njihnte mirë. Nga fjalët e tij turqit u mahnitën dhe njëri prej tyre u shpreh kështu: *Byjuk Dibradan çok ulema var, ama bu kyçyk iji ular* (Në Dibër të madhe ka shumë dijetar, por ky më i vogëli qenka më i miri)²¹. Kontributi i këtij patrioti të ulemasë shqiptare është i madh gjatë Shpalljes së Pavarësisë e më pas.

Hafiz Lila i lindur nga Golloborda, por aktivitetin e vet e bën në Dibër dhe më vonë në Gostivar dhe Strugë. Para pavarësisë së Shqipërisë kryen detyrën e drejtorit të “idadijes” në Dibër. Idadija e tij ishte mbushur plor me libra shqip. Në

18. Cit. sipas Jashar Rexhepagiqit, vep. e cit. f. 30.

19. Cit. sipas Nexhat Abazit, Zhvillimi arsimi dhe mendimi pedagogjik shqiptar në Maqedoni (1830-1912), Tetovë, 1977, f. 269.

20. Avzi Mustafa, Figura mësuesish shqiptarë, I. BKSH, Tetovë, 1975.

21. Qazim Xhelili, Vehbi Dibra, personalitet dhe veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare, albin, Tiranë 1998, f. 24.

vaaze e ndeja propagandonte dije islame e kulturë kombëtare. Ishte përkrahës i shkronjave shqipe sidomos para mbajtjes së Kongresit të Dibrës, ku e bindte masën e gjerë se vetëm shkronjat që krijojnë shkrimin shqip do të mund të përparojnë shqiptarët. “Ju e dini sa vështirë këndohet e mësohen shkronjat arabçe sa vite u duhet atyre që të lexojnë dhe përsëri nuk mund ta mësojnë.”

Po ashtu nga Dibra vjen edhe një fetar e filozof ku propagandonte besim fetar dhe kulturë kombëtare, Haxhi Hafiz Ismet Dibra. Në Kongresin e Dibrës ai mori pjesë si anëtar i thjeshtë. Thuhet se ishte një nacionalist i madh, edhe studentët e tij i mësonte me ndjenjat e dashurisë për Shqipërinë.²²

Një tjetër nga qyteti i Dibrës është edhe Haki Sharofi. Ishte njëri nga dishepujt e Said Najdenit. Fshehurazi e mësoi gjuhën shqipe me alfabetin e Stambollit. Ishte një nga kuadrot e para të Normales së Elbasanit. Mori pjesë aktive në veprimtarit atdhetare. Qysh në vitin 1909 hapi vullnetarisht kursin e gjuhës shqipe për shokët e lagjes së tij në livadhin e Qeranicës afër Dibrës. Në verë të vitit 1912 Haki Sharofi është në ballë të 50 studentëve që nënshkruan kërkesën drejtuar organeve lokale të qeverisë osmane për të mësuar në shkollë gjuhën shqipe me alfabetin latin, si pasojë e së cilës Shefqet Daiu nga Elbasani u emërua në Dibër mësues i gjuhës shqipe.²³

Kontribut të veçantë nga Dibra e Reka e Dibrës kanë dhënë edhe Hfz. Maliq Tanusha, nga Tanusha e Rekës, ithtar i zjarrrtë i Klubit të Stambollit,

22. Disa fetar patriot mysliman shqiptarë, Michigan USA, 1993, f. 106.

23. Vepër e cit. Disa fetar...faqe 152.

Hfz. Abdurrahim Dauti, propagandues dhe mësues i gjuhës shqipe, Sherif Langu etj.

Një personalitet mjaft interesant nga ulemaja shqiptare, e cila kishte për qëllim përhapjen e shqipes me shkronja arabe është edhe Abdylaqim Dogani nga Gostivari. Autor i shumë librave dhe një abetareje me shkronja turko arabe e konceptuar sipas parimit të gjuhës turke, lëvrues i teorisë së mësimin etj. Edhe pse na duket si njeri kontrovers, ai kërkonte me maturi t’i zgjidhë problemet. Unë do të jap vetëm një shembull kur atë e sjellin si profesor në Idadijen e Shkupit dhe zëvendëson patriotin e shquar Salih Gjuka nga Peja. Drejtori Sabri Xhemili, gjithashtu shqiptar – tregon Baba Qazim – na thirri dhe na tha se kemi marrë urdhër t’ju mësojmë shqip, por nuk kemi vend. Një gjakovar – Murat Gjakova – i tha drejtorit: “A nuk ka mundësi të na jepni zyrën tuaj e ju të kaloni në zyrën e profesorëve”. Na thamë: “Duam vetëm me këndue shqip, shkojmë edhe në akull”, mbas ditësh erdhi ministri i brendshëm i Perandorisë Haxhi Adil beu dhe apostafat për me na trembë, na e prunë në klasën tonë. Në prezencën e tij na pyeti drejtori: “Kush asht prej jush që do me këndue shqip me alfabet kaurr”. Na u çuam ma shumë se gjysma e klasës. Mësimet e shqipes vazhduan, por jashtë orarit zyrtar. Deri në kryengritje kemi këndue shqip. Por, na prunë si mësues Abdulhakim Himetin nga Gostivari, por ai ma tepër fliste turqisht. Shokët më shtynë me me u çue kundër tij se isha ma i ri e nuk më kapte ligji dhe kërkova që mos të vijë ma se nuk e dinte shqipen dhe mbas 4-5

mësimesh nuk erdhi ma.”²⁴

Mos ardhja e tij lidhet pikërisht me mos largimin e nxënësit Qazim të cilin e ka mbrojtur rreptësisht dhe si revolt për atë e lëshon shkollën²⁵. Po edhe ky si Rexhep Voka, abetaren e përgatiti për nxënësit shqiptarë për shkollën shqipe.

Po ashtu kontribut të veçantë ka dhënë edhe ulemaja e Shkupit me rrethinë. Këtu do të përmendi hoxhën e Patishka Rekës nga rrethi i Shkupit me emrin Hoxhë babë Musliu që talebeve (nxënësve) të vet ua mësonte shkronjat e gjuhës shqipe. Ky shkronjat i kishte shkruar në lëkurën e dhisë dhe e përdorte si postiqe, por kur u mbante mësimin atë postiqe ai ua tregonte shkronjat shqipe²⁶. Ky i kishte bindur edhe xhematin që të rrinë urtë dhe se u kishte thënë se nuk prishet feja me harfet (shkronjat). Krahas shërbesës fetare organizoi fëmijët e fshatit që të hapte një shkollë në gjuhën shqipe. Këtu nuk duhet ta anashkalojmë edhe Ataullah ef. Kurtishin nga fshati Studeniçan i Shkupit që vitet 1908 e pas të aftësohet dhe të mendojë edhe politikisht²⁷, kur nuk pranoi që në bazë të fesë të identifikohet populli shqiptar me turqit. Ai thoshte se edhe në Kur’an mbi 70 herë përmendet fjala “komb”e kombet

janë të ndryshëm, kurse feja mund të jetë e përbashkët. Ai kundërshtonte ligjet e Perandorisë që u njëhte vetëm identitetin fetar mysliman e të krishterë.

Sipas një dokumenti që gjendet në arkivin e Maqedonisë, dokumenti mban nr. 74 të 18 frorit (shkurtit) 1910, ku thuhet se “Turqit e rinj janë angazhuar që të organizojnë protestë kundër shkronjave latine të arnautëve. Nga shumë qytete kjo protestë nuk ishte e mirëpritur, kurse sukses ka pasur vetëm në Ohër, atje janë mbledhur 3.000 frymë”²⁸. Mirëpo në këtë protestë ishin mbledhur nga gjithë qytetet, kurse mospërkrahje dhe kundërshtime pikërisht kishin gjetur nga ulemaja e Strugës. Qerim hoxha, Nexhip hoxha, Tasim hoxha (imami), që nëpër xhamitë kishin kundërshtuar dhe kishin udhëzuar xhematin se “Zoti më parë popujve të tjerë nëpërmes të Dërguarit të vet u drejtohej në gjuhë të vet”²⁹. Ata kishin përsërit thënien e Hafiz Ali Korçës se “Shkronjat nuk kanë të bëjnë as me fenë e as me halifenë”. Hyrrijeti dështoi tani ne duhet të jemi të bashkuar për të mbrojtur e udhëzuar popullin në rrugë të drejtë.”

Në vargun e ulemave shqiptare nga trevat e Maqedonisë ka edhe shumë të tjerë që i kanë dhënë fizionominë kombit dhe e kanë mbajtur gjallë në momentet më delikate e më të vështira. Kjo dëshmon se gjatë ndërtimit të shtetit shqiptar nuk kemi pasur ndonjë kundërshtim me karakter masiv antishqiptar kur dihej se ata

24. Hasan Kaleshi, Disa aspekte të alfabetit të Stambollit.

25. Informatë nga Talat Afçe, gazetar në RTM në gjuhën shqipe dhe është i pari që shkroi një punim mbi Doganin.

26. Avzi Mustafa, Përpekja e shqiptarëve të Maqedonisë në mbrojtjen e alfabetit dhe shkollës shqipe, referat me rastin e 100-vjetorit të ABC-së shqipe, Shkup, 2008 (shih Avzi Mustafa, ww.ylliprees, www.zemrashqiptare.net.)

27. Mutalip Ademi, Atullah ef. Kurtishi, Hëna e Re, 1 shkurt 1994, f. 30.

28. Arkivi i Maqedonisë, dokumenti 1.19.173/207-208

29. Informatë që është përcjell brez pas brezi. (Q.D)

kishin xhematë njerëz të shtresave e të kulturave të ndryshme, kur atyre që u besonin më shumë nuk e keqpërdorën fenë për kundërshtime, por duke u udhëhequr nga parimet Kur'anore, ato treguan urtësi, tolerancë e respekt për gjuhën e shkollën shqipe. Ata në vazet e tyre nuk predikonin vetëm Njësimin e Zotit, por përgjithësimin e Tij se Zoti është i të gjithëve. Zoti është Krijuesi i botërave dhe i kombeve që do të thotë edhe i shqiptarëve.

Pra edhe ulemaja shqiptare, që ishte ushqyer me ndjenjat kombëtare në gjithë rrjedhën e ngjarjeve që përcaktojnë fatin e Shqipërisë, kanë pjesën e vet të

historisë, janë edhe ata pjesë e lavdisë shqiptare, kanë hyrë edhe ata në vargjet e lahutës shqiptare, kanë zënë edhe ata vendin e tyre në mozaikun e nderit kombëtar. Mjafton të kujtojmë këtu vargjet e Fishtës të "Lahuta e Malsise". Ja si këndon Homeri Shqiptar:

"Shtrine te ngratin hafiz Myslimin, dhe ne dru e rraben trimin

Sado qe ishte një "hafiz" "Jam shqiptar me gjuhe e fis"

*Jam Shqiptar përgjigjet Hafizi deri qe ashti i kambes i keris.*³⁰

30. Dh. Diriazi "Christianity in Albania" 2000.

Përdorimi i emrave myslimanë në Shqipëri: krahasim në tre periudha historike

**Ilir Akshija, M.D., M.Sc.
Spitali Universitar “Nënë Tereza”, Tiranë**

Abstrakt

Evidenca tregon lidhjen që ekziston ndërmjet emrave personalë dhe përkatësisë fetare, veçanërisht në pjesën më të moshuar të popullatës. Ky përfundim mbështetet nga studime që analizojnë frekuencën sipas prejardhjes së emrave dhe shpërndarjen e tyre gjeografike. Në këtë studim, ne kemi ndërtuar një rrjetë të dhënash nga pacientët e shtruar në spitalin më të madh në Shqipëri, të ndarë në tre periudha historike dhe kemi analizuar evolucionin e përdorimit të emrave myslimanë. Karakteristika fatlume e Shqipërisë është të qenit një pikë takimi e tre kategorive religjioze, Myslimanëve, të Krishterëve Katolikë dhe të Krishterëve Ortodoksë. Çfarë ka ndodhur dhe vlerësimi i tendencës së përdorimit të emrave myslimanë në popullatën e Shqipërisë, është diskutuar duke marrë në konsideratë tre periudha historike të ndara mirë nga njëra tjetra; 1904-1945, 1946-1991, dhe 1991-2011. Duke e konsideruar vendosjen e emrit të fëmijës si një procedurë gjuhësore, të lidhur ngushtësisht me identitetin e popullatës, jemi përpjekur ta trajtojmë këtë proces si reflektim të sjelljes kolektive gjatë proceseve historike në një vend me karakteristika specifike, si besimet fetare, gjeopolitike, etj.. Të dhënat tregojnë qartë zëvendësimin në kohë të emrave tradicionalë myslimanë me emra që qartësisht mbajnë gjurmët e periudhës historike që i përkasin. Pamundësia teknike e fokuson studimin vetëm në studimin e emrave myslimanë. Vendosja e emrit të fëmijës si pjesë e sjelljes kolektive tregon preferencat apo rezistencën e popullatës ndaj ndryshimeve sociopolitike dhe presionin apo sugjerimin e sistemit politik ndaj këtij komponenti. Një sjellje e tillë nuk është një ndryshim i menjëhershëm në kohë por rezultante e forcave që veprojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe me ndryshime të herëpashershme në shoqërinë Shqiptare.

Fjalëkyçe

Emra myslimanë; sjellje kolektive; sistem i emërimit; feja; data mining; bazë e të dhënave spitalore.

Hyrje

Shqipëria është një vend i vogël në gadishullin e Ballkanit, Evropa Juglindore. Popullsia e përgjithshme është 2,831,741.¹ Shqiptarët janë një vazhdimësi etnike e ilirëve, një popull i lashtë i Ballkanit, të cilët u përzien dhe luftuan me grekët, trakët dhe maqedonasit, para se të binin para sulmeve romake rreth kohës së Krishtit. Në shekujt XIV dhe XV, turqit osmanë sunduan në Ballkanin perëndimor. Nacionalizmi shqiptar u nxit për herë të parë në fund të shekullit të XIX, kur u duk qartë se Serbia, Mali i Zi, Bullgaria dhe Greqia donin të rrëmbejnë tokat shqiptare të populluara të Perandorisë Osmane. Pas dekadave të tëra trazira dhe humbjen e Perandorisë Osmane në Luftën e Parë Ballkanike në vitet 1912-1913, liderët shqiptarë e shpallën Shqipërinë një shtet të pavarur dhe Fuqitë e Mëdha të Evropës përcaktuan një Shqipëri të pavarur pas Luftës së Dytë Ballkanike të vitit 1913.² Pas çlirimit të Shqipërisë nga pushtimi nazist, vendi u bë një republikë socialiste, derisa Republika Popullore u shpërbë dhe zëvendësohet me Republikën e Shqipërisë, në epokën e demokracisë në vitin 1991.

Duke ju referuar historisë moderne Shqiptare të shekullit të XX-të, të

turbullt dhe të paqëndrueshme, mund të përcaktohen qartë tre periudha krejtësisht të ndryshme nga njëra tjetra me të cilat shqiptarët aktualisht të gjallë u detyruan të bashkëjetojnë. Presioni i hapur ndaj fesë dhe besimit është tipike e regjimit komunist. Ishte objektiv i PPSH-së të modifikonte sjelljen dhe qëndrimet e qytetarëve shqiptarë në mënyrë të tillë që «opinionit shoqëror» duhej të parandalonte «sjelljet antishoqërore», ndërsa të gjithë qytetarët duhej të shpallnin «luftë kundër borgjezisë, revizionizmit, feudalizmit, dhe ideologjive patriarkale» dhe «praktikave të prapambetura dhe paragjyqimeve fetare.»³ Ky presion shtetëror reflektohet në të gjitha dimensionet e jetës së përditshme. Me pak fjalë, Hoxha ndërtoi një regjim që merrej seriozisht me çdo aspekt të sjelljes dhe qëndrimeve individuale.⁴ Sidoqoftë, këto karakteristika nuk janë ekskluzive të regjimit komunist. Disa prej tyre janë produkt i pastër i ideologjisë komuniste, por përgjithësisht përzihen me karakteristika të tjera gjeopolitike. Në periudhën moderne të historisë shqiptare mund të shohim qartë gjurmët e politikës lokale dhe globale. Për shembull, mund të konstatohet, se emigracioni i Shqiptarëve dhe reaksioni i vendeve fqinjë ndaj këtij fenomeni ka karakteristika mjaft

1. INSTAT, 2011 Census-AL, Population and Housing Census of Albania 2001 / Census 2011, preliminary results, http://census.al/Resources/Data/Census2011/Instat_print%20.pdf

2. Albania: a country study / Federal Research Division, Library of Congress; edited by Raymond E. Zickel and Walter R. Iwaskiw, 2nd ed., ISBN: 0844407925, Washington, D.C. : The Division : For sale by the Supt. of Docs., U.S. G.P.O., 1994.

3. Bashkimi, January 12, 1973, p. 1.

4. Bowers, Stephen R., "Stalinism in Albania: Domestic Affairs under [1] [1] Enver Hoxha" (1989). Faculty Publications and Presentations. Paper 87; Helms School of Government http://digitalcommons.liberty.edu/gov?utm_source=digitalcommons.liberty.edu%2Fgov_fac_pubs%2F87&utm_medium=PDF&utm_campaign=PDFCoverPages

specifike. Migrimet Intra-Balkanike janë në mënyrë të paevitueshme të ndryshme nga karakteristikat normale të migrimit. Greqia e ka treguar veten në menaxhimin e emigracionit në mënyrë të qartë se është një vend ballkanik më tepër sesa një vend evropian.⁵

Ndikimi i këtyre periudhave në sfondin socio-kulturor të shqiptarëve është evident, si dhe ndikimi i tyre në emrat e popullatës lokale, i cili është argumenti i këtij studimi. Të ndarë në tri grupe fetare, Myslimanë, të Krishterë Katolikë dhe të Krishterë Ortodoksë, vetëm emrat myslimanë mund të studiohen. Emrat në dy grupet e tjera mbivendosen në mënyrë të konsiderueshme duke e bërë të pamundur identifikimin e saktë të përkatësisë së tyre.

Materiali dhe metoda

a. Materiali

Lista e emrave të përdorur në studim është ekstraktuar nga baza e të dhënave të Shërbimit të Statistikës, Qendra Spitalore Universitare, Tiranë, Shqipëri. Të dhënat konsistojnë në listat e plota të shtrimit, vitet 2005-2011, me origjinë nga dokumenti “kartelë klinike” dhe të ruajtura në format elektronik.⁶ Saktësia e të dhënave është shumë e lartë dhe përdoret për qëllime administrative, klinike dhe ligjore.

5. Martin Baldwin Edwards; Albanian emigration and the Greek labour market: Economic symbiosis and social ambiguity; SEER, South East Europe Review for Labor and Social Affairs), issue: 01/2004, pages: 5165, on www.ceool.com

6. Tirana University Hospital Center, “Mother Teresa”; Statistics Department, 2005-2011.

Karakteristikat sociodemografike, të tilla si emri, mbiemri, mosha, gjinia, vendi i lindjes dhe vendbanimi janë ekstraktuar nga baza e të dhënave origjinale. Literatura mbështet përdorimin e bazave të të dhënave të mëdha në zhvillimin e listave emërore. Të dhënat e censusit që përfshijnë emrin, vendin e lindjes, prejardhjen janë burime të shkëlqyera, që janë përdorur me sukses për zhvillimin e listave të mbiemrave.⁷

Vini re se, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” shërben si qendra e vetme e kujdesit terciar, gjatë periudhës së marrë në studim, për të gjithë popullatën e Shqipërisë dhe numri i personave të shtruar në spital gjatë kësaj periudhe është rreth 10% e popullsisë së Republikës së Shqipërisë. Ne kemi konsideruar që nuk ka diferenca domethënëse ndërmjet grupeve sipas të cilëve ne kemi realizuar ndarjen, që i përfaqëson komuniteteve fetare respektive, veçanërisht gjatë kohës së komunizmit kur Shqipëria ishte vetëdeklaruar një vend ateist dhe periudhës së demokracisë, prandaj edhe konsiderohet si popullatë përfaqësuese e të gjithë popullatës së Republikës së Shqipërisë. Nëse kjo konsideratë nuk është e vërtetë apo nuk merret parasysh dhe mendohet se ka ndryshime domethënëse në stilin e jetesës dhe aksesit në shërbimet shëndetësore sipas besimeve fetare, përsëri nuk ka influencë në studimin e emrave myslimanë si një fenomen i shpërndarë, përdorimit dhe tendencave në kohë të tyre.

7. Kiumarss Nasser; Construction and validation of a list of common Middle Eastern surnames for epidemiological research; Cancer Detect Prev. 2007 ; 31(5): 424-429.

b. Metoda

Njohja dhe klasifikimi i emrave personalë në një tekst të caktuar (p.sh., personi, vendndodhja dhe organizata) kohët fundit është konsideruar si e një rëndësie madhore në *Natural Language Processing (NLP)*, meqenëse luan një rol domethënës në lloje të ndryshme aplikimesh të NLP, veçanërisht në *Information Extraction, Information Retrieval, Machine Translation, Syntactic Parsing/Chunking, Question-Answering*, ndërmjet të tjerave. Informacioni i vlefshëm në një tekst zakonisht lokalizohet duke pasur në qendër emrin personal, prandaj mbledhja e këtij informacioni fillon me gjetjen e tij si hap i parë i këtyre proceseve.⁸ Në vazhdim kemi paraqitur një përshkrim të shkurtër të ndërtimit të emrit arab, si rrënjë e shumicës së emrave myslimanë, madje edhe në gjuhë të tjera dhe ne fokusohemi tek kategoria *ism*, e përdorur e plotë dhe gjerësisht në traditën Shqiptare të vendosjes së emrave të fëmijëve. Gjuha Arabe ka praktika të mirë përcaktuara të vendosjes së emrave. Elementët përbërës të emrave arabë mund të ndahen në pesë kategori kryesore, Ibn Auda (2003):

1. Një **ism** (shqiptohet ISM, si rrokja e fundit tek fjala *dogmatism[ang.]*), një emër personal që vendoset pak kohë pas lindjes. Shembuj emrash të tillë janë *Mubam-mad* [Muhamed], *Musa* [Moisi], *Ibrahim* [Abraham].

2. Një **kunya** (shqiptohet KOON-jah), një emër apo mbiemër honorifik,

8. Saleem Abuleil 2004. Extracting Names from Arabic Text for Question-Answering Systems, In Proceed-ings of Coupling approaches, coupling media and coupling languages for information retrieval (RIAO 2004), Avignon, France. pp. 638- 647.

si babai ose nëna e dikujt; p.sh., *abu Da'ud* [babai i Davidit], *umm Salim* [nëna e Selimit]. Ka qëllim të luaj rolin e prefiksit ose në shenjë respekti. Personat e martuar (veçanërisht gratë e martuara) si rregull i përgjithshëm thirren me *kunya* e tyre (*abu* ose *umm* + emrin e fëmijës së parëlindur). Kur përdoret emri i plotë i personit, *kunya* paraprin emrin personal: *Abu Yusuf Hasan* [i ati i Jusufit, Hasani], *Umm Ja'far Aminah* [nëna e Xhaferrit, Amina].

3. Nga një **nasab** (shqiptohet NAH-sahb), tregues i trungut familjar, si e bija ose i biri i dikujt; p.sh., *ibn 'Umar* [i biri i Omerit], *bint 'Abbas* [e bija e Abazit]. *Nasabi* ndjek *ism-in* në përdorim: *Hasan ibn Faraxh* [Hasani i biri i Faraxhit], *Sumajja bint Khubbat* [Sumaja e bija e Khubatit]. Mjaft personazhe historike janë më të njohur nga *nasab-i* tyre se sa nga *ism-i*: p.sh., historiani *ibn Khaldun*, udhëtari *ibn Battuta*, dhe filozofi *ibn Sina* [Avicena]. *Nasab-i* mund të zgjatet në disa breza, siç mund të shikohet në shembullin e mëposhtëm që përmban nasabin e dy brezave: Abu al-Qasim Mansur **ibn** al-Zabriqan **ibn** Salamah al-Namari

4. Një **lakab** (shqiptohet LAH-kahb), kombinim fjalësh në një dyemëror ose epitete, zakonisht fetar, që lidhet me natyrën, përshkrues, ose të ndonjë vetie të admirueshme karakteristike e personit në fjalë (ose do të dëshironte të kishte); p.sh., *al-Rashid* [i Drejtëudhëzuar], *al-Fadl* [i Shquar]. *Laqab-i* ndjek *ism-in*: *Harun al-Rashid* [Haruni i Drejtudhëzuar].

5. Një **nisba** (shqiptohet NISS-bah), emër me origjinë nga: zanati apo biznesi, vendbanimi ose vendlindja,

përkatësia fetare e personit në fjalë. Mund të përmendet; p.sh., *al-Hallaxh* [mbulesë prej pambuku], *Al Msri* [Egjiptjani], *Islami* [Islamik]. Nisba ndjek ism-in ose, nëse emri përmban një nasab (sado brezash qoftë), zakonisht ndjekin nasab-in.⁹

Kriteret e përcaktues të përfshirjes së emrave myslimanë janë vendosur si më poshtë:

- Emrat personalë të Profetit (s.a.v.s.), familjes së tij, pasardhësve dhe shokëve (*sahabeve*).
- Emrat e profetëve nga Kur’ani.
- Emrat e Allahut (xh.sh.) të lejuar dhe të përbërë, për përdorim nga njerëzit.
- Emra tipikë turq, persë, etj.
- Emra florealë (lule, pemë), kafshësh (zogji, gjitarë), vendesh (të dyja botët), fenomene natyrore, etj., me origjinë Islame, Turke, Perse dhe Arabe.
- Emra që tregojnë cilësi, epitete dhe llagape.
- Emra të njerëzve të shenjtë (*evlija*), dijetarëve (*arifëve*), të gjetur në historinë e Islamit.

Të njëjtat kriteret mund të përdoren si kriteret përfshirës për emrat e Krishterë; vështirësia qëndron në kategorizimin e tyre si Katolik apo Ortodoks, të cilët mbivendosen. Emra

tipikë të kësaj kategorie janë emrat e apostujve të Krishterë, si Gjon (ang. John), Pal (ang. Paul), Filip (ang. Philip), etj.

Baza e të dhënave e përfituar në këtë mënyrë është një rrjetë periudhash, emrash sipas përkatësive fetare dhe pjesa tjetër e variablave, që mbetet e paprekur gjatë procesit të kodifikimit, ashtu siç janë tërhequr nga baza origjinale e të dhënave. Kodifikimi është përsëritur dy herë dhe gjithashtu është mbështetur me kontrolle të cilësisë së kodifikimit. Parimi “i përkatësive fetare të emrit” konsiston në kodimin si emra myslimanë vetëm emrat që përmbushin kriteret e përfshirjes në studim, duke lënë jashtë kësaj kategorie edhe emrat me dyshimin më të vogël për origjinën e tyre. Mendojmë se një metodë e tillë mund ta zvogëlojë në mënyrë jodomethënëse përqindjen e totalit të emrave myslimanë, por nuk prek rezultatet e studimit sepse emrat me frekuencë më të lartë, të konsideruar si përgjegjës për analizimin e tendencës mbeten të paprekur.

Variablat që paraqesin ‘*periudhën*’ dhe ‘*emrin*’ janë kodifikuar sipas kriterëve përfshirës. Tre periudha janë përcaktuar, 1904-1945, 1946-1991, 1991-2011. Ndërsa emrat janë kodifikuar si, “*myslimanë*” (1), “*jo e sigurtë*” (2), “*jomyslimanë*” (3). Periudha I, 1904-1945, është quajtur periudha osmane, mbretërore dhe e pushtimit nazist; Periudha II, 1946-1991, periudha komunizmit, e quajtur edhe si Republika Popullore dhe Periudha III, 1991-2011, periudha e demokracisë, e quajtur edhe si Republika e Shqipërisë.

Kur është konsideruar e nevojshme kemi realizuar transliterimin e emrave

9. Khaled Shaalan, Hafsa Raza; Person Name Entity Recognition for Arabic; Proceedings of the 5th Workshop on Important Unresolved Matters, pages 17–24, Prague, Czech Republic, June 2007. c2007 Association for Computational Linguistics.

nga Shqipja në Anglisht. Lista (**Tab. 5**) përbëhet nga 50 emrat me frekuencë më të shpeshtë. Ngjashmëria në shkrimin e këtyre emrave në të dy gjuhët është e dukshme, ndërsa në shqiptim ka mjaft ndryshim. Transliterimi është realizuar duke u nisur nga njohja e gjuhës shqipe si gjuhë amtare dhe duke ndjekur në mënyrë strikte rregullin në vazhdim. Me Romanizim i referohemi çdo përkthimi ose interpretimi të fjalëve nga sisteme shkrimi jo-Latine në gjuhë që përdorin alfabetin Latin. Transliterimi i referohet në mënyrë më specifike një sistemi preciz hartëzimi të një sistemi shkrimi në një tjetër, shpeshherë shkronjë pas shkronje, kështu që lexuesi nuk ka paqartësi për fjalën e transliteruar për mënyrën e shqiptimit në gjuhën origjinale.¹⁰

Rregullat metodologjike të vendosura gjatë studimit mund të jenë një fushë studimi e mëtejshme, si kombinimi i kodifikimit manual, i konsideruar me sensitivitet të lartë, mund të përdoret në të ardhmen e afërme e kombinuar me sisteme njohje elektronike, akoma në zhvillim e sipër. Aktualisht sisteme të tilla ekzistojnë. Rregullin në fjalë bazohet në përafrimet me output-et e prodhuara nga Buckwalter Arabic Morphological Analyser (BAMA), dhe përdorimi i një seti fjalëkyçesh, që na udhëheqin në fjalitë që me shumë mundësi përmbajnë emra personale.¹¹

Plani analitik konsiston në studimin deskriptiv të datasetit të krijuar, kryesisht nëpërmjet ndërtimit të krostabulimeve dhe paraqitjes së tyre në mënyrë grafike. Hartëzimi i të dhënave është realizuar duke shfrytëzuar ndarjen administrative në kohën e mbledhjes së të dhënave, e cila e ndan Shqipërinë në 36 rrethe.

Rezultatet

Lista e plotë është e përbërë nga 401.274 shtrime spitalore. Nga kjo listë janë larguar rishtrimet meqenëse nuk janë raste unike. Numri i rishtrimeve është 110.716 (27.6%) dhe baza e të dhënave të mbetura dhe të përdorura në studim është 290.558 (72.4%) raste unike të shtrimeve spitalore. **Tab. 1** paraqet shpërndarjen e popullatës së pranuar në spital sipas periudhës historike në të cilën ata kanë lindur, data e lindjes e vendos personin automatikisht në periudhën historike kur ka lindur.

Tabela 1. Shtrimet spitalore sipas periudhës së lindjes në momentin e shtrimit në spital, pacientë nga Qendra Spitalore Universitare, “Nënë Tereza”, Tiranë:

	Viti	Nr.	Përqindje	Definicioni
Periudha I	1904 - 1945	65.095	22.4	osmane, mbretërore dhe e pushtimit nazist
Periudha II	1946 - 1991	146.900	50.6	komuniste, e quajtur edhe Republikë Popullore

10. Heather Hedden; Arabic names; Centrepiece to *The Indexer* Vol. 25 No. 3 April 2007.

11. Ali Elsebai, Farid Meziane, Fatma Zohra Belkredim; A Rule Based Persons Names Arabic Extraction System; Communications of the IBIMA, Volume 11, 2009 ISSN: 1943-7765.

Studime

Periudha III	1992 -2011	78.563	27.0	demokratike, e quajtur edhe Republika e Shqipërisë
Totali	1904 -2011	290.558	100.0	

Ndërkohë, e njëjta shpërndarje në **Tab. 2** na paraqet të njëjtën popullatë të klasifikuar në kategori të emrave sipas përkatësisë fetare. Emrat që përmbushin kriteret e vendosura që të konsiderohen emra myslimanë rezultojnë në **63.3% (64.97% në Tiranë, kryeqyteti)** për periudhën e parë, 1904-1945, osmane, mbretërore dhe e pushtimit nazist; **32.8%** periudha e dytë, 1946-1991, periudha e komunizmit dhe **7.1%** për periudhën e tretë, periudha e demokracisë, 1991-2011.

Tabela 2. Emrat e kodifikuar sipas origjinës së përkatësisë fetare që përmbushin kriteret e përfshirjes:

Myslimanë			Të tjerë		
Totali		Nr.	Përqindje	Nr.	Përqindje
Periudha I	65.095	41.213	63.3	23.882	36.7
Periudha II	146.900	48.226	32.8	98.674	67.2
Periudha III	78.563	5.556	7.1	73.007	92.9
Totali	290.558	94.995	32.7	195.563	67.3

Mund të shikojmë në kategorinë periudha e parë, dy nëngrupet kanë pothuajse të njëjtën paraqitje sipas moshës. ‘Emrat Myslimanë’ (71.2 ± 6.5 vjeç, $n = 41.213$) dhe kategoria ‘të tjerë’ (71.0 ± 6.6 vjeç, $n = 23.882$).

Interesant është paraqitja grafike në **Fig. 1**, që tregon shpërndarjen e emrave myslimanë të periudhës së parë, 1904-1945. Prezantimi geografik është bazuar në ndarjen administrative të Shqipërisë në kohën e pranimin në spital të këtij grupi pacientësh, i cili e ndan vendin në rrethe dhe mundëson paraqitje të detajuar të shpërndarjes së të dhënave. Harta e gjeneruar përputhet me saktësi me vendosjen e komuniteteve fetare në vend, duke përforcuar edhe një herë lidhjen e fortë midis origjinës së emrit dhe përkatësisë fetare, veçanërisht në periudhën e hershme.

Duke hyrë më tej në detaje, numrat në **Tab. 3** vazhdojnë t’i referohen periudhës së parë, ku nga 65.095 njerëz të shtruar në spital nga kjo grup-moshë, shohim se 10.632 (16.3%) janë klasifikuar në nënkategorinë ‘jo e sigurt’. Në këtë nënkategori janë klasifikuar të gjithë emrat të cilët nuk i plotësojnë kriteret e përfshirjes si “emra myslimanë” ose ‘jomyslimanë’, gjithashtu edhe emrat me origjinë të dyshimtë.

Figura 1. Harta e shpërndarjes së emrave myslimanë për periudhën e I-rë, 1904-1945.




Tabela 3. Rezultatet e kodifikimit, periudha e parë, 1904 – 1945.

Periudha I	Nr.	Përqindje
Myslimanë	41.213	63.31
Jo e sigurt	10.632	16.33
Jo myslimanë	13.250	20.35

Këta janë emra tipikë shqiptarë që e kanë origjinën në fillim të shekullit të XX-të dhe përdorimi i tyre rritet vazhdimisht me kalimin e kohës. Këto emra përdoren diku më shumë e diku më pak nga të gjitha komunitetet fetare dhe është teknikisht e pamundur të dallohet me qartësi se cilit komunitet i përkasin. Realizuar një përpjekje

për kodifikimin e këtyre emrave duke përdorur mbiemrat dhe nuk kishte rezultat sepse ishte e pamundur vendosja e kriterëve të përfshirjes për kodifikim, madje edhe duke përfshirë edhe atësinë. Kjo del jashtë mundësive teknike në dispozicion. Disa emra tipikë të kësaj kategorie janë Liri (ang. Liberty) që konsiston në 308 (0.47%) dhe Drita (ang. Light) që konsiston në 249 (0.38%) të emrave në këtë kategori.

Fig. 2 shpjegon fenomenin e mësipërm në një paraqitje grafike. Në këtë grup “të ri” emrash që fillon të “luftojë” emrat “e vjetër” i sjell shqiptarët tek emrat që ata sot përdorin.

ndërmjet dy kolonave është e qartë dhe evolucioni morfologjik është minimal. Emri më i përdorur është Fatime, që përbën 517 (0.79%) të totalit të emrave myslimanë në periudhën e parë, 589 (0.40%) të emrave në periudhën e dytë dhe 37 (0.05%) të emrave në periudhën e tretë. Në kategorinë e emrave mashkullorë myslimanë, emri Ali, përbën 418 (0.64%) të totalit të emrave Myslimanë në periudhën e parë, 371 (0.25%) të emrave në periudhën e dytë dhe 54 (0.07%) të emrave në periudhën e tretë. Ndërsa, në një studim të emrave në popullatën e Kajros, Egjipt emri Ali arrin frekuencën e 3.1% të përdorimit




Figura 2. Rezultatet e kodifikimit, periudha e I-rë, 1904 – 1945.

Ndërsa **Tab. 2** tregon shpërndarjen e fenomenit në të gjithë popullatën, **Tab. 4** (e vendosur në fund, para Referencave) tregon se çfarë ka ndodhur me 50 emrat myslimanë më të shpeshtë gjatë tre periudhave të studimit. Në kolonën ngjitur me emrin në gjuhën shqipe është transliterimi në anglisht, duke ju referuar emrit në gjuhën Arabe, Turke dhe Perse nga perspektiva e gjuhës nga e kanë prejardhjen. Ngjashmëria

në totalin e popullatës. Studimi ishte realizuar në vitin 1961.¹² Në studimin tonë, grupi i 50 emrave më të shpeshtë është përgjegjës për mbulimin me emra, respektivisht në tre periudhat, për 17.69%, 7.89 dhe 1.95% të emrave myslimanë. 12 (4.05%) e elementëve të listës janë femra dhe pjesa tjetër 38 (13.64%) të elementëve janë emra mashkullorë.

12. Ali Elsebai, [a] Regional Seminar on Bibliography Documentation and Exchange of Publications in Arabic Speaking States; Dr. Mahmud Sheniti; UNESCO/LBA/Sem. 8/2, Paris, November 1961.

Diskutim

Përdorimi i emrave personalë mund të jetë një diskutim i morfologjisë, demografisë, sociologjisë dhe religjionit, me ndryshime në dizenjimin e studimit, rezultateve dhe interpretimeve. Ne kemi zgjedhur ta vështrojmë problemin si një sjellje kolektive shoqërore, duke mos harruar edhe aspektet e tjera. Duke e konsideruar vendosjen e emrit të fëmijës si një veprim specifik lingvistik, i lidhur ngushtësisht me vlerat, traditat, shpresat dhe ngjarjet në jetët e njerëzve. Emrat tregojnë shumë nga preferencat e mbartësve të tyre (ose të atyre që kanë marrë përsipër vënie e emrit) dhe që lidhen me objekte nga jeta e vërtetë, veprime, karakteristika dhe besime (Rosenhouse, 2002).¹³ Sipas definicionit të mësipërm, vendosja e emrit të fëmijës duket që nuk është një akt i thjeshtë, i vendosur në një moment të izoluar në kohë dhe një vendim i vetëm familjarëve të afërm. Në të vërtetë, është një akt kompleks, i përbërë nga shumë forca të dukshme apo të padukshme, që rezultojnë me zgjedhjen e emrit.

Në disa raste, vetëm për të krijuar një ide minimale rreth diversitetit të fenomenit, emrat mund të marrin rrënjë nga origjina të paimagjinueshme. Kur emri vendoset duke pasur në mendje një qytet apo një shtet, reflekton ndjenjat që emërvënësi ka për qytetin, shtetin ose kontinentin, ose që i porsalinduri që merr emrin të ketë karakteristikat e bukurisë së vendit nga është marrë emri. Në vazhdim janë disa shembuj

13. Personal Names in Hebrew and Arabic: Modern Trends Compared to the Past; Rosenhouse J.; *Journal of Semitic Studies*, Volume 47, Number 1, 2002, pp. 97-114(18).

që i përkasin kësaj kategorie: Barees “Paris”, Qaherah “Kairo”, Feefa, Qandahar, Doha, Tal Abeebe “Tel Aviv”, Faransa “Francë”, Surja “Siria”, Lobnan “Liban”, Amerika “Amerika”, Libja “Libia”, Almania “Gjermani”, Afgan, Aspania “Spanjë”, Italia, Tunes “Tunizi”, Qatar, Hend, Bagdad, Imarat, dhe madje edhe emra kontinentesh si Asia dhe Afrika “Afrika”.¹⁴

Tre periudhat janë të mirë përcaktuara historikisht. Specifika e Shqipërisë gjatë këtyre tre periudhave është pozicionimi i qartë në kufirin e ndodhjes së ngjarjeve të mëdha, që u dhanë edhe formën këtyre periudhave historike. Shqipëria ishte e vendosur në kufirin e Perandorisë Osmane, në kufirin e pushtimeve të Italisë fashiste dhe më vonë në kufirin e kampit komunist. Sot, është e vendosur në kufirin e ndryshimeve demokratike, gjeografike dhe psikologjike moderne. Ndryshe nga çfarë thotë propaganda zyrtare, asnjëherë nuk ka ndodhur që e gjithë popullata të jetë pjesë e një kampi të caktuar ideologjik. Deklaratë tipike e propagandës së shtrembëruar është pretendimi komunist që të gjithë Shqiptarët janë ateistë dhe Shqipëria është një vend ateist. Të vendosur në dy anët e barrikadave ideologjike, dhe jo vetëm, dhe të bindur që zgjidhja e tyre ka qenë ajo më e drejta dhe më e ndershmeja, sjellja shoqërore e Shqiptarëve reflektohet me intensitet edhe në procesin e vendosjes së emrave të fëmijëve.

14. A Socio-Cultural and Linguistic Analysis Of Yemeni Arabic Personal Names; *Abdul Wahed Qasem Ghaleb Al-Zumor*; *GEMA Online Journal of Language Studies* 15 Volume (2) 2009.

Fenomeni i vendosjes së emrave të fëmijëve është reflektim, ndoshta edhe i shtrembëruar, i realiteteve historike të rajonit. Përdorimi i emrave myslimanë gjithashtu duhet konsideruar si vlerësim relativ i fenomenit. Popullata shqiptare gjatë shekullit të XX-të ka qenë me mazhorancë myslimane dhe të gjitha matjet e konfirmojnë këtë fakt. Në studimin tonë shohim që përdorimi i emrave myslimanë mbulon një pjesë të mirë të popullatës, rreth **63.3%** në periudhën e parë. Ky studim e konsideron evenimentin e vendosjes së emrit, në secilën nga periudhat pa dallim, një ngjarje ndërmjet zgjedhjes dhe detyrimit. Një zgjedhje e pastër apo manipuluese ose detyrimi me dhunë apo me demagogji, kjo është e pamundur për t'u konfirmuar rast pas rasti.

E vërteta në shifra, na tregon, që përdorimi i emrave myslimanë në popullatën myslimane gjatë periudhës së komunizmit është sa gjysma e periudhës paraardhëse, dhe sot ndan vetëm 7.1%. Këta emra, shumë prej tyre janë edhe një urim për jetën që e pret fëmijën në të ardhmen, ndërtohen shpesh duke përdorur procedura produktive morfologjike.¹⁵ Të dhënat e Censurit të vitit 2011 tregojnë që popullata myslimane nuk është duke u zhdukur, por përdorimi i emrave myslimanë tradicionalë është gjithnjë në rënie.

Në rastin tonë mund të identifikojmë dy tendenca, të cilat janë:

a. Zhvendosje nga emrat myslimanë drejt emrave shqiptarë autoktonë, si Shpresa, Kujtim, etj.

15. Cross- and trans-language morphology; The lexicography of Indonesian names; Dick Van Der Meij; Wacana, Vol. 12 No.2 (October 2010): 345-368.

b. Zëvendësimin me emrat të rinj myslimanë si Medina ose Amir (Amr).

Ky studim arrin t'i identifikojë këto probleme por nuk merr përsipër matjen e këtyre dy fenomeneve. Megjithatë mund të vihet re që popullata mund të bëjë kompromise me forcat që ushtrojnë presion po asnjëherë nuk dorëzohet plotësisht. Kanë zgjedhur emrin Kujtim, por jo emrin Marenglen (Marx-Engels-Lenin) edhe pse ky i fundit mund të haset në mënyrë sporadike. Marenglen është një emër i preferuar nga nomenklatura komuniste. Së fundmi mund të themi se këto emra origjinalë shqiptarë ishte e pamundur të kategorizoheshin si tipikë të cilitdo besim fetar.

Në listën e shkurtër me emrat më të shpeshtë të emrave më të përdorshëm myslimanë, raporti i meshkujve ndaj femrave është tre herë më i madh. Kjo të krijon idenë që pjesa tjetër e listës ofron një variacion shumë më të madh në emrat e gjinisë femërore, duke i ofruar kësaj kategorie kënaqësinë e një mundësie më të madhe për zgjedhjen e emrit.

Duke u rikthyer tek sjellja shoqërore mund të themi se klasifikimi i saj është mjaft i ndryshëm sipas pozicionimit të filozofive të zgjedhura për t'i qëndruar besnikë. Këto klasifikime gjejnë një numër të jashtëzakonshëm shkaqesh të sjelljes shoqërore, duke bërë të pamundur krijimin e një seti universal kriteresh gjykim. Sjellja kolektive mund të studiohet duke iu referuar një shkollë apo modeli të caktuar, por nuk mund të jetë shteruese. Modele të ndryshme ofrojnë përafrime të ndryshme dhe studimet nuk mund të konsiderohen krejtësisht të sakta apo të gabuara,

përveçse kur shikohen nga pozicione të përzgjedhura perspektive.¹⁶ Në disa raste sjellja shoqërore kolektive konsiderohet edhe si një proces evolucionar, p.sh., që suksesi kulturor çon në sukses biologjik.¹⁷ Jo të gjitha perspektivat bien dakord në këtë pikë.

Rëndësi ka të theksohet që ambienti kompetitiv evolucionar duke ushtruar presionin e tij përzgjedhës nuk ka në vetvete mekanizma të gatshëm që favorizojnë sjellje të caktuara.¹⁸ Të tjerë autorë e konsiderojnë adaptimin e sjelljes si fenomen me rregulla të pandryshueshme.¹⁹

Kompleksiteti i zgjedhjeve sociologjike për ta parë problemin i hap derën mjaft diskutimeve beninjë, ndërsa ne ndalemi në pikën e prezantimit të të dhënave tona sasiore, kompleksitetin e problemit dhe ndërtimin e strukturës së forcave në lojë.

Konkluzione

Vendosja e emrave personalë të fëmijëve është një proces gjithnjë në ndryshim dhe i prek të gjitha shoqëritë.

16. Benno Torgler; The importance of faith: Tax morale and religiosity; *Journal of Economic Behavior & Organization*; Vol. 61 (2006) 81–109; © 2005 Elsevier

17. Napoleon A. Chagnon; *Life Histories, Blood Revenge, and Warfare in a Tribal Population*; *Science, New Series*, Vol. 239, No. 4843. (Feb. 26, 1988), pp. 985-992.

18. Moritz Hetzer, Didier Sornette; *The Co-Evolution of Fairness Preferences and Costly Punishment*; *PLOS ONE*, www.plosone.org 2; March 2013, Volume 8, Issue 3, e54308.

19. S. R. Musse, D. Thalmann; *A Model of Human Crowd Behavior: Group Inter-Relationship and Collision Detection Analysis*.

Shoqëria shqiptare sigurisht që është e prekshme ndaj këtyre ndryshimeve. Këto ndryshime janë komplekse, janë të vazhdueshme në kohë dhe e kanë filluesën si tendenca në kohë nga ndryshimet madhore historike. Studimi jonë merr përsipër të provojë këto tendenca dhe ndryshime. Fenomeni nuk është lokal dhe shumë studime e provojnë duke e konsideruar si pjesë të ndryshimeve globale por me specifika lokale. Arabët dhe hebrenjtë tentojnë t'i ripërtërijnë emrat në kohë, por ndryshimet në strukturën sociale dhe kulturore çojnë në rezultate që ndryshojnë në shumë aspekte.²⁰ Fenomeni është global, por amplituda e shfaqjes së tij paraqitet me karakteristikat lokale dhe duhet të jetë subjekt i studimit të mëtejshëm meqenëse edhe forcat që veprojnë brenda dhe jashtë një shoqërie janë specifike sipas gjeografisë dhe kulturës.

Duke u sjellë ndërmjet frikës dhe shpresës dhe duke përfshirë të gjithë popullatën, ky proces nuk mund të jetë i pavarur nga forcat që veprojnë në histori. Qëndrimi i regjimit qeverisës ndaj fesë dhe besimit dhe sjellja e popullatës lokale reflektohet në antropometri.

Cilat janë shifrat e përkatësive fetare në Shqipëri? A janë treguesit në disponim të besueshëm? Si kanë ndryshuar në kohë?

Me të vërtetë që këto pyetje nuk kanë përbërë shqetësim për popullatën e Shqipërisë, ndërsa mund të kenë qenë prioritet i strukturave dhe personave të caktuar që herë pas herë nxjerrin edhe konkluzione. Për shqiptarët, autori

20. Rosenhouse J.; *Personal Names in Hebrew and Arabic: Modern Trends Compared to the Past*; *Journal of Semitic Studies*, Volume 47, Number 1, 2002, pp. 97-114(18).

shpreh në këtë rast pikëpamjet personale, feja dhe besimi janë vlera me rëndësi fundamentale dhe si vlera të tilla respektimi ndërmjet feve është detyrim. Kjo është arritur në mënyrë të përsosur dhe është e vështirë të gjendet një rast i ngjashëm në të gjithë botën.

Studimi nuk ndjek qëllimin e përcaktimit të përkatësive fetare, madje e ka të pamundur, aq më tepër që emrat “e modës së vjetër” janë zëvendësuar me emrat “e modës së re”. Në sfondin unik të realitetit shqiptar, emri mbetet një kontribut i vlefshëm në ruajtjen e vlerave dhe promovimin e vlerave të reja dhe gjithashtu një pasqyrim i sjelljes kolektive të shqiptarëve. Diku duke rezistuar ndryshimin e emrave, duke i konsideruar si vlera fetare, diku duke e quajtur domosdoshmëri ndryshimin e tyre, diku duke bërë kompromise dhe diku duke pranuar me kënaqësi, mund të kapim një pasqyrim të realitetit shumë të paqëndrueshëm shqiptar nëpërmjet këtij fenomeni.

Një rekomandim mund të jetë raportimi vullnetar i përkatësisë fetare gjatë procedurave të pranimit në spital. Studimi i forcave që qeverisin dhe drejtojnë shoqërinë shqiptare mund ta ketë fillësën nga ky studim por kërkon pjesëmarrjen e specialistëve nga shumë fusha të tjera. Shembull i studimit të një prej këtyre komponentëve mund të jetë studimi i stigmës. Mjaft procese psikologjike dhe të sjelljes shkatërrohen nga stigma.²¹

Kjo sjellje kolektive e Shqiptarëve ndaj këtij fenomeni mund të konsiderohet një tregues i fuqishëm i zgjedhjeve të përbashkëta, që ata po bëjnë sot dhe mund të hedhë një shikim rreth tendencave për të ardhmen e këtij komuniteti. Kjo sjellje kolektive, duhet të rikujtojmë që nuk është një sjellje momentale e kësaj popullate, por rezultante e forcave që ndryshojnë në kohë dhe bashkëveprojnë me preferencat e tyre.

Tabela 4. Shpërndarja e 50 emrave myslimanë më të shpeshtë sipas periudhës së lindjes

	Emri në shqip	Transliterimi në anglisht	Gjinia	P I	P I	P I	P II	P II	P II	P III	P III	P III
				n	% e emrave Muslimanë	Përqindja kumulative	n	% e emrave Muslimanë	Përqindja kumulative	n	% e emrave Muslimanë	Përqindja kumulative
1	Fatime	Fathima	F	517	0.79	0.79	589	0.40	0.40	37	0.05	0.05
2	Ali	Ali	M	418	0.64	1.44	371	0.25	0.65	54	0.07	0.12

21. Mark L. Hatzenbuehler, Jo C. Phelan, Bruce G. Link; Stigma as a Fundamental Cause of Population Health Inequalities; Am J Public Health. 2013 May; 103(5): 813–821.

Studime

3	Bajram	Bayram	M	378	0.58	2.02	335	0.23	0.88	109	0.14	0.25
4	Hysen	Husain	M	364	0.56	2.58	269	0.18	1.06	43	0.05	0.31
5	Hasan	Hassan	M	340	0.52	3.10	286	0.19	1.26	35	0.04	0.35
6	Skender	Iskandar	M	320	0.49	3.59	489	0.33	1.59	29	0.04	0.39
7	Xhemal	Jamal	M	305	0.47	4.06	231	0.16	1.75	38	0.05	0.44
8	Ramazan	Ramadan	M	288	0.44	4.50	322	0.22	1.97	86	0.11	0.55
9	Muharrem	Muharrem	M	286	0.44	4.94	212	0.14	2.11	36	0.05	0.59
10	Rexhep	Rajab	M	280	0.43	5.37	239	0.16	2.28	31	0.04	0.63
11	Gani	Ghanim	M	279	0.43	5.80	179	0.12	2.40	21	0.03	0.66
12	Ibrahim	Ibrahim	M	278	0.43	6.23	198	0.13	2.53	68	0.09	0.75
13	Ismail	Ismail	M	274	0.42	6.65	307	0.21	2.74	61	0.08	0.82
14	Shaban	Shabaan	M	254	0.39	7.04	218	0.15	2.89	26	0.03	0.86
15	Qemal	Kamal	M	247	0.38	7.42	324	0.22	3.11	19	0.02	0.88
16	Haxhi	Haji	M	241	0.37	7.79	247	0.17	3.28	33	0.04	0.92
17	Mustafa	Mustafa	M	225	0.35	8.13	194	0.13	3.41	36	0.05	0.97
18	Mehmet	Mehmet	M	224	0.34	8.48	234	0.16	3.57	39	0.05	1.02
19	Sulejman	Sulayman	M	224	0.34	8.82	165	0.11	3.68	28	0.04	1.06
20	Ramadan	Ramadan	M	221	0.34	9.16	198	0.13	3.82	19	0.02	1.08
21	Shefqet	Shaukat	M	220	0.34	9.50	186	0.13	3.94	20	0.03	1.10
22	Hajrie	Hayrah	F	216	0.33	9.83	262	0.18	4.12	18	0.02	1.13
23	Sanie	Saniyah	F	216	0.33	10.16	197	0.13	4.26	16	0.02	1.15
24	Xhemile	Jamilah	F	212	0.33	10.49	301	0.20	4.46	20	0.03	1.17
25	Hatixhe	Khadeeja	F	210	0.32	10.81	275	0.19	4.65	21	0.03	1.20
26	Osman	Uthman	M	205	0.31	11.13	175	0.12	4.77	27	0.03	1.23
27	Riza	Risay	M	204	0.31	11.44	174	0.12	4.89	34	0.04	1.28
28	Isuf	Yusuf	M	203	0.31	11.75	177	0.12	5.01	26	0.03	1.31
29	Ahmet	Ahmad	M	202	0.31	12.06	145	0.10	5.10	40	0.05	1.36
30	Hava	Hawwa	F	201	0.31	12.37	233	0.16	5.26	3	0.00	1.37
31	Kadri	Kadar	M	192	0.29	12.66	206	0.14	5.40	20	0.03	1.39
32	Qazim	Kazim	M	192	0.29	12.96	170	0.12	5.52	41	0.05	1.44
33	Hamide	Hamidah	F	189	0.29	13.25	236	0.16	5.68	9	0.01	1.45
34	Sadik	Sadiq	M	186	0.29	13.54	146	0.10	5.78	24	0.03	1.49
35	Nadire	Nadirah	F	184	0.28	13.82	300	0.20	5.98	9	0.01	1.50
36	Nurie	Noor-Al-Haya	F	182	0.28	14.10	195	0.13	6.12	10	0.01	1.51
37	Sanije	Saniyah	F	182	0.28	14.38	231	0.16	6.27	13	0.02	1.53
38	Sali	Saleh, Salih	M	180	0.28	14.65	232	0.16	6.43	30	0.04	1.56
39	Adem	Adam	M	175	0.27	14.92	188	0.13	6.56	30	0.04	1.60
40	Hamit	Hamid	M	170	0.26	15.18	114	0.08	6.64	21	0.03	1.63
41	Enver	Anwar	M	169	0.26	15.44	329	0.22	6.86	23	0.03	1.66
42	Islam	Islam	M	168	0.26	15.70	166	0.11	6.97	26	0.03	1.69
43	Emine	Aaminah	F	166	0.26	15.96	176	0.12	7.09	19	0.02	1.72

Studime

44	Zenel	Zeynel	M	166	0.26	16.21	133	0.09	7.18	19	0.02	1.74
45	Fadil	Fadil	M	163	0.25	16.46	190	0.13	7.31	20	0.03	1.77
46	Muhamet	Muhammad	M	161	0.25	16.71	203	0.14	7.45	73	0.09	1.86
47	Selim	Saleem	M	161	0.25	16.96	139	0.09	7.55	18	0.02	1.88
48	Aishe	A'ishah	F	160	0.25	17.20	181	0.12	7.67	18	0.02	1.90
49	Halil	Khaleel	M	160	0.25	17.45	158	0.11	7.78	26	0.03	1.94
50	Qamil	Kaamil	M	158	0.24	17.69	167	0.11	7.89	13	0.02	1.95

PI – periudha e parë

PII – periudha e dytë

PIII – periudha e tretë

n – numri i personave që përdorin këtë emër në periudhën përkatëse

% e emrave myslimanë – përqindja e emrit përkatës në popullatën e emrave myslimanë gjatë periudhës së cituar

Përqindja kumulative – shuma e përqindjeve të gjithë emrave paraardhës së bashku me emrin e radhës, duke ju referuar totalit të emrave të konsideruar myslimanë sipas kriterëve të studimit.

Referenca

[1] INSTAT, 2011 Census-AL, Population and Housing Census of Albania 2001 / Census 2011, preliminary results, http://census.al/Resources/Data/Census2011/Instat_print%20.pdf

[2] Albania: a country study / Federal Research Division, Library of Congress; edited by Raymond E. Zickel and Walter R. Iwaskiw, 2nd ed., ISBN: 0844407925, Washington, D.C. : The Division : For sale by the Supt. of Docs., U.S. G.P.O., 1994.

[3] Bashkimi, January 12, 1973, p. 1.

[4] Bowers, Stephen R., “Stalinism in Albania: Domestic Affairs under [1] [1] Enver Hoxha” (1989). Faculty Publications and Presentations. Paper 87; Helms School of Government http://digitalcommons.liberty.edu/gov?utm_source=digitalcommons.liberty.edu%2Fgov_fac_pubs%2F87&utm_medium=PDF&utm_campaign=PDFCoverPages

[5] Martin Baldwin Edwards; Albanian emigration and the Greek labour market: Economic symbiosis and social ambiguity; SEER, South East Europe Review for Labor and Social Affairs), issue: 01/2004, pages: 5165, on www.cceol.com

[6] Tirana University Hospital Center, “Mother Teresa”; Statistics Department, 2005-2011.

[7] Kiumarss Nasser; Construction and validation of a list of common Middle Eastern surnames for epidemiological research; Cancer Detect Prev. 2007 ; 31(5): 424–429.

[8] Saleem Abuleil 2004. Extracting Names from Arabic Text for Question-Answering Systems, In Proceed-ings of Coupling approaches, coupling media and coupling languages for information retrieval (RIAO 2004), Avignon, France. pp. 638- 647.

[9] Khaled Shaalan, Hafsa Raza; Person Name Entity Recognition for Arabic; Proceedings of the 5th Workshop on Important Unresolved Matters, pages 17–24, Prague,

Czech Republic, June 2007. c2007 Association for Computational Linguistics.

[10] Heather Hedden; Arabic names; Centrepiece to *The Indexer* Vol. 25 No. 3 April 2007.

[11] Ali Elsebai, Farid Meziane, Fatma Zohra Belkredim; A Rule Based Persons Names Arabic Extraction System; Communications of the IBIMA, Volume 11, 2009 ISSN: 1943-7765.

[12] Ali Elsebai, [a] Regional Seminar on Bibliography Documentation and Exchange of Publications in Arabic Speaking States; Dr. Mahmud Sheniti; UNESCO/LBA/Sem. 8/2, Paris, November 1961.

[13] Personal Names in Hebrew and Arabic: Modern Trends Compared to the Past; Rosenhouse J.; Journal of Semitic Studies, Volume 47, Number 1, 2002, pp. 97-114(18).

[14] A Socio-Cultural and Linguistic Analysis Of Yemeni Arabic Personal Names; *Abdul Wabed Qasem Ghaleb Al-Zumor; GEMA Online Journal of Language Studies* 15 Volume (2) 2009.

[15] Cross- and trans-language morphology; The lexicography of Indonesian names; Dick Van Der Meij; Wacana, Vol. 12 No.2 (October 2010): 345-368.

[16] Benno Torgler; The importance of faith: Tax morale and religiosity; Journal of Economic Behavior & Organization; Vol. 61 (2006) 81–109; © 2005 Elsevier

[17] Napoleon A. Chagnon; Life Histories, Blood Revenge, and Warfare in a Tribal Population; Science, New Series, Vol. 239, No. 4843. (Feb. 26, 1988), pp. 985-992.

[18] Moritz Hetzer1, Didier Sornette; The Co-Evolution of Fairness Preferences and Costly Punishment; PLOS ONE, www.plosone.org 2; March 2013, Volume 8, Issue 3, e54308.

[19] S. R. Musse, D. Thalmann; A Model of Human Crowd Behavior: Group Inter-Relationship and Collision Detection Analysis.

[20] Rosenhouse J.; Personal Names in Hebrew and Arabic: Modern Trends Compared to the Past; Journal of Semitic Studies, Volume 47, Number 1, 2002 , pp. 97-114(18).

[21] Mark L. Hatzenbuehler, Jo C. Phelan, Bruce G. Link; Stigma as a Fundamental Cause of Population Health Inequalities; Am J Public Health. 2013 May; 103(5): 813–821.

Perjetësimi i Nezim Beratit mes divanit të tij shqip

Prof. Assoc. Dr. Rahim Ombashi
Fakulteti i Shkencave Humane, Universiteti Bedër

Abstrakt

Pranimi masiv i islamit nga shqiptarët nuk përfaqëson një tradhti për bashkatdhetarët e tjerë apo fqinjët e krishterë, është i justifikuar si imperativ politik, dhe jo vetëm, një thirrje e marrë për të përforcuar identitetin e tyre të veçantë. Sociologjia e religjionit zbulon trashëgiminë osmane në Shqipëri që krijoi dhe ruajti një kulturë të konsiderueshme shpirtërore islame, e cila përfshinte penetrimin e gjerë të sufizmit në vetëdijen myslimane dhe shqiptare, që vijon të mbetet një element i fuqishëm i kulturës islame në Ballkan. Islamologjia e përgjithshme ndikoi mbi veprën poetike të alamiadistit Nezim Frakulla me temat, idetë, mendimet, filozofinë, moralin, etikën, me të cilat ka konvergencë. Vetëdija fetare e tij e ngriti vetëdijen gjuhësore, iluministe, politike, sociale, me synimin të ishte si ajo te Rumi apo Junus Emre. Me metodën e rezonancës kuantike divani i tij shqip dëshmon për ndërveprime diskursive në filozofinë, ndodhitë, gjetjet poetike, fjalët e urta, porosinë të cilat shkojnë nga bota e jashtme te ajo e brendshme, që do të thotë nga vija fetare zyrtare sunite te ajo drejt pikëpamjeve sufi haptazi mistike, me trend nga një besim i jashtëm në atë të brendshëm, ndërsa mistika, si besim i besimeve ezoterike, qëndron si poetikë islame, e cila ndërtohet mbi fjalor të huaj. Nezimi diti të vrojtonte, të kishte imagjinatë të begatë, zhdërvjelltësi përpunuese, asimiluese të lëndës së vendlindjes duke e kthyer në poezi, në ditiramb për gjuhën shqipe, në këngë malli për Beratin e Shqipërinë, sepse ndihet shkrimi muzikor i fjalëve mes këtij komunikimi social. Me të drejtë T.S. Eliot thekson se asnjë art nuk është më kombëtar se poezia.

Fjalë çelës: identitet, sociologjia e fesë, sufizmi, almiado, divan.

1. Hyrje

Historia e divanit në Shqipëri zë fill në shekullin XV me autor Mesih Prishtinën. Një shekull më pas la emër Jahja bej Dukagjini dhe Ahmet bej Dukagjini. Poetët e kësaj kohe, që kishin mësuar nëpër medresetë dhe shkruanin divane osmanisht ose persisht, kanë krijuar të përziera, ku bashkë me leksikon e huaj është edhe fjala shqipe. Shpejt do të shfaqeshin edhe krijimet e

mirëfillta në gjuhën shqipe të shkruara me alfabet arab.

Deri vonë pranohej si krijimi i parë në gjuhën shqipe me alfabet arab një vjershë e Muçizades, e vitit 1724, me 17 strofa katërshe me rimë AAAB, në të cilën vargu i fundit do të jetë refren i saj: *Lord, don't leave me without coffee!*,¹ përkthyer nga Robert Elsie në

1. USHT, (1959). *Historia e Letërsisë Shqipe I*, Tiranë.

vetëm gjashtë strofa katërshe dhe është titulluar po prej tij me vargun refren. Vjershëtari i drejton një lutje Zotit, si pasionant i kahvesë (tashmë kafe), kësaj pijeje orientale, e cila duket kishte hyrë gjerësisht në familjet e pasura shqiptare.

Thirrjet: *Mos më le bë iftar thatë; Mos më lerë me lëng të armesë; Mos më braktis me cipa të elbit;* bëjnë që vargjet deri-diku të tingëllojnë si parodi sociale.

Në fund të vjershës, sipas detyrimit të vjershave të divanit oriental, autori individualizohet. Emri i shkurtuar i tij Muçi, sipas traditës, është përngjitur me emrin Zade për të formuar mbiemrin, dëshmon autenticitetin si vetëdije gjuhësore duke pohuar edhe lidhjet me kulturën orientale të pirjes së kafesë. Detaji artistik del si fakt i pastër i nevojës për të konsumuar lëngun e zi, duket si element i ri jetese në qytet, por dhe të aristokracisë së fshatit. Pija e huaj krijoi dhe *kafeanat* (mjedis me dyqane ku tregtohej pija, por edhe si qendër takimi e bisede) ku ajo shijohej. Për banorët ishin krijuar kushtet e komunikimit social, prej sigurisë, qetësisë së rendit dhe asaj ekonomike, që asokohe mbizotëronte në vilajetet shqiptare, pas periudhave shekullore nën dyndjet sllave që synonin eliminimin e jo vetëm pushtimin.

Prej krijimit nismëtar dhe në vijim motivet sociale e bëjnë këtë letërsi një burim të pazëvendësueshëm të komunikimit social për kohën, por dhe më pas. Fakti social është ngurtësuar në kohë artistike duke u bërë një burim i pastër dhe i sigurt komunikimi.

Imzot, mos më lerë pa kahve!

*Për sa rrëfejnë muxhizatë,
për shenjtërit që janë vatë,*

*mos më le bë iftar thatë,
Imzot, mos më lerë pa kahve!*

*Për hyrmet të Fatimesë,
për të mirët e Merjemesë,
mos më lerë me lëng t`armesë,
Imzot, mos më lerë pa kahve!*

...

Lord, don't leave me without coffee

*By the wonders of the prophets,
By the saints that we acknowledge,
Let me break no fast a-thirsting,
Lord, don't leave me without coffee!*

*By the honour of Fatima,
And Meyreme, don't reject me
With a plate of salty yoghurt,
Lord, don't leave me without coffee!...*

Natyrë sociale e divanit të Nezim Beratit

Me Nezim Beratin e Hasan Zyko Kamberin shfaqet *lirika personale e lirika sociale* në letërsinë shqipe, me trajtat poetike të kulturës islame: *gazela, kasida, poezia didaskalike* të përmbledhura në divanin klasik, i cili kishte një renditje të veçantë. Divani zakonisht fillon me një lutje drejtuar Zotit, vazhdon me gazele, kaside dhe vjersha didaskalike, për t'u përmbyllur me kasidet panegjirike për Sulltanin apo sundimtarët e drejtuesit lokalë. Brenda vjershave, zakonisht në strofën e fundit, ndodhet emri i krijuesit, që përforcon sigurinë mbi autenticitetin e divanit. Në Arkivin e Shtetit të Republikës së Shqipërisë ruhen dy kopje të divanit në gjuhën shqipe me shkronja arabe të Nezimit, si

2. Imzot, mos më lerë pa kahve, 1724.
Përkthyer nga Robert Elsie.

dhe lidhja ku gjenden divani në gjuhën osmane dhe divani në gjuhën perse. Filozofia mbi të cilën ngrihet ky divan është filozofia islame, por njëherazi ai forcon themelin e letërsisë artistike të nisur me shkrime me alfabet latin, shfaq mendimin e vet mbi krijimin artistik poetik, mban qëndrim kritik apo të shfaq mendime teorike mbi artin letrar. Nuk është objekt i punimit tonë teksti poetik, po shqyrtimi i kontekstit të tij, i cili diku është ndikues e diku tjetër përcaktues.

Sociologjia e religjionit zbulon trashëgiminë osmane në Shqipëri, që krijoi dhe ruajti një kulturë të konsiderueshme shpirtërore islame. Ajo përfshinte penetrimin e gjerë të *sufizmit* në vetëdijen myslimane dhe shqiptare, i cili vijon të mbetet një element i fuqishëm i kulturës islame në Ballkan. Islamologjia e përgjithshme ndikoi mbi veprën poetike të alamiadistit Ibrahim Berati, i cili hyri në letërsinë tonë me emrin letrar, siç pohon vetë se Nezim është *mablasi* i tij, me temat, idetë, mendimet, filozofinë, moralin, etikën, me të cilat ka konvergencë. Vetëdija fetare e tij e ngriti vetëdijen sociale dhe kombëtare. Divani i tij shqip dëshmon për ndërveprime diskursive në filozofinë, ndodhitë, gjetjet poetike, fjalët e urta, porositë të cilat shkojnë nga bota e jashtme te ajo e brendshme, që do të thotë nga vija fetare zyrtare sunite te ajo drejt pikëpamjeve *sufi* haptazi mistike, me trend nga një besim i jashtëm në atë të brendshëm, ndërsa *mistika*, si besim i besimeve ezoterike, qëndron si poetikë islame.

Nezimi diti të vrojtonte, të kishte imagjinatë të begatë, zhërvjellësi

përpunuese, asimiluese të lëndës së vendlindjes, duke e kthyer në poezi, në ditiramb për gjuhën shqipe, në këngë malli a shqetësim për Beratin e beratasit, për elbasanasit, për vlonjatët, për Shqipërinë e shqiptarët, sepse ndihet shkrimi muzikor i fjalëve mes këtij komunikimi social. Përmbajtja e ndërthurur fetare dhe laike pasuroi motivet dhe tematikën e këtyre krijimeve alamiado, duke i hapur udhën poemës (mesnevi), ilahisë, lirikës, panegjirikës (med-hi), elegjisë (mersije), satirës etj.

Mendohet që divanin e vet shqip ta ketë nisur rreth vitit 1731, kur porsa ishte kthyer nga studimet në Stamboll, ku qëndroi pak gjatë. Në atë kohë letërsia osmane, veçmas poezia, nën ndikimin e poezisë persiane, mbajti të paprekur afnitetin për artizëm të divanit. Në këtë hulli artistike, divani në gjuhën osmane, ruan frymën e shpirtin e shkollës poetike mistike, ndërsa të folurit alegorik u qas me realitetin osman të kohës. Edhe Nezimi, te divani shqip, i ndoqi parimet e poetikës orientale, si për zhanrin, formën e përbërësve të tij, idealin e jetës, duke i dhënë përparësi idealit artistik dhe duke thelluar prirjen drejt kombëtares dhe sociale. Nezim Berati pranohet si krijuesi i divanit të parë shqip. Kjo njësi poetike ka strukturën e vet klasike, por ai thekson në të ngjyrën lokale si dhe karakterin praktik të saj, duke iu larguar konvencionalizmit. Autori guxon të mendojë thellë duke përfytyruar Zotin dhe dritën e tij, bukurinë e Tij si një nur. Joshet prej përfytyrimit “Si Mexhnuni për Lejlanë” dhe synon që jehonën e dashurisë abstrakte hyjnore ta zbulojë te natyra plot hare, gëzim, gjallëri e botës së njeriut.

Duke synuar cakun e mistikut, njohjen e së vërtetës, siç shkruan studiuesja gjermane Anemarie Schimmel, ai shmangu metodat ndijore dhe racionale, duke gjykuar sipas përvojës së vet shpirtërore. Përvoja e tij boheme ka lënë detaje të sakta të realitetit social, veçmas te vargjet e tij moralizuese të shkalla e katërt e poezisë së tesavufit, ajo e *marifetit*, si shkalla më e lartë e njohjes.

Vargut alamiado i shkojnë më mirë masat ritmike të gjuhës shqipe, strukturat e saj theksore, kurse vargun popullore tetërokësh e futi te strofa katërshe me rimë të alternuar.

Kësisoj Nezimi krijoi edhe metrikën shqiptare, duke i vënë shenjën e personalitetit të vet gjithë shkollës së vjershëtarëve. Pas tij, Muhamet Kyçyku, në trajtën e poemës tregimtare, do të jetë shumë i kërkuar me veprat *Ervebeja* e *Jusufi e Zelihaja*, kurse *Ervebeja* do të jetë vepra më e përhapur në periudhën e Rilindjes sonë Kombëtare.³

Divani i Nezimit ndihmoi që të niste shkrimi i krijuesit që nuk mbeti rob i ideologjisë, cilado qoftë ajo. Shkrim pa ide dominante! Poezi e fatit njerëzor në dashuri, ringjallje, dhembje apo dëshpërim. Poezia e tij ftoi për t'u shijuar nga lexuesi i futur në këtë udhë, të cilit porsa i kishte trokitur në derën e ndërjegjes paqja shpirtërore.

Gjendja e disa mjediseve gjeografike, por dhe e shqiptarëve që banonin në to, në këtë kohë, është e ndryshme me faktet që jep studiuesi Milazim Krasniqi:

“Përfundimisht, mund të konstatojmë se shqiptarët hynë në shekullin XIV nën Perandorinë Osmane

si një popull i pushtuar, i defaktorizuar, në një proces të asimilimit etnik e fetar nga serbët, ndërsa në fillim të shekullit XX, kur dolën prej Perandorisë Osmane, ishin një komb i konsoliduar, që ishte i aftë të luftojë për shtetin e vet kombëtar, në një rrethim ballkanik dhe evropian shumë armiqësor”.⁴

Shenjat e gjallërimit të disa krahinave u ndjenë menjëherë. “Si provë për këtë ne kemi një shënim të një kronike veneciane të vitit 1570, ku thuhet se në këtë kohë Elbasani lulëzonte, në qytet kishte lagje tregtarësh: francezë, hebrej dhe të krishterë. Qytetet e tjera në këtë kohë si Durrësi, Shkodra ishin bërë gërmadha dhe të jepnin përshtypjen e qyteteve të vdekura”.⁵ Nezimi u kthye në vendlindje burrë i pjekur. Kishte vëzhguar pemët në pyll, të cilat tregonin gjendjen e ndihmës, që i jepnin njëra-tjetrës. Në ditët e zhegut të verës të gjitha bënin hije përreth, duke mbrojtur rrënjët nga tharja. Kur frynte era e fortë, mbështeteshin te degët pranë dhe nuk thyheshin. E po ashtu kur kishte reshje të dendura shiu. Pemët e pyllit e përballonin përmbytjen duke i ndarë rrëketë, kështu që ato humbnin fuqinë shkatërruese dhe pemët mbijetojnë së bashku te pylli. Pylli parandalon fatkeqësinë natyrore duke ruajtur mjedisin. Pikat e shiut janë mëshirë për njerëzimin, por duhet mbrojtur prej tyre kur formohen rrëketë. Kështu dhe njeriu. Ka nevojë të ketë njeriun në krah, merr prej tij, por edhe i jep atij. E ndiente dhe vuante prej vetmisë, e kishte provuar jo pak herë individualizmin e tejskajshëm të bashkatdhetarëve. Këto lloj marrëdhëniesh kishin krijuar njeriun

4. Krasniqi M. (2012). *Rrjedhimet historike dhe kulturore të sundimit osman*, “Zani i Naltë”, nr. 1.

5. Puzanova V. (2005). *Mbi artin bizantin dhe post-bizantin shqiptar*, Tiranë.

3. Hamiti S. (2010). *Poetika shqipe*, Tiranë.

e mbyllur brenda vetes, pa komunikim real me të tjerët dhe jetën sociale në përgjithësi.

U druhej grupimeve njerëzore që nuk bashkoheshin në bazë të normave, ato krijonin fatkeqësi sociale. Njeriu ishte hallkë e zinxhirit të madh shoqëror, por e dinte dhe një parim të njohur se fortësia e zinxhirit matet me fortësinë e hallkës më të dobët të tij. Me fatin tragjik në të shkuarën, pas pushtimesh të gjata të cilat kishin synuar asgjësimin, populli i tij kishte ruajtur vlera identitare. Pasojat e sistemit politik-shoqëror individualist dalloheshin gjithandej. Po të përdorim një argument të Faik Konicës:

“Para së gjithash, duhet mbajtur ndër mend, siç e kemi parë më sipër, se shqiptari është tepër i pavarur dhe tepër individualist, kështu nuk i nënshtrohet ndikimit të kujtdo qoftë në kundërshtim me vullnetin e vet. E përsëri ai ka besim të fortë te prejardhja dhe te e drejta e precedencës, si dhe te gjithçka lidhet me ide të tilla”.⁶

Dhe ai shkroi:

Sorrë, as u turpërove!

Meqn' i bilbilut ç't'u desh?

Te divani janë fjalët, tërë ato vargje, plot kuptime në rrafshin horizontal, si dhe në atë vertikal, madje këtu më shumë. Të zbulojmë pas asaj çfarë thuhet diçka që ishte krejt ndryshe me çfarë mendonte e bënte në të vërtetë.

Frikësohej nga Zoti, ndaj besonte të fshehtë e tij, duke e adhuruar sinqerisht, *shirku* (idhujtaria) e shqetësonte. Formimi kombëtar dhe ai shpirtëror mund të shkojnë paralelisht, prandaj ai shkroi shqip. Kontradiktat e

shumta e lodhën, kishte jo pak çaste kur nuk ndihej i lirë, veçmas në atë periudhë të jetës, kur punoi për të tjerët, por kurrë nuk i shkoi në mendje të shiste bindjet për të fituar lirinë. Nuk luajti asnjë rol në skenën e kohës, edhe kur i diktohej realiteti dramatik social, mbeti vetvete. Jetoj jetën e vet, ndaj pa vetëm me sytë e shpirtit të vet, duke na lënë pamje, portrete dhe realitete sociale, fakte dhe dëshmi historike të pa tjetërsueshme.

Nezim Berati iu qas Islamit në aspektin *ezoterik*, duke e pranuar të mësuarit e Kur'anit si mësim pozitiv – *shariat*, kurse idetë e tij të brendshme, apo të vërtetën e fshehtë si *hakikat*. Duke realizuar pranimin së brendshmi të Islamit, njeriu që arrin të njohë hakikatin, arrin të njësohet me Zotin, duke u çliruar prej unit të vet, i cili e tondon me vesin. Etika e *tesavufit* krijoi botëkuptimin metafizik, i cili dha ndihmesën e vet në zhvillimin e etikës universale humane, por edhe të moralit apo ligjeve shoqërore të bazuara në të. Filozofia dhe morali i tij islam ka për synim krijimin e njeriut të përsosur - *insani kamil*, i përplotësuar në vetvete. Në këtë mënyrë ai përqs mendësinë e vet ideale me tipare negative, duke na dhënë kështu materiale autentike sociale. Duke mos u njësuar me Zotin substancialisht, por me anë të dashurisë, do të hiqte dorë nga individualizmi i tejskajshëm. Në divanin e vet jo vetëm e përshkruan dashurinë ndaj Zotit, por ai përcjell përvoja se si kultivohet ajo, duke e shpallur veten *muderris* (mësues) të *ashkut*. Jep modelin e vet të asketit, duke falënderuar Zotin për mundimet, vuajtjet, dhembjet që e ndihmojnë ta njohin dhe të njësohen me Të.

6. Konica F. (1993). *Vepra*, Tiranë.

Duke vënë në themel të moralizimeve të tij etikën universale, të mirën dhe të keqen, ai nxjerr deduksionet morale si nderi, besnikëria, drejtësia, urtësia, bindja, të cilat i shpall vlera të njeriut, duke i kundërvënë me antonimet e tyre:

*Hasedçiu e munafiku
Të e di se ç'udhë kanë,
Vallahi s'gënjen sadiku (shoku besnik)
Të gjithë shejtanë janë.*

Meditimi i Nezimit – si mënyrë e të jetuarit

Tipar i fuqishëm i botëkuptimit artistik të Nezim Beratit është integrimi i “meditimit” me jetën e poetit. I evidentuar te ky poet, ai është i pranuar dhe i përhapur në të gjithë krijimtarinë e divaneve, si një veçori thelbësore e poetikës së tyre. Nezimi, ashtu si edhe Rumi, të cilin e njeh dhe e pranon, por nuk e kopjon, përpunon dhe zhvillon idenë se “meditimi” si refleksion dhe njëherësh përgjigje ndaj sfidave të kohës dhe të mjedisit rreth tij, duhet domosdoshmërisht të bashkëjetojë me gjendjen e brendshme të shpirtit të poetit. Ky tipar i kudogjendur i poezisë së tij e kishte bazën te tradita e lashtë poetike e artit Islam.

Ndjeshmëria artistike e tij nuk mund të shihet e ndarë nga biografia e poetit bohem dhe themi plot siguri se Nezimi dhe poetët e tjerë alamiado e kanë të ndjerë vargun e tyre, sepse meditimi i tyre poetik ka dalë nga përjetimi i tyre vetjak.

Me jetën e veçuar dhe plot privime ka vlerësuar meditimin si një mënyrë jetese dhe jo vetëm si një refleksion

teorik. Të meditosh do të thotë të jetosh dhe të veprosh në një mënyrë të caktuar, duke iu shmangur përplasjeve me çështjet abstrakte. Meditimi nuk është krejt i ndarë nga poeti për faktin se ai ka të bëjë kryesisht me esencën e njeriut; por, në të njëjtën kohë, duke mos synuar një zgjidhje, ai merr pozicionin e duhur.

Në divanin e Nezimit, produktet meditative janë të pandara me jetën e poetit, këtij heroi të mendimit të individualizuar, që shikon me sy, vlerëson me shpirt dhe ndjen me zemër.

Vepra e tij gjithashtu ka një armaturë konceptuale të fortë, pa pretenduar të jetë një sistem. Nezimi konceptualizon dhe vë në marrëdhënie tonalitetet afektive (frikën, agoninë, dëshpërimin, pandershmërinë, abuzimin...), duke krijuar kështu psikologjinë sociale të shqiptarit, që ai njohu. Vargjet e tij paraqesin edhe një mendësi të kohës (të çastit dhe të përtëritjes) si dhe të stadeve të ekzistencës (fetar: raporti i njeriut me Zotin; estetik: raporti i njeriut me ndjenjën; etik: raporti i njeriut me detyrën; moral, social, komunikues). Meditimi i veprës duhet shijuar në mënyrë ekzistenciale, duke pasur subjektivitetin si themel të procesit komunikues, por edhe mund të gjykohet.

Ngrehina e krijuar prej tij është plot ekzistencë humane. Duke qenë aq pranë me të shpirtërisht, kundërshton mbizotërimin e arsyes. Ideja qendrore e poezisë së tij është ajo e përgjegjësisë individuale përballë ekzistencës. Ai përshkruan aspekte të ndryshme të individit duke dhënë një orientim në ekzistencën e lexuesve të tij. Konsideron teknikën e divanit, në të cilën ai shpreh

ndjeshmërinë, si një model krijimi, që së pari është realizuar në shqip. Sinqeriteti dhe individualiteti e inkurajojnë lexuesin të marrë pjesë aktivisht në atë që ai lexon. Vargu shpërfaq njëkohësisht shqetësimet dhe kufijtë e normave morale të shoqërisë ekzistuese. Me shumë sinqeritet dhe me një fjalor të veçantë poetik, me përdorimin e një numri të konsiderueshëm simbolesh (rumuz), alegorish, metaforash, subjeksionesh... Nezimi përball indirekt lexuesin me jetën e tij përkatëse.

Aspekti indirekt nuk ka të bëjë vetëm me mënyrën e komunikimit poetik, ai pranon që komunikimi varet gjithashtu nga bashkëbiseduesi. Ky i fundit duhet të ndjejë bindjen e tij fetare që është shprehur aq saktë shqip. Pagoi aq shumë për “marrëzinë poetike”, por duhet gykuar për të si për një poet. Objektivizmi në vetvete, në veçanti, shënon një ndarje të *unit* që është i vëzhguar e i njohur dhe *unit* që vëzhgon dhe njeh. Kjo e çoi në vetëtjetërsim (vetarmiçësim) si dhe te një fund tragjik, pasi u ndalua, u internua dhe u burgos.

Ndërkohë që pretendohet që njeriu duhet të lirohet nga *introspeksioni* ose nga kthimi i tij në vetvete, duke synuar të ecë drejt tij, Nezimi qëndroi fort te njohja e vërtetë e vetvetes, ngritur si një proces aktiv. Ai e fton lexuesin duke i propozuar një pasqyrë që të njohë vetveten, të njohë të metat, por t'i përjashtë ato dhe njerëzit, që ai i njeh mirë. Duke kritikuar shqiptarin e kënaqur në vetvete dhe kulturën e tij, ashtu sikurse vese të tjera, ai e shtyn individin të dalë nga të zakonshmet e tij dhe nga reflekset sociale.

Nezimi me objektivitet pranon t'i lejojë individit, përgjatë procesit të komunikimit me të, evoluimin, duke arritur të pranojë në komunikim të vërtetën subjektive. Ai e përshkruan këtë proces si një rrugëtim që shkon nga estetika, duke kaluar nëpërmjet etikës, për të mbërritur në stadin religjioz: të ekzistencës së orientuar drejt kënaqjes së dëshirave imediate, si zgjidhje e qenies për Zotin. Në mënyrën në të cilën na hapet një rrugë në ekzistencë, ne ndiejmë domosdoshmërinë e ndonjë themeli tjetër nga ai i yni.

Refleksioni mbi njeriun nuk duhet të na çojë në ngatërrimin, në përzierjen e përshkrimeve abstrakte dhe realitetit konkret. Grumbullimi i njohurive nuk mjafton për të plotësuar paditurinë, megjithëse ai përcjell idenë se e vërteta është subjektive. Është për të vërtetën dhe me të vërtetën, sikur të ishte e vërtetë individuale. Përpiqet të përshtatet me të kundërtën e saj, tërhiqet, ndryshon banim, shkon nga Berati në Elbasan, në qytete dhe vende të tjera, deri në Ukrainë, vuan prej saj. Gjuha e së vërtetës del pas leximit kuptimor të saj, sepse ajo duhet të shprehë atë që, e marrë në një kuptim gramatikor, nuk mund të jetë thënë. Ajo është më shumë një instrument në duart e artistit, sesa të dijetarit. Ajo transmeton një mundësi (pushtet) dhe jo një njohje.

Ekzistenca është realiteti themelor i njeriut. Nezimi nisat nga parimi që energjia dhe serioziteti që përcakton këtë ose atë zgjedhje karakterizojnë qëndrimin e përshtatshëm përballë jetës, qëndrim që na vë automatikisht në marrëdhënie me origjinat tona:

qëllimin e Zotit. Detyra e njeriut nuk është vetëm qenia, prandaj infinity duhet të paraqitet si infinity në ekzistencën kalimtare. Infinity dhe pavdekshmëria janë të vetmet siguri.

Besonte se ishte i lirë në përcaktimin e cilësisë së ekzistencës, duke na vënë në ruajtje kundër iluzionit të autonomisë, që shpalojë shpesh brenda natyrës shqiptare. Ne mund të vendosim vetë të marrim përsipër jetën tonë. Megjithatë, paradoksi i ekzistencës qëndron në faktin se ne duhet të përpiqemi në çdo rast të gjejmë një ekuilibër me “faktorin” (Zotin) për të cilin ne jemi të hapur dhe që na përcakton. Ajo që përbën destinimin tonë është se ne jemi të varur. Njëkohshmëria ndërmjet kuptimit dhe dëshirës transhendente i ikën, i shpëton mendimit. Në çastin ku mendimi lind, ai është i asgjësuar nga ekzistenca. Nezimi arrin ta zbulojë këtë paradoks.

Paradoksi i lirisë gjendet në faktin që ne besojmë me vetëdije lirinë tonë në Zotin e gjithëfuqishëm, i cili na imponohet. Të besuarit nuk qëndron mbi arsyen, por ai është një kërkim në boshllëk, i frymëzuar nga besimi. Prandaj dhe besimi është përfundimisht i pasigurt në çdo çast drejt pavdekësisë. Liria është, pra, një qëndrim ekzistencial. Njeriu nuk është i lirë të jetë një tjetër nga vetvetja, përkundrazi, ai është i lirë të bëjë të duket (se është) të qenët një tjetër. Në rastin e dytë ai ka një raport të keq me vetveten. I ndërgjegjshëm se nuk mund të jetë në akord me natyrën e tij të vërtetë, ai zhytet në ankth, në agoni. Ai nuk mund ta ndreqë këtë situatë veçse me anën e vullnetit. Nëse ai dëshon, është i lirë të dëshpërohet. Liria e

vërtetë supozon se nuk ka tjetër zgjidhje veç asaj që njeriu të ndjekë rrugën që duhet ndjekur. Kjo është dorëheqje nga alternativa e lirisë në pranimin e asaj që na transhedenton.

Nezimi argumentoi poetikisht karakterin subjektiv të së vërtetës, si pjesë e përgjegjësisë individuale në njohje përballë ekzistencës. Duke analizuar kufijtë e njohjes objektive, inspiron individin të pranojë në komunikim të vërtetën subjektive si një të vërtetë individuale.

Me natyrën e *burufiut*, vuri në themel të veprës së vet çështjen e ekzistencës, që besohej prej tij si realiteti themelor i njeriut. Jemi të lirë të vendosim cilësinë e ekzistencës sonë. Me fjalën e gjetur ai zbuloi paradoksin e lirisë që na shoqëron përgjatë ekzistencës, sepse sipas pikëpamjeve të tij iluministe dhe humaniste të lirisë ky është një qëndrim ekzistencial. Liria e vërtetë supozon që nuk ka zgjidhje tjetër veç asaj që njeriu ndjek rrugën që ai duhet ta ndjekë.

Diskutimi

Për historinë e luftërave të popujve të Ballkanit midis tyre apo të këtyre popujve me Perandorinë Osmane është shkruar dhe vijon të shkruhet, ndërsa për komunikimin shpirtëror më pak, kur kohët e fundit pranohet se trashëgimia shpirtërore osmane është vitale në rajon.

Studiuesi Stephen Schwartz ka vënë re se studiuesit perëndimorë kanë parë me vëmendje raportet shtetërore të perandorisë Otomane me shtetet e Ballkanit, duke lënë mënjanë marrëdhëniet shpirtërore, të cilat, pas shkëputjes së të parave, dëshmojnë edhe tashmë:

“Ndërsa historia e pushtimit dhe e sundimit osman në rajonin e Ballkanit, si dhe roli i pakënaqësive nacionaliste nga ana e banorëve të krahinave të Ballkanit në lëvizjen që çoi në shpërbërjen e perandorisë, janë tema të njohura nën titullin e përgjithshëm të historisë osmane, studimet perëndimore mbi Islamit në Ballkanin osman, dhe veçanërisht mbi rolin e sufizmit në Ballkan, kanë qenë të rralla. Kjo është për të ardhur keq, sepse trashëgimia e shpirtërore Osmane është çuditërisht e rëndësishme në atë rajon.”⁷

Edhe më të rralla janë shkrimet mbi jehonën e kësaj trashëgimie në jetën sociale dhe veçanërisht mbi elementët që e dëshmojnë këtë:

“Përveç bektashinjve, të cilët mbështesin aparatit e tyre organizativ, Kosova, Maqedonia perëndimore përfshi dhe Shqipërinë kanë qindra teqe aktive të lidhura me tarikatat Rifa'i, Halveti, Kadiri, Sa'adi, Gjylsheni, Xhelveti, Hajati dhe Tixhani, duke numëruar pothuajse 300 vetëm në Shqipëri. Shumë qytete në Kosovë dhe Shqipëri duket kanë një numër teqesh që përfaqësojnë urdhra të ndryshëm, si dhe, sidomos në jug të Shqipërisë, shumë qendra bektashiane.”⁸

Në përforcim të këtij pohimi shqipfolësit *sufinj* vazhdojnë të prodhojnë koleksione nga *ilahije*, *nefesler*, këngë të tjera dhe recitime për përdorim në *dhikër*. Vijon të përkujtuarit sufi të Perëndisë, diku në gjuhën turke dhe diku

shqip, së bashku me krijimet alamiado, si dhe përkthimet e klasikëve sufistë, duke ia shtuar kontributet e reja kanunit shpirtëror. Veç krijimeve artistike, në një fazë të mëvonshme, letërsia alamiado shtoi punimet fetare. Tradita shërbeu si bazë për krijime të tilla si *Mevlud-i Sherif* i Hafiz Ali Riza Ulqinakut (1855-1913) dhe poezia bektashiane e poetit të shquar kombëtar shqiptar Naim Frashëri (1846-1900), konsideruar si një nga dy poetët kombëtarë shqiptarë së bashku me katolikun Gjergj Fishta (1871-1940), mbetet popullor edhe sot ndër shqiptarët.

Gjithçka pohon për vijueshmëri të komunikimit shumëllojesh.

Jo shumë më parë nisi të pranohet roli i madh i sufizmit në Ballkan, i cili ka lidhje me fatet fetare, kulturore, por edhe sociale të popujve të kësaj zone. Duhet parë natyra dyfishe dhe e përzier e shtetit, në të njëjtën kohë altaik dhe levantin; arabo-persian e greko-romak; ballkanik dhe anadollas. Shteti osman ndryshoi elementë dhe veçanti prej shumë vendeve që kishte aneksuar dhe pasqyroi sintezën etnike të *melting-pot* të Mare Nostrum. Duke ruajtur një mozaik kulturash, gjuhësh dhe besimesh, për të cilat Islami sunit turk, fuqimisht i influencuar nga misticizmi pers dhe selxhuk, nga qytetërimi i oborrit persian dhe nga praktikat administrative bizantine, furnizoi lidhësin unifikues.

Është mbështetës pohimi se sinteza e kulturave sedentare, që vënë në themel figurën më intriguese të jetës së lashtë fetare⁹ me ato nomade, që vinin nga Indo-Evropa, ndodhi në Evropën Juglindore, ndaj transformimi

9. Melikoff I. (1983). *The Humanism of Rumi Versus Western Humanism*, (26 Researchers on Rumi), Konya.

7. Schwartz S. (2010, 2012). [Presented to Indiana University Bloomington Conference *The Turks and Islam*, September 12, 2010, revised January 2012].

8. Schwartz S. (2010, 2012). [Presented to Indiana University Bloomington Conference *The Turks and Islam*, September 12, 2010, revised January 2012].

i jetesës ndikoi në ideologji, sistemin e vlerave duke lënë gjurmë në jetën shpirtërore.¹⁰ Veçantia e trevave ilire mes Perëndimit dhe Lindjes dëshmon se kontaktet e tyre me fqinjët, veçmas me ata indoevropianë, kanë qenë në vijueshmëri. Duket jehona e kultit anatolian u tret me jehonën e *Magna Mater*, që erdhi me kontaktet greko-romake, të cilat gjithashtu e kishin të huazuar. Me shtrat të parapërgatitur, mendësia mitike ilire krijoi *shtojzovallet, zanat, orët* e eposit tonë monumental, aq autentike e njëherazi aq të përafërta me mitin e lashtë.

Lidhja e fuqishme me natyrën e mjedisëve ku jetonin fiset ilire, siguria që mbartnin nga mbrojtja që u vinte nga këto qenie mitike, përforconte besimin e tyre në vetvete. Prirja natyraliste e hurufijve të parë, që erdhën në qytetet shqiptare, gjeti hapësirë në një mjedis të tillë, ku hodhi rrënjë lëvizja sufiste në Shqipëri, e cila në shekullin XVIII ndodhej jashtë disiplinës së institucioneve zyrtare sunite.

Studimet sociale për këtë periudhë të pranimit masiv të Islamit nuk kanë analizuar se pse autorët alamiado dëshmojnë tipare të lëvizjes *alevite* në përgjithësi dhe të rrymës *hurufite* në veçanti, lëvizje që pasqyron ndikimin e misticizmit pers dhe selxhuk, si dhe prirjen për moszbatim të disiplinës së institucioneve zyrtare sufite. Nuk është qëndruar te analiza e gjendjes sociale, arsimore, ekonomike dhe kulturore të qytetit të Beratit, të cilin udhëtari i shquar turk Evlija Çelebi gjatë vizitës së tij më 1670 e gjeti me 30 lagje, me 5

medrese, me hamame të shumta publike e private, me shumë teqe e xhami të bukura, si ajo e Izgurit, e Mushkës dhe e Hysen Pashës, për të cilën thotë se s'e kishte shoqen për nga arkitektura. Masat e volumit të xhamive ishin formatuar me linjat e brinjëve, që duke anuar kithtas arrijnë te maja e minares, duke shënjuar simbolikën sunite të trëndafilut, që lartëson Zotin. Udhëtari i shquar flet dhe për jetën e gjallë shpirtërore, intelektuale dhe kulturore të qytetit dhe të banorëve të tij me shpirt kërkues.

Shpërthimi poetik alamiado nuk është dukuri spontane. *Rruga Perandorake*, njëra nga dy degëzimet e *Via Egnatias* romake kalonte afër manastirit Shën Mëria e Apolonisë dhe vijonte nëpër luginën e Osumit, nëpër Berat e më tej në Voskopojë, Korçë e Selanik. Në vitin 1537, arkitekti më i shquar i periudhës klasike të arkitekturës osmane, arkitekt Sinani, kishte ndërtuar në Vlorë White Tower, si ajo e Selanikut, Xhaminë Muradie dhe plot ura, me porosi të Sulejmanit të Madhërisëm. Më 1554 Onufri madhështor lë mbishkrimin në kishën e Shënpremtës, në Valsh, fshat mes Elbasanit dhe Beratit. Burimi lindor e kishte ushqyer artin bizantin në vijim, por piktori i madh, duke ruajtur të gjitha rregullat e shkollës së Kostandinopojës, e ngopi atë me ekzekutimin realist, sepse i mori tipat e tij nga mjedisi lokal. Me individualizimin e tipave që krijoi, ai e pasuroi artin e bukur bizantin. Studiuësja ruse e quan pikturë me nivel të lartë, ndërsa atë serbe në nivelin e zejtarisë së zakonshme.¹¹

Më 1578 Nikolla, biri i Onufrit,

10. Ismajli R. (1994). *Etni dhe Modernitet*, Pejë.

11. Puzanova V. (2005). *Mbi artin bizantin dhe post-bizantin shqiptar*, Tiranë.

pikturon një kishë në Berat. Më 1724 David Selenicasi ka pikturuar kishën e madhe të Shën Kollit në Voskopojë. Pas tyre dalin vëllezërit Zografi. Gjithçka dëshmon për gjallërinë e jetës kulturore dhe artistike të këtij pellgu.

Gjithçka flet për një vijueshmëri, e cila e mban truallin me vlagë jete e ndjeshmëri të lartë artistike. Duhet hyrë edhe më thellë në analizën e fakteve që dëshmojnë drejtuesit e institucioneve fetare të qytetit të Beratit, siç është rasti i heqjes nga posti i Mulla Aliut më 1738, myftiu i Beratit, nga Shejhul-islami i Stambollit, si shkaktar trazirash.

Fenomeni i Nezimit nuk duhet parë i veçuar, sepse fill pas tij del poeti Sulejman Naibi, edhe ai hurufi. Postin e myftiut arrin ta zërë Hysen Mullai, hurufi edhe ky, madje deri dhe udhëheqësi i hurufijve të Rumelisë, e kishte qendrën në Berat. Për konfliktin mes drejtuesve sunitë dhe hurufive të kryesuar nga myftiu, dëshmojnë shënimet e Faik Karaosmanit, sipas të cilave ulematë sunitë arritën ta shkarkonin nga detyra myftiun e Beratit.

Mbizotërimi i vështrimit social-historik ka dëmtuar besimin e mirëfilltë të divani i Nezimit, duke zbehur jehonën e tij në popull, si lexues apo dëgjues i veprës, kur pranohet se besimi është një shfaqje e marrëdhënieve të njeriut me të pashpjegueshmen dhe të mbinatyrshmen. Njeriu ka lidhje të natyrshme me të mbinatyrshmen për të krijuar thjesht bankën e mendimeve, sepse tradita, kultura, besimet deri-diku janë përcaktuese në lidhjet e individit me të mbinatyrshmen.

Mënyra tolerante e ndjekjes së riteve madje edhe e besimeve të tjera

fetare dëshmon jehonën e fuqishme të së shkuarës sonë politeiste dhe njëherazi mungesën e mbivlerësimit për institucionet monoteiste të besimit fetar, të ngritura në tokën e tyre, të cilat vijonin asokohe t'i shihnin si institucione thjesht njerëzore, derisa frekuentoheshin për arsye shoqërore. Dyzimi ka ndikuar te pasiguria e Nezimit për të nisur vargëzimin në shqip më herët, sepse sipas studiuesit Kristo Frashëri ai në fillimet e veta poetike ka kombinuar vargje turqisht dhe shqip.¹²

Studimi serioz nga Albert Doja, *Bektashizmi në Shqipëri: histori politike e një lëvizjeje fetare*, dëshmon për mosnjohjen e gjendjes realisht, kështu që kërkimet e kësaj nënshtrese fetare islame kanë qenë deskriptive, nuk kanë mundur t'i largohen “etnocentrizmit, empirizmit, historizmit dhe interpretimit të fjalëpërfjalshëm”,¹³ duke mos u ngjitur te analiza të mirëfillta antropologjike dhe sociologjike, të cilat hedhin dritë mbi jetën reale sociale. Ndonëse kërkimet eksplicite gjithmonë janë deklaruar se ishin vënë në shërbim të së ardhmes, realisht kanë qenë të kapura prej *virusit të thelbeve të amshuara* (R. Barthes, “Le mythe aujourd’hui”) apo të prira drejt një shëmbëlltyre të rëndomtë të “hulumtimit të relikteve” që synon gjurmimin e mbeturinave të lashtësisë.

Duke qenë vijë fetare tërësisht jozyrtare, shumë e afërt me shtresat e vegjëlisë, bektashinjtë dhe degët e tjera ndihmuan që banorët vendas të kalonin

12. Frashëri K. (2012/2). *Sulejman Naibi dhe vendi që ai zë në letërsinë shqipe të shekullit XVIII*, “Perla”, Tiranë.

13. Doja A. (2008). *Bektashizmi në Shqipëri: Histori politike e një lëvizjeje fetare*, Tiranë, 2008.

nga magjistarizmi në besimin në një Zot. Aq të ngushta kanë qenë lidhjet e bektashizmit, lëvizjet e tij të alevizmit dhe hurufizmit, apo dhe sekte të tjera të përfaqësuara me to, me banorin e thjeshtë të perandorisë shumëkombëshe, saqë studiuësja turke Suraiya Faroqhi gjykon se ato “mund të provojnë praninë e një shoqërie civile në perandorinë osmane”.¹⁴ Edhe më të nevojshme kanë qenë ato për atë pjesë të largët e të veçuar të perandorisë, në jug-perëndim të gadishullit ballkanik.

Qendrat bektashiane në vijim kanë qenë qendra kulture dhe edukimi, ku mbizotëronte mirëkuptimi, dashuria dhe nderimi për njeriun, pavarësisht pozicionit të tij shoqëror, racor, gjinor apo kombëtar:

*Vetë ju thotë fakiri:
në ju paça faj, më mviri...
O zemëra ime, mos qaj
se Nezimi nuk ka faj.
...*

*Në bejte u bëshë mahir,
ujdis të më thonë shair;
shiri im u bë xhevahir,
gëzoi gjithë dynjanë.*

Elemente të moralit të kohës zbulohen prej qëndrimit të tij satirik ndaj mendësisë primitive të mburrjes me fis:

*Ata që s'kanë një hyner,
po rinë e mburren me fis,*

apo mbivlerësimin të gjendja materiale e cila nuk është siguri:

*Pse ke mall në këtë dynja,
mos pandeh se je vakti hosh;*

Siç di të dashurojë, të vlerësojë mikun e vërtetë, po me këtë forcë arrin të urrejë dyfytërsinë (mynafikun):

*Gahado që paçë nonjë mik
Të gjithë bëra imtiban,
Mynafiku o birader
Sakën mos të bënë këshmer,*

Shigjeton teprimet, veçmas kur ato janë për dukje:

*Me allaj asqeri kur shkoj
Maletë e fushat i mbuloj*

Kjo poezi, jo vetëm e paraqet faktin social, por ajo mban në vete vlerësime sociale, siç ka pohuar studiuësi Mahmud Hysa, të cilat dalin të gërshetuara me përmbajtjet e tjera në kuadër të poezisë.

Përfundime: Propozime

Një tjetër çështje që duhet analizuar me imtësi në sfondin historik të bektashizmit është raporti i urdhrimit të dervishëve me lëvizjen sufi të Islamit, të zhvilluar nga një numër misionarësh nga Horasani, të cilët kalojnë në Anadoll, duke filluar nga shekulli XI.

Analiza shkencore e trashëgimisë së islamit osman në Ballkan, së pari është e nevojshme që të njohim dallimin në fatet fetare dhe kulturore të popujve në zonën që ishin nën sundimin osman, duke filluar nga shekulli XIV. Ato ndihmojnë që të shihet se te divani i

14. Faroqhi S. (1995). *Conflict, accommodation and long-term survival: the Bektashi order and the Ottoman state* (sixteenth-seventeenth centuries), in Bektachiyya: études sur l'ordre mystique des Bektachis et les groupes relevant de Hadji Bektach, ed. Alexandre Popovic and Gilles Veinstein (Istanbul: Isis).

Nezimit ka edhe elementë realistë të antropologjisë kulturore apo etnologjisë, “*më shkencoren e natyrës njerëzore dhe më njerëzoren e shkencave shoqërore*”, siç do ta quante E. Wolf. Vëzhgimi objektiv i poetit alamiado zbulon karakteristikat themelore të traditës së Beratit e më gjerë, sidomos kodin moral të tyre dhe rolin e tij në strukturën sociale të saj.¹⁵

Duke e lexuar dhe interpretuar deskriptivisht këtë lloj krijimtarije e cila është një bankë e vërtetë faktesh me vlerë të padiskutueshme, kemi qenë të qetë, sepse siç thuhet injoranca është çelësi i lumturisë. Më prekëse është ajo kur ka pasur hapësirë në kërkimet shkencore, të cilat janë kryer në kushtet e një mbylljeje ndaj tregut të lirë të ideve universale. Në thellësi të ideologjisë shqiptare ka një urrejtje që frymëzon neveri për mondializmin e tregjeve. Të thënë “Jo” fundamentalizmit të tregut të lirë nuk i ka bërë shqiptarët më të lumtur, por vetë më të varfër dhe më të izoluar, gjë që më së fundmi po kuptohet. Ksenofobia i bindi studiuesit shqiptarë se duhej të shkonte mali te Muhamedi, ndërsa krenaria absurde shfaqej me distancën që mbanim ndaj tjetrit, gjë që nuk ndihmoi për të ruajtur një identitet të pasur dhe të fuqishëm, por na shkëputi nga pjesa tjetër e botës.

Në kushtet e hapjes duhen zbuluar nënkuptimet dhe kodet mistike brendashkruar te vargjet e Nezimit, si dhe duhen analizuar pikëpamjet e tij ideosinkretike. Tharmi se si lexohet dhe kuptohet një vepër gjendet brenda vetë veprës, e cila ka reflekse edhe të elementëve jashtëtekstorë. Duke krijuar mitin i leximit, dhe jo vetëm për këtë autor, do të rritet objektiviteti në vlerësimin e letërsisë sonë të traditës.

Me krijuesit alamiado letërsia shqipe zhvilloi mitin e përshtatjes, madje dhe të manipulimit, sepse ato u lexuan pasi u transkriptuan apo transliteruan. Së fundi, pjesa më e madhe e letërsisë alamiado shqiptare është botuar shoqëruar me punime kritike, të cilat japin mundësinë e zbulimit të “vullnetit të autorit të tekstit” (në konotimin filologjik të këtij termi), siç ngulmon studiuesja Dhurata Shehri, e cila beson se ka ardhur koha e rileximit të letërsisë sonë klasike, kurse kritika e hapur të përforcojë prirjen e saj “të ndërmjetësorë pa pushim e pa kufi marrëdhënien e privilegjuar të lexuesit me letërsinë”.

Me divanin e parë në shqip, interpretimi lind si nevojë dhe bëhet domosdoshmëri. Analiza e imtë e të dhënave në vepër me lidhjet e autorit me mjedisin social, do të bashkojnë *intencio auctoris*, *intencio operas* dhe *intencio lectoris* për të mbërritur aty ku duhet të mbërrijë kritika e vërtetë, te miti i origjinalit dhe te thelbi i saj, ndërmjetësimi, individual në nisje e kolektiv në mbërritje. Depërtimin në thellësitë e njohjes së popullit shqiptar duhet ta nisim nga zhbirimi i botës së tij shpirtërore.

Tashmë nuk është më ai “inat” ideologjik bardhezi për vlerësimin e shkrimtarëve alamiado, kur arrihej të flitej deri për “dalldisje” pas bejtexhinjve.¹⁶ Te divani i Nezimit lexuesi shqiptar sheh një model të letërsisë turke, ashtu si studiuesi turk Necmettin Turinay dhe kolegë të tij shohin Ballkanin në letërsinë turke.

Madje interesi shkencor për të shkon më larg, deri në degën e St. Petersburgut të Institutit të Studimeve Orientale të Akademisë Ruse të Shkencave:

15. Sokoli L.(2011). *Metodat e kërkimit*, Tiranë.

16. Frashëri K. (2006). *Identiteti Kombëtar Shqiptar dhe Çështje të Tjera*, Tiranë.

“Poezia e Nezimit është sigurisht e ndryshme nga ajo që është shkruar më parë në gjuhën shqipe, sepse ndryshon edhe në gjuhën dhe në strukturën e imazhit që përdor. E megjithatë në të njëjtën kohë arti i tij është absolutisht i përzier me poezinë e përgjithshme myslimane, me kanonet e saj unike, pa marrë parasysh se në cilën gjuhë është shkruar.

Botimi i ri i poezisë së Nezimit si një e tërë është fakt i këndshëm, dhe shuma e të gjitha materialeve, i njohur nga botimet e hershme të pakoordinuara nga O. Myderrizi, H. Kaleshi, M. Hysa, A. Hamiti, është mjaft e dobishme. Megjithatë, është shpresa jonë që më tej, publikimet nga seritë e “Divan-it” do ta kushtojnë më shumë vëmendjen e tyre për probleme kodikologjike dhe tekstologjike dhe ne do të shohim të paktën fotokopje të origjinaleve arabografike.”¹⁷

Nezim Berati, mes frymëzimit të tij idealist, i solli lexuesit shqiptar porosinë e *Mesnevisë* së Mevlana Rumiut:

Mesnevia jonë është një dyqan i njëshmërisë hyjnore,

Çfarëdo që ju shihni atje, përveç Një, është ajo një idhull i rremë.

E bëri këtë duke e lidhur divanin e tij me të ardhmen e popullit shqiptar, pa dallim besimi, ndaj arti i tij nuk ka vjeshtë. Ndodhi si me vepren e Rumiut:

“Rumi, një trashëgimtar i vërtetë i të Dërguarit që i është dërguar gjithë njerëzimit, fliste një gjuhë të jashtëzakonshme. Ashtu si një

palë e kompasit, ai kishte një këmbë të fiksuar në vlerat e tij, dhe pastaj ai përqafoi të gjitha kombet që ai e mori si manifestim i Dritës së Perëndisë. Myslimanët panë mësimet e Profetit Muhamed mishëruar në të, në të njëjtën kohë ai përfaqësonte mësimet e Jezusit për të krishterët dhe ato të Moisiut për hebrejtë. Një mendje e pjekur dhe një zemër entuziaste ishin të bashkuara në të. Kjo është arsyeja pse ai ka mirësinë, jehona e zërit të tij është duke u dëgjuar ende. Ne mund të themi atë që ai tha në lidhje me Shamsin për vetë Rumiun:

*Derdh ujë mbi rrugë,
ti përgëzoji kopshtet
era e pranverës po vjen,
Ai po vjen - ajo është “ai!”¹⁸*

Libri është botuar me rastin e 800 vjetorit të lindjes së Rumiut, (1207 Balkh -1273 Konya), por te ne, mjeshtëri i madh sufi Xhelaledin Rumi, kishte ardhur shekuj më parë me “Divanin” e Nezimit, filozofia e tij humane, e cila kishte shtuar ngjyra, pas një të shkuare gri në kufijtë e ekzistencës. Në hyrje të librit të vet, studiuesi i shquar i Rumiut, Cihan Okuyucu pranon gjykimin e Irene Melikoff¹⁹, e cila sugjeroi se, “në qoftë se kombet e botës kanë për të përkthyer vepra të Rumiut në gjuhët e tyre dhe do t’i lexonin ato, nuk do të kishte të keqe apo luftë, nuk do të kishte armiqësi apo urrejtje në botë”, (jam i nderuar ta pranoj si të vërtetë të provuar).

E kemi nderuar mikun sipas kodit tonë të lashtë etik. Me Nezimin lidhëm miqësi me urtësinë dhe mirësinë e

18. Okuyucu C. (2007). *Rumi – Biography and message*, New Jersey.

19. Melikoff I. (1983). *The Humanism of Rumi Versus Western Humanism*, (26 Researchers on Rumi), Konya.

17. Wojewódzki I. N. (2009). *Manuscripta Orientalia*, Vol. 15, Nr. 2, December, St. Petersburg.

mjeshtrit Rumi. Dëgjuam këshillat e poetit Yunus Emre, i cili te poezia “Gjej paqen e përsosur”, e divanit “Pika që bëhet det”, porositi:

*Junus Emre thotë gjithashtu
Më lejoni të marr atë që kam nevojë.
Gjëja më e mirë e mundshme
Është të gjes paqen e përsosur.*

Ajo dhuratë na erdhi si ilaç për të dobësuar sadopak komponentin “hakmarrës” të identitetit tonë kombëtar. Me rileximin dhe studimin e veprës së tij tregojmë se po e ruajmë

si një nder. Përvoja popullore ka krijuar proverbin shqiptar: *Të krijosh një miqësi është mirë, të kesh një miqësi është dhuratë, të ruash një miqësi është virtyt, të jesh mik është nder.*

Nezim Berati u rikthye me dinjitetin që i takon në tryezat tona të leximit e studimit, sepse siç thotë Elio Miraço, arbëresh, profesor në universitetin *La Sapienza*, Romë, studiues i gjuhës dhe i letërsisë shqipe:

“Vetëm librat e mirë kanë forcën e madhe për t’i bërë të përjetshëm njerëzit”.

Bibliografia dhe referencat

1. Doja A. (2008). *Bektashizmi në Shqipëri: Histori politike e një lëvizjeje fetare*, Tiranë.
2. Faroqi S. (1995). *Conflict, accommodation and long-term survival: the Bektashi order and the Ottoman state* (sixteenth-seventeenth centuries), in Bektachiyya: études sur l'ordre mystique des Bektachis et les groupes relevant de Hadji Bektach, ed. Alexandre Popovic and Gilles Veinstein (Istanbul: Isis).
3. Frashëri K. (2012/2). *Sulejman Naibi dhe vendi që ai zë në letërsinë shqipe të shekullit XVIII*, “Perla”, Tiranë.
4. Frashëri K. (2006). *Identiteti Kombëtar Shqiptar dhe Çështje të Tjera*, Tiranë.
5. Ismajli R. (1994). *Etni dhe Modernitet*, Pejë.
6. Hamiti S. (2010). *Poetika shqipe*, Tiranë.
7. Konica F. (1993). *Vepra*, Tiranë.
8. Krasniqi M. (2012). *Rrjedhimet historike dhe kulturore të sundimit osman*, “Zani i Naltë”, Nr. 1.
9. Melikoff I. (1983). *The Humanism of Rumi Versus Western Humanism*, (26 Researchers on Rumi), Konya.
10. Okuyucu C. (2007). *Rumi – Biography and message*, New Jersey.
11. Puzanova V. (2005). *Mbi artin bizantin dhe post-bizantin shqiptar*, Tiranë.
12. Roller, Lynn E. (1999). *In Search of God the Mother The Cult of Anatolian Cybele* (Berkeley-Los Angeles: University of California Press). New Book on Magna Mater.
13. Sokoli L. (2011). *Metodat e kërkimit*, Tiranë.
14. Schwartz S. (2010, 2012). [Presented to Indiana University Bloomington Conference *The Turks and Islam*, September 12, 2010, revised January 2012].
15. USHT, (1959). *Historia e Letërsisë Shqipe I*, Tiranë.
16. Wojewódzki I. N. (2009). *Manuscripta Orientalia*, Vol. 15, Nr. 2, December, St. Petersburg.

Said Najdeni dhe fillimet e arsimit shqip në Dibër

Dr. Mois Kamberi
Durrës

Abstrakt

Zhvillimi i gjithanshëm i Dibrës, roli i saj si qendër e organizimit të besës dhe unitetit të krabinave shqiptare gjatë Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, si qendër e luftës për mbrojtjen e krabinave shqiptare nga politikat e Fuqive të Mëdha dhe monarkive ballkanike e Perandorisë Osmane, e bënë Dibrën jo vetëm një krabinë të luftës e qëndresës, por dhe një qendër të propagandimit dhe të përhapjes së arsimit e shkollave në gjuhën shqipe.

Ashtu si dhe në shumë treva shqiptare, në fund të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX, lëvizja arsimore e kulturore në Dibër morën përmasa më të mëdha duke e bërë Dibrën trevë përcaktuese në përhapjen e arsimit shqip në Shqipërinë verilindore dhe në krabinat e tjera shqiptare. Është e dokumentuar se “Abetarja e gjuhës shqipe” e shkruar dhe e botuar nga Kostandin Kristoforidhi në vitin 1867 në Stamboll me dialektin toskërisht e gegërisht, u përhap dhe u mirëprit në Dibër me një entuziazëm e dashuri shumë të madhe. Në një letër të Kristoforidhit të vitit 1871, tregohet entuziazmi me të cilin e kishin pritur në Shqipëri e veçanërisht në Dibër e në disa qytete të tjera të Shqipërisë qendrore këtë abetare.¹

1. M.H.D, Kumtesë, Hysni Myzyri, ”Përpyekjet për arsimin shqip në Dibër”, Peshkopi, 1980, f. 1.

Shtytje edhe më të madhe lëvizjes arsimore në Dibër i dha Lidhja Shqiptare e Prizrenit. Gjatë kësaj periudhe Dibra ishte shndërruar jo vetëm në një qendër të kësaj Lidhjeje, por dhe mbrojtësja kryesore e platformës së saj për përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe. Në kuvendet e Lidhjes Shqiptare në Dibër të 14 tetorit 1878 dhe të 1 nëntorit 1878, krahas kërkesave me karakter autonomist, u përfshi dhe kërkesa për përhapjen e arsimit në gjuhën shqipe si:

- njohjen e gjuhës shqipe nga nëpunësit,
- zhvillimin e arsimit dhe futjen e gjuhës shqipe në shkolla,
- përdorimin e një pjese të buxhetit për arsimin e punët botore etj.¹

Pas shtypjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, iu dha një shtytje me rëndësi shumë të madhe zbatimit të programit kulturor dhe sidomos zhvillimit të arsimit. Pas Lidhjes, lufta për arsimin

1. *Akte të Rilindjes Kombëtare Shqiptare 1878-1912*, Tiranë, 1978, f. 69.

shqip dhe kulturën kombëtare arritën në një shkallë më të lartë. Lëvizja arsimore e kulturore kombëtare do të ndikonte në afirmimin e kombit shqiptar, në rritjen e vetëdijes kombëtare, për bashkimin dhe mobilizimin e popullit shqiptar në luftë për zbatimin e programit të lëvizjes kombëtare shqiptare deri në shpalljen e pavarësisë. Ky program gjeti menjëherë përkrahje dhe zbatim në shumë krahina shqiptare dhe u shoqërua me hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Pengesë kryesore për përhapjen e arsimit shqip ishte vetë Perandoria Osmane. Ajo i përjashtoi shqiptarët nga e drejta për të përdorur lirisht gjuhën e tyre në institucionet arsimore, kulturore e fetare. Pengesat e Portës së Lartë për hapjen e shkollave shqipe dhe për përhapjen e arsimit e shkrimit shqip, krijuan kushtet për hapjen e shkollave greke, serbe e bullgare në këto krahina.

Me gjithë censurën e egër, mësimi dhe shkrimi i gjuhës shqipe filluan të bëhen fshehurazi. Shumë rilindas bënë përpjekje për të nxjerrë lejen e përdorimit të gjuhës amtare në shkollat e vendit dhe për botimin e librave shqip dhe shpërndarjen e tyre në të gjithë Shqipërinë. Rilindasit e kishin të qartë që emancipimi politik nuk mund të arrihej pa emancipimin kulturor. Emancipimi kulturor do të bëhej nëpërmjet përhapjes së gjuhës shqipe, përhapjes së diturisë dhe shkollës shqipe që do të ndërjegjësonin shqiptarët për mbrojtjen e kombit dhe çlirimin e tyre nga sundimi osman. Në Dibër, këto përpjekje të rilindasve gjetën mbështetjen dhe përkrahjen e gjithë krahinës. Kultura dhe arsimit u përhapën jo vetëm në Shehër (Dibër të Madhe),

por dhe në rrethinat e saj. Kudo u ngritën objekte kulturore e fetare. Në Dibër e rrethina u hapën shumë shkolla publike (shtetërore), private dhe fetare. Sipas të dhënave osmane e arkivave të huaja, në Dibër e rrethinë pas vitit 1875 ka pasur rreth 33 shkolla fillore islame, 2 shkolla fillore të krishtera, 7 medrese, një ruzhdie.²

Ky fakt tregon se Dibra dhe rrethinat e saj kishin një ngritje të mjaftueshme arsimore e kulturore, që shërbente si bazë për përhapjen e gjuhës e shkollave shqipe. Ngritja kulturore e krahinës së Dibrës u dëshmuar sidomos pas hapjes më 7 mars 1887 të shkollës së parë shqipe në Korçë. Në shembullin e Korçës, shkolla shqipe u hapën në Dibër dhe në shumë krahina të tjera të Shqipërisë si: në Elbasan, Krujë, Korçë, Berat, Gjirokastër, Kolonjë, Pogradec, Vlorë, Përmet, Skrapar, Çamëri, etj. Këto shkolla, në të cilat mësuesit atdhetarë u mësonin fëmijëve dhe të rriturve alfabetin e gjuhës shqipe³, u çelën pranë shtëpive private dhe dyqaneve. Shkolla shqipe u hap dhe në Rekë të Dibrës⁴, e para shkollë shqipe në këtë krahinë. Në lëvizjen mbarëkombëtare për përhapjen e mësimi dhe të shkollave shqipe, një rol të veçantë luajtën Dibra dhe atdhetarët dibranë Said Najdeni (Hoxhë Voka), Hamdi bej Ohëri, Dervish Hima, Shaqir Daci, Kadri Fishta, Hoxhë Muglica etj. Në lëvizjen për përhapjen e shkrimit e mësimi shqip, ndër të parët u shqua

2. M.H.D, "Dibra dhe etnokultura e saj", Vëll. II, Dibër, 1995, f. 79.

3. *Histori e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Tiranë : Toena, 2002, f. 350.

4. A.Q.SH, *Fondi arsim*, D. 25, f. 24; "Historiku i shkollës shqipe në Dibër", Peshkopi, 1980, f. 27.

Said Najdeni i njohur me emrin Hoxhë Voka.⁵ Pasi u kthye në Dibër, brenda një kohe të shkurtër, Saidi së bashku me Shaqir Dacin, Shyqyri Qokun, Hamdi Ohërin, Kadri Fishtën, Nazif Sharofin, Hajdar Varvaricën etj, formuan një vatër patriotësh dibranë të cilët i vunë detyrë vetes të përhapnin shkrimin shqip dhe veprat e rilindasve brenda dhe jashtë qytetit.

Në vitin 1888, Said Najdeni hapi të parën shkollë shqipe në qytetin e Dibrës. Po në këtë vit, Saidi, si një pjesëtar aktiv i Shoqërisë së Shkronjave Shqipe të Stambollit, mundi të organizojë dhe të formojë një shoqëri patriotike thjesht me të rinj dibranë me plot etje për mësimin, shkrimin e këndimin e gjuhës shqipe. Said Najdeni u dhuroi atyre




dhe abetare⁶ e hartuar në vitin 1879 nga patriotët e Shoqërisë së Stambollit dhe abetaren e hartuar në vitin 1886 nga Sami Frashëri. Kjo shoqëri ishte njëkohësisht dhe shkolla e parë shqipe në qytetin e Dibrës. Shkolla shqipe e hapur në Dibër, ishte një shkollë e thjeshtë. Në të nxënësit vinin dhe mësonin fshehurazi për të mos rënë në sy të autoriteteve osmane. Aty mësohej

5. M.H.D, *Said Najdeni, (Hoxhë Voka)*, Fondi XII/1, Dosje patriotësh, Dosja, nr. 495.

Said Najdeni lindi në qytetin e Dibrës së Madhe më 1864. Studimet i kreu në Fakultetin e Teologjik të Stambollit. Pas studimeve ai u kthye në atdhe në qytetin e lindjes ku në vitin 1888 krijoi një shoqëri për mësimin e shkrimin shqip. Veprimtarinë e tij e shtriu jo vetëm në Dibër por dhe krahinat rreth saj në Gollobordë, në Grykë të Vogël, në Bllacë, në Maqellarë, në Brezhdan, në Dohoshisht e shumë fshatra të tjerë të Dibrës. Qeveria turke në vitin 1895 duke parë aktivitetin e Saidit e arrestoi atë dhe e burgosi në Edrene. Edhe në burg Saidi nuk i shkëputi lidhjet me atdhetarët shqiptarë dhe luftoi për çështjen kombëtare. Said Najdeni ishte një nga frymëzuesit e organizatorët e Lidhjes së Pejës më 1899, bashkëpunëtor i ngushtë i Haxhi Zekës në Besëlidhjen e Dibrës të shkurtit 1899. Në vitin 1900 boton "Abetaren e Gjuhës shqipe" dhe "Ferëfenjësen e Myslimanëve". Saidi rihapi shkollën shqipe në Dibër në vitin 1893 dhe 1900. Njëpërmjet ngritjes së tij atdhetare, ai ndikoi në ndërgjegjësimin e dibranëve në luftën për liri e pavarësi. Saidi vdiq në moshën 39 vjeçare, më 21 nëntor 1903.

6. M.H.D, *Dorëshkrim, "Djelmnia dibrane"*, D.148, f.8.



alfabeti shqip, lexohej në gjuhën amtare, mësohej të numërohej dhe bëheshin biseda me temë nga historia e popullit shqiptar. Në këtë shkollë gjithashtu merreshin njohuri dhe nga shkencat e natyrës e feja.

Shkolla e parë shqipe në Dibër u hap në një nga dyqanet e pazarit, në dyqanin e opingarit Sherif Gorenxa, aty afër xhamisë. Në bodrumet e këtij dyqani Hoxhë Voka jepte mësim për një grup nxënësish. Kjo ishte një shkollë e fshehtë, klasat e saj ishin *izbat* e errëta të dyqaneve dhe odat e fshehta të shtëpive.⁷ Nxënësit e parë të kësaj shkolle ishin: Selim Rusi, Shaban Pepa, Daut Varvarica, Kadri Fishta, Murat Piperku, Dullë Nallbani, Zenepe Qoku (motra e Shyri Qokut, gruaja e ardhshme e Dervish Himës dhe gruaja e parë dibrane që mësoi shkrimin shqip në Dibër), Aziz Menzelxhiu, Osman Lleshi, Shaban Daci, Ramiz Daci, Qamil Daci, Shyqyri Daci, Nuredin Xhemalçe, Vehbi Xhidri, Hasan Ballanca, Vehbi Hatibi, Hafëz Sherif Palikuqi, Hafëz Abdurahimi, Hafëz Muhameti, Sheh Latifi, Sefedin, Qazim e Hysni Najdeni, Razije Pregja (Najdeni) etj.⁸

Shkolla shqipe që u çel në Dibër në vitin 1888, nuk pati jetë të gjatë, megjithatë ajo u bë një qendër e rëndësishme patriotike. Të shqetësuar nga aktiviteti patriotik i kësaj shkolle, autoritetet osmane e zbuluan dhe morën masa jo vetëm për mbylljen e saj, por dhe për ndjekjen dhe burgosjen e të gjithë atyre që propagandonin mësimin shqip në Dibër.

7. M.H.D, Ismail Strazimiri, “Lëvizja kombëtare në Qarkun e Dibrës”, Tiranë, 1931, f. 2.

8. S. Temo, L. Bilbili, P. Najdeni, *Monografi, “Said Najdeni”*, Tiranë, 1980, f. 32.

Rreziku i copëtimit të viseve shqiptare, riaktivizimi i pretendimeve të shteteve ballkanike ndaj trojeve shqiptare të Kosovës, të Dibrës etj, i dhanë një shtytje të re jo vetëm lëvizjes për mbrojtjen e trojeve shqiptare nga copëtimi, por dhe lëvizjes për shkollat shqipe. Situatën e krijuar e shfrytëzuan mjaft mirë atdhetarët dibranë të cilët, pas vitit 1890, nëpërmjet kryengritjeve të vazhdueshme kundërshtuan reformat osmane dhe politikën e shteteve ballkanike dhe bënë përpjekje për rihapjen e shkollave shqipe në Dibër. Në vitin 1893 Said Najdeni u rikthye në Dibër pas internimit dhe rihapi përsëri shkollën shqipe të mbyllur në vitin 1888. Situata e krijuar, ofroi përsëri hapësira për shtrirjen e aktivitetit politik, arsimor e kulturor jo vetëm në qytetin e Dibrës, por dhe në krahina të tjera rreth saj. Rihapja e shkollës shqipe në qytetin e Dibrës, ndikoi në shtrirjen e rrjetit të shkollave shqipe dhe në malësitë e Dibrës: në Gollobordë u hap një shkollë shqipe në shtëpinë e Hoxhë Muglicës⁹, atdhetar i flaktë i çështjes kombëtare, shkolla shqipe u hapën dhe në Maqellare, në Dohoshisht pranë shtëpisë së atdhetarit Hasan Zajmi, në Brezhdan, në Homesh¹⁰ dhe në Grykën e Vogël tek shtëpia e Sheh Sulës, Babai i Teqesë në Bllacë etj.¹¹

Rikthimi në Dibër i Said Najdenit, me një politikë të qartë arsimore, ndikoi jo vetëm në rihapjen e shkollës shqipe të vitit 1888, por dhe në formimin e një vatre patriotësh dibranë me pjesëmarrje

9. M.H.D, *Hoxhë Muglica, “Historiku i shkollës shqipe në Dibër”*, Peshkopi, 1980, f. 62.

10. M.H.D, Bukurie Zeneli, *Kujtime historike, dorëshkrim*, Dibër 1985, f. 23.

11. M.H.D, *Dorëshkrim*, Haki Stërmilli, “Dibra në prag të historisë”, Tiranë, 1940, f. 36.

të figurave të shquara dhe aktivistë aktivë si: Shaqir Daci, Kadri Fishta, Shyqyri Qoku, Hamdi Ohëri, Nazif Sharofi, Hajdar Varvarica etj., të cilët i vunë vetes si detyrë të rrisnin aktivitetin arsimor për përhapjen e shkrimit shqip dhe shkollave shqipe në Dibër e rrethina. Në vitin 1894, Shaqir Daci, një ndër nxënësit dhe bashkëpunëtorët e ngushtë të Said Najdenit, shkoi në Homesh dhe me mbështetjen e patriotit Mersim Dema hapi në këtë fshat shkollën e parë shqipe.¹² Shkolla u hap në shtëpinë e Mersim Demës, por edhe kjo shkollë nuk pati jetëgjatësi dhe u mbyll shpejt. Pavarësisht nga kohëzgjatja, në këtë shkollë mësuan të lexonin e të shkruanin shqip shumë nxënës nga fshatrat e Kovashicës, Bllacës, Boçevës, Homeshit etj.

Për përhapjen e arsimit e shkollave shqipe, një ndihmesë mjaft të madhe, krahas faktorit vendas, dhanë dhe shoqëritë patriotike të krijuara brenda dhe jashtë atdheut. Këto shoqëri siguronin dhe sillnin fshehurazi abetaret dhe librat shqip, që pastaj shpërndaheshin në të gjitha krahinat. Librat shqip në Dibër vinin nga kolonitë shqiptare të Stambollit, Bukureshtit, Sofjes. Librat silleshin deri në Shkup e më tej, nëpërmjet qiraxhinjve, shpërndaheshin në qytetin e Dibrës, në Zerqan, Bulqizë, Homesh, Bllacë, Luzni, Lurë, Gollobordë, Rekë etj. Në Zerqan librat drejtoheshin për në Teqe tek Sheh Sula¹³, në Bulqizë tek Karaj, në Homesh tek Mersim Dema, në Bllacë tek Baba Sufa i parë dhe në Lurë tek

Kolë Bibë Doçi.¹⁴ Gazeta “Drita” e Sofjes shkruante: “Qysh në vitin 1893, Said Najdeni kishte marrë nga Stambolli një tog me libra shqip dhe kishte shkuar në Dibër të Madhe për t’u mësuar shqipen dibranëve”.¹⁵

Nga Bukureshti e Sofja vinin gjithashtu deri në Shkup dhe materialet mësimore; nga Shkupi silleshin në Dibër dhe prej andej shpërndaheshin në Zerqan, në Bulqizë, në Mat e deri në Tiranë.¹⁶ Përpjekjet për hapjen e shkollave shqipe në Dibër e Malësi vazhduan dhe në vitet në vazhdim. Shpesh patriotët dibranë e shqiptarë u detyruan të organizonin protesta kundër autoriteteve osmane, që pengonin hapjen e shkollave shqipe dhe protesta për të mos lejuar në Shqipëri ngritjen e kishave bullgare, greke e serbe. Protestat arritën kulmin në vitin 1894, kur Sulltanit iu dërgua një memorandum nga Shqipëria në emër të treqind fshatrave shqiptare të disa krahinave të vilajeteve të Kosovës e Manastirit. Në memorandum parashtrohej ankesa ndaj Portës së Lartë sepse u kishte dhënë mundësi bullgarëve, serbëve dhe grekëve të ngrinin në viset shqiptare të Dibrës, të Prizrenit, të Prishtinës e gjetkë, shkolla, peshkopata e seminare në gjuhët e tyre. Në këtë memorandum kërkohej gjithashtu leja për hapjen e shkollave shqipe në këto vise.¹⁷ Kundrejt këtyre kërkesave të shqiptarëve, menjëherë

14. Gazeta ” Drita “e Sofjes 1903, nr. 2, 17/30, vjeshtë e tretë.

15. Gazeta “Drita” e Sofjes 1903, nr. 2, 32/21, vjeshtë e tretë.

16. M.H.D, *Referat*, Hilmi Sadiku, “*Arsimi në gjuhën shqipe dhe çështja e alfabetit në krahinën e Dibrës*”, Peshkopi, 1976, f. 28.

17. *Histori e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Tiranë : Toena, 2002, f. 259.

12. M.H.D, *Mersim Dema*, Fondi XII/1, dosje patriotësh, nr. 327; Haki Stërmilli, *vepër e cituar*, f. 36.

13. M.H.D, *Sulejman Shehu (Sheh Sula)*, Fondi XII/1, dosje patriotësh, D. 596.

vepruan autoritetet osmane. Këtë presion direkt të autoriteteve, e ndjenë më shumë atdhetarët dibranë Said Najdeni dhe Dervish Hima (Ibrahim Naxhiu).

Në vitet 1895-1899, Dervish Hima erdhi prej Stambolli. Në Shqipëri, dhe sidomos në Dibër, ai gjeti terrenin e përshtatshëm dhe bashkëpunimin me Said Najdenin, që i dhanë një shtytje të mëtejshme lëvizjes për hapjen e shkollave shqipe në Dibër. Në Dibër, në lëvizjen për arsimin e shkollën shqipe, me gjithë masat e rrepta ushtruar nga autoritetet osmane, krahas Said Najdenit e Dervish Himës, u shquan për veprimtarinë e tyre arsimore dhe ish-nxënësit e Said Najdenit.

Për të penguar lëvizjen për arsimin shqip dhe hapjen e shkollave shqipe në Dibër e rrethina, autoritetet arrestuan dhe internuan propaganduesit e arsimit shqip në Dibër. Atdhetarët arsimdashës dibranë, për t'u shpëtuar persekutimeve dhe për të realizuar misionin e tyre, hapjen e shkollave shqipe, shpërndarjen e abetareve, gazetave e librave shqip të shkrimtarëve të Rilindjes, lëviznin nga një qytet i Shqipërisë në tjetrin, nga njëra krahinë në tjetrën. Dervish Hima i shkruante atdhetarit Ibrahim Temo në fillim të korrikut 1896 se ai ishte në lëvizje të vazhdueshme, sepse ndodhej nën mbikëqyrje të plotë të autoriteteve osmane. Ai theksonte se: "Sot ndodhem në Elbasan, nesër shkoj në Tiranë, pasnesër në Bërzheshtë, javën tjetër në Strugë e njëherë tjetër në Dibër."¹⁸

Pas kthimit në Dibër, Said Najdeni së bashku me nxënësit e tij: Shaqir Daci, Shyqyri Qoku, Kadri Fishta,

Hamdi Ohëri, Nazif Sharofi, Hajdar Varvarica etj., në vitin 1896 organizuan brenda në Shehër (Dibër), në shtëpinë e Abdullah Manjanit, një kurs të fshehtë për mësimin e shkrimit shqip. Ky kurs dokumentohet si i pari kurs shqip në trevën e Dibrës.¹⁹ Me nismën e tyre, po rreth vitit 1896 ata formuan një shoqëri të fshehtë për përhapjen e mësimin shqip dhe për të përballuar shpenzimet me fondet që do të siguroheshin nga kontributet që do të mblidheshin.

Në vitin 1896, autoritetet arrestuan dhe mbyllën në burgun e Manastirit dhjetëra të rinj dibranë. Po në vitin 1896, Said Najdeni u internua në Edrene, kurse Dervish Hima, për t'u shpëtuar ndjekjeve e arrestimit, në vitin 1897 u detyrua të largohej jashtë Shqipërisë. Për vetë kontributin që po jepte për përhapjen e mësimin e shkollave shqipe në Dibër e më gjerë, të njëjtin fat si dhe Said Najdeni pati dhe Hamdi Ohëri i cili u burgos në Manastir. Hamdi Ohëri është i pari patriot dibranë, që lëshoi një deklaratë politike, në të cilën parashtronte aspiratat kombëtare të shqiptarëve. Ai, i informuar mirë për nevojat e ngutshme të dibranëve për libra e shkolla shqipe, në një korrespondencë me Ibrahim Temon, shkruan: "Në Dibër po shtohen mësuesit e gjuhës shqipe. Vazhdimisht kërkojnë libra. Aman përpiku që librat të vijnë këtu shpejt. Librat të vijnë këtu një sahat e më parë."²⁰

Në fund të vitit 1897, Said Najdeni, pas internimit u rikthye në Dibër. Ai kishte sjellë nga Stambolli libra shqip dhe kudo ku kaloi: në Ohër, në Strugë, në Elbasan, propagandoi nevojën e

18. A.Q.SH, *Fondi 12*, Dervish Hima, D. 9, f. 4/1.

19. M.H.D, Haki Stërmilli, *vepër e cituar*, f. 39.

20. A.Q.SH, *Fondi 19*, D. 32/2, f. 16.

hapjes së shkollave në gjuhën shqipe.²¹ Në vitin 1898, me dhjetëra patriotë të tjerë dibranë, ndër të cilët dhe Shaqir Daci, u përcollën me pranga në Manastir, kurse Said Najdeni, i cili u lirua atë vit, pas disa muajsh mori urdhër të linte përsëri vendlindjen me pretekstin se ishte “emëruar” pedagog në Medresenë e Sulltan Ahmetit në Stamboll. Me gjithë masat e rrepta, radhët e patriotëve dibranë u shtuan. Lidhjet e tyre me rrethet patriotike të krahinave të tjera brenda dhe jashtë Shqipërisë, u shtuan e u forcuan. Lidhje të vazhdueshme u mbajtën sidomos me shoqëritë shqiptare “Dituria” të Bukureshtit dhe “Dëshira” të Sofjes, me Kosovën dhe me Shqipërinë e Mesme nga vinin në Dibër abetare e libra shqip të rilindasve. Në Dibër u përhap në këtë kohë “Abetarja” e Sami Frashërit me të cilën raportonte konsulli austro-hungarez, A. Kral në Manastir: “Mësuan të shkruanin në gjuhën shqipe qindra dibranë. Deri në vitin 1899, kishin mësuar të shkruajnë e të lexojnë shqip më shumë se 300 dibranë”.²²

Lidhjet e vazhdueshme me shoqëri brenda e jashtë atdheut ndikuan në rritjen e personalitetit të disa atdhetarëve dibranë, të cilët për aktivitetin që kishin luajtur në dobi të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, u zgjodhën dhe në krye të këtyre komiteteve e shoqërive. Në fund të vitit 1898, Kadri Fishta hyri si përfaqësues i qarqeve patriotike dibrane në Komitetin Kombëtar të fshehtë, që u formua në Manastir nën kryesinë e Halit Bërzhestës, i cili mori drejtimin

e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare dhe të luftës për të drejtat autonomiste në mbarë vilajetin e Manastirit. Krahas Kadri Fishtës, kontribut të rëndësishëm në mbajtjen e kontakteve me rrethet patriotike shqiptare dhe sjelljen e botimeve në gjuhën shqipe në Dibër, ka dhënë Selim Rusi²³, i cili do të bëhet një figurë qendrore në lëvizjen kombëtare në vitet në vazhdim.

Në rrethanat kur marrëdhëniet e Portës së Lartë me Dibrën ishin acaruar, kur lëvizja për të drejtat autonomiste po ngrihej vazhdimisht, lindi e ashtuquajtura “Çështja maqedone”, e cila i detyroi dibranët, si mbarë shqiptarët, ta drejtonin vëmendjen e tyre tek lufta për mbrojtjen e tërësisë tokësore të atdheut, por pa i ndërprerë për asnjë çast dhe kërkesat për zhvillimin e arsimit shqip. Kjo lëvizje mbarëkombëtare arriti shkallën më të lartë të saj me formimin e Lidhjes së Pejës në janar 1899. Dibranët, ashtu si dhe në vitet e Lidhjes shqiptare të Prizrenit, u bënë mbështetësit kryesorë të Lidhjes së Re. Haxhi Zeka, drejtuesi kryesor i Lidhjes së Re, gjeti mbështetjen, përkrahjen dhe solidaritetin e fuqishëm të dibranëve, mbështetje e cila u shpreh dhe në kontributin për organizimin e një Kuvendi të Madh krahinor në Dibër. Kuvendi i Dibrës i zhvilloi punimet në shkurt-mars 1899 dhe ndikoi fuqishëm në gjallërimin e lëvizjes arsimore. Komiteti i Besëlidhjes së Dibrës kishte për detyrë jo vetëm të organizonte mbrojtjen e trevave shqiptare, por dhe të lëvronte gjuhën shqipe, të hapte shkolla shqipe dhe të siguronte mjetet

21. *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë, 1972, f. 43.

22. Hysni Myzyri, “*Shkollat e para kombëtare shqipe*”, Tiranë, 1978, f. 141.

23. M.H.D, *Selim Rusi*, Fondi XII/1, Dosje patriotësh, D. 496; - “*Dibra dhe Etnokultura e saj*”, Dibër, 1995, f. 287.

e duhura financiare për to. Këtë dëshirë të dibranëve për arsim e shkolla shqipe e shpreh dhe konsulli austro-hungarez Kral, i cili shprehej se: “Komiteti i Besëlidhjes së Dibrës kishte parashikuar në buxhetin e vet një fond për ndihmë materiale shkrimtarëve kombëtarë d.m.th shkrimtarëve që do të zhvillonin letërsinë kombëtare shqiptare. Më ka habitur fakti, - shprehet ai në raportin e 11 marsit 1899 -, se gati të gjithë personalitetet dibranë me të cilët pata fatin e rastin të bisedoj, më kanë bindur se në Kuvend i është kushtuar vëmendje shumë çështjeve të tilla si:

- bashkimi i të gjithë banorëve që flasin shqip, pavarësisht nga feja,
- barazi përballë pushtetit midis shqiptarëve të krishterë dhe myslimanë,
- kultivimi dhe ruajtja e gjuhës amtare,
- hapja e shkollave shqipe dhe sigurimi i materialit shkollor.”²⁴

Në Dibër, me nismën e patriotëve dibranë Shyqyri Qoku, Shaqir Daci, Kadri Fishta, Sefedin Pustina, Selim Rusi, Shaqir Jegeni, në kundërshtim me qëndrimet e emisarëve të Sulltanit, më 6 nëntor 1899 u thirr një mbledhje e veçantë me qytetarët e Dibrës në oborrin e Xhamisë së Madhe të Shehrit. Më 7 nëntor 1899 mbledhja zgjodhi “Komisionin Arsimor Shqiptar të Dibrës” me kryetar Shyqyri Qokun dhe me 31 anëtarë.²⁵ Komisioni i arsimit hartoi po atë ditë një promemorie, që iu dorëzua dy të dërguarve të Sulltanit, të cilët kishin ardhur për të qetësuar gjendjen në Dibër. Në këtë promemorie

thuhej ndër të tjera: “...Meqenëse në qytetin tonë, Dibër, flitet vetëm shqip dhe fëmijët e vendit nuk kanë pasur mundësi të arsimohen legalisht në gjuhën amtare, zemrat tona janë mbushur plot me hidhërim të thellë. Në qoftë se lejohet hapja e një shkolle me shqipen si gjuhë mësimi, d.m.th. me gjuhën tonë amtare...atëherë do të përgjithësohesh arsimi popullor... dhe të gjitha shpenzimet do t'i paguajnë patriotët vetë”.²⁶ Promemoria ishte nënshkruar nga Shyqyri Qoku, Hamdi Bej Ohëri dhe patriotët të tjerë dibranë me aktivitet jo vetëm në Dibër, por dhe më gjerë. Kërkesat e dibranëve nuk u miratuan nga qeveria osmane. Refuzimi u shoqërua me rifillimin e kryengritjeve antiosmane kundër administratës lokale dhe për largimin e forcave ushtarake nga qyteti i Dibrës. Sukseset e lëvizjeve kryengritëse e vendosën Dibrën nën kontrollin e forcave kryengritëse që erdhën nga Malësia e Dibrës së Poshtme, nga Mati, nga Luma dhe nga Selishta.²⁷


Sukseset e lëvizjeve kryengritëse sollën jo vetëm vendosjen e kontrollit në qytetin e Dibrës, por dhe hapjen e shkollave shqipe, përgatitjen e botimeve në gjuhën shqipe dhe shpërndarjen e tyre anembanë atdheut. Ashtu si dhe shumë rilindas të tjerë, u shqua për botimet e tij dhe Said Najdeni. Në vitin 1900 ai botoi në Sofje “Abetaren në gjuhën shqipe” dhe “Ferrëfenjësen e Muslimanëve”, botime që treguan dhe njëherë përpjekjet që po bënin atdhetarët dibranë për përhapjen e mësimin në gjuhën shqipe.

24. A.I.H, *Rap.* konsullit Austro-Hungarez, Kral, 11 mars 1899.

25. *Histori e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Tiranë : Toena, 2002, f. 286.

26. Hysni Myzyri, “*Shkollat e para shqipe*”, Tiranë, 1978, f. 180.

27. *Histori e Popullit Shqiptar*, vëll. II, Tiranë : Toena, 2002, f. 286.



Në vitet 1900-1902, Dibra ishte një ndër vatrat kryesore të Lëvizjes kombëtare shqiptare. Sipas konsullit austro-hungarez Kral: “Në Dibër gjendej pika e gravitetit të situatës”²⁸, sepse në Dibër kërkohej me ngulm të hapeshin shkolla shqipe. Në të gjitha shkrimet e shtypit të kohës vlerësohej shumë gjendja e avancuar që kishte mësimi shqip në Dibër.²⁹ Gazeta “Drita” në titullin “Paravajtje në Dibër”, shkruante se: “...Si ndë vise të tjera edhe këtu zuri me hy dashuri e mëmëdheut bashkë me të gjuhës! Sot ndë Dibër të Madhe, ndë të Vogël, ndë Mat, Rekë e Malësi, kemi shumë zotni, pleq të nderçëm që përpiqen për paravajtjen e gjuhës shqip. Sot, i pasur, i varfër, i madh e i vogël thërrasin: me gjuhë ruhet mëmëdheu, me shkolla përmirësohet kombi!”³⁰

Në mjaft qytete të Shqipërisë si në

Tiranë, në Elbasan, në Shkodër, në Dibër, në Mat, në Vlorë etj, qenë ngritur me kontributin e popullsisë fonde të posaçme që përdorehin për të sjellë fshehurazi libra, gazeta e broshura në gjuhën shqipe si dhe për të ndihmuar veprimtarinë e atdhetarëve jashtë vendit.

Jehonë përhapjes së mësimit shqip në Dibër e Malësi në këto vite i bëjnë dhe këngët e çetave të atdhetarëve dibranë që luftonin kundër turqve, por mbronin dhe shkollat shqipe:

“...Asqeri i turkut na ka rrethu,
faj të madh thot kemi ba,
qitap shqip pse kemi kndu,
gjith Ballkani cirilisht,
en shqiptari shqiptarisht!”³¹

Përhapja e shkollave shqipe, e mësimit të gjuhës shqipe, shpërndarja e librave e gazetave shqipe në Dibër e Malësi në prag të konstitucionit osman dhe pas tij, qenë të dukshme. Lëvizja arsimore e kulturore në Dibër kishte arritur një shkallë të lartë, gjë që ndikoi në krijimin e një shtrese shoqërore të arsimuar e të ndërgjegjësuar e cila do të bëhej mbështetja kryesore në realizimin e programit të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.



28. Hysni Myzyri, *vepër e cituar*, f.182.

29. Gazeta “Drita” e Sofjes, nr.2, dt .17/30 e vjeshtës së III, 1901.

30. Gazeta “Drita” e Sofjes, nr.2, dt .17/30 e vjeshtës së III, 1901

31. M.H.D, *Fondi Folklor*, Hilmi Kolgjegjia, “Visaret e Kombit”, D.132, f 57.

Kontributi i klerikëve shqiptarë për shkollën, gjuhën dhe shkrimin shqip

Xhemal Balla

Abstrakt

Klerikët islam shqiptarë, krahas rilindësve të tjerë pa dallim feje e krabine, kanë dhënë një kontribut të fuqishëm në të gjithë rrugën e popullit shqiptar drejt lirisë e pavarësisë. Ata qëndruan pranë popullit në të gjitha vështirësitë që kalonte ai. Kur qe nevoja rrokën edhe armët në luftërat shekullore ndaj pushtuesit sllav dhe padrejtësive të pashallarëve, apo u vunë edhe në krye të shtetit të ri shqiptar, duke drejtuar lidhjen shqiptare të Prizrenit, kuvendin kombëtar të Qeverisë së Vlorës, senatit e shtetit të ri shqiptar dalë nga Qeveria e Lushnjës etj., por njëkohësisht ishin edhe pranë popullit në fushë të edukimit e të arsimit të brezave të rinj.

Klerikët dhanë një kontribut të shquar në lëvrimin e gjuhës shqipe përmes disa fushave:

1. Përmes bibliotekave të ngritura në institucionet arsimore apo në familjet e veta.
2. Përmes mësimin në shkollat e hapura në shumicën e lagjeve të qyteteve e të fshatrave.
3. Përmes botimit të librave në shërbim të shkollave, mes tyre të abetareve dhe gramatikave për mësimin e gjuhës shqipe.

Personalitetet e kulturës sonë islame edhe në këtë fushë të vështirë dhanë ndihmesën e tyre të shquar, nga të cilët theksojmë: Hasan Vogli, Hafiz Ali Ulqinaku, Hafiz Ali Korca, Hafiz Ibrahim Dalliu e deri tek më të rinjtë si: Imam Vehbi Ismaili, Haxhi Vehbi Gavoçi etj.

Në veçanti do të ndalem për mësuesin tim Hafiz Ibrahim Dalliu.

Kontributi i H. Ibrahim Dalliu në historinë e kulturës e të shkencës islame

Ai ka hyrë në historinë e kulturës shqiptarë me të gjitha tiparet e një rilindësi, si një njeri i penës e i pushkës, si një figurë e shumanshme dhe si një personalitet i shquar. Për vite me radhë ai u përfshi drejtpërdrejt në lëvizjen kombëtare të popullit tonë për liri e pavarësi, drejtësi shoqërore e për nevojat e kësaj lëvizjeje ai përdori poezitë e tij si dhe përkthimet e tij në gjuhën shqipe.

H. Dalliu i përket plejadës së nderuar të figurave të shquara të kulturës fetare tek shqiptarët. Krijimtaria e tij letrare e fetare ka hyrë në thesin e kulturës shqiptare në përgjithësi e në atë të kulturës fetare në veçanti.



Ibrahim Dalliu lindi në Tiranë më 1872. Ai vjen nga një familje fetare e hafizësh, duke filluar nga i ati, Mustafa Dalliu, i cili vetë ishte hafiz i Kur'anit, deri tek djemtë e tij: Hysniu (haxhi, hafiz), Aliu (haxhi, hafiz), dhe vetë Ibrahim u bë hafiz. Ky si mbaroi shkollën e mesme në Tiranë, i ati e dërgoi në Stamboll për studime të larta tek vëllai i tij, Hysniu (haxhi hafiz). Këtu ai mori njohuri të thella teologjike, por njëkohësisht u brumos me idetë e rilindësve tanë, u bë i vendosur për të luftuar për përparim shoqëror e demokratik të vendit.

Kur kthehet në Shqipëri personaliteti i H. Dalliu merr vlera të mëdha për faktin se kulturën fetare e vuri në shërbim të njerëzve të tij. Ai kishte dëshirë të madhe për të qenë i dobishëm për njerëzit e atdheun.

Qysh herët u bë i njohur si hoxhë dhe mësues me një përgatitje të gjithanshme. Megjithëse hoxhë, ai u bë mësuesi i parë i shkollës së vajzave

në Tiranë që u hap më 1902, ndërsa veprimtarinë e tij fetare nuk e ndan asnjëherë nga ajo kombëtare, për të mos lejuar që përçarja fetare të kthehej në përçarje politiko-fetare. Ai përçoi me kujdes parimet e Islamit tek njerëzit, me qëllim që t'i ushqej shpirtin besimtarëve mysliman me cilësitë më të larta morale njerëzore, për të sjellë paqe e vëllazëri në mes tyre.

Si teolog i shkallës së lartë ishte njëkohësisht dhe atdhetar i flaktë me shpirt e me mendje, që punoi për bashkimin e shqiptarëve pa dallim feje, për të mbrojtur pavarësinë e vendit ndaj pushtuesit që krijuan ndasinë fetare e deri brenda islamit me sekte që përfaqëson ai. H. Dalliu shkruan: *“Ndashti jame tue pa se ka hy një mace e zezë ndër ne”*. Hafizi ishte tolerant dhe i respektonte fetë e tjera. Për këtë sjell argumente nga Kurani, ku shprehet: *“Hallbuqi në Kuran përmenden me emrin e lavdeshëm “Ehliqitab” të zotët e librit (ungjillit)”*. Pastaj shprehej: *“Na shqiptarët prej çdo feje qofshim, jemi të tanë vllëzën gjaku, vllëzën gjuhe dhe vllëzën vatani”*.

H. Dalliu bëri një jetë aktive shkencore, sociale e në radhë të parë fetare. Atje ku ishin ngjarjet e mëdha të vendit nuk ishte e mundur të mos ishte prezent H. Dalliu.

Ai bashkëpunoi edhe me deputetët e Perandorisë Osmane, Hasan Prishtinën dhe me figura të jetës kulturore si Ismail Ndroqi, Hasan vogli, Myslim Llagami, Musa Muçi, Ibrahim Hasnaj etj. Hafizi u bë i afërt edhe me personalitete të njohura ndërkombëtare në fushën e gjuhës shqipe si Nobert Jokli.

H. Dalliu si njohës i gjuhëve orientale i arabishtes dhe turqishtes

dhe si fetar i devotshëm shquhet si përkthyes i talentuar i literaturës fetare në gjuhën shqipe. Nëpërmjet tyre ai kapërcen didaktikën fetare që kishte traditë të fortë në Shqipëri, hapi udhën e shqiptarizimit duke futur elementë të gjuhës shqipe. Si hoxhë dhe patriot ka marrë pjesë në Kongresin e Manastirit më 1908, në atë të Elbasanit më 1909 deri në Kongresin e Lushnjës më 1920.

Për shkak të veprimtarisë së tij bëhet objekt ndjekjesh, intrigash dhe burgimesh. Armiqtë e çështjes kombëtare e ndoqën hap pas hapi duke e ngarkuar me lloj lloj akuzash, për ta armiqësuar me popullin e për ta demaskuar para tyre. Ata dolën me parullën se H. Dalliu po lufton Zotin e po nxjerr debate me fenë e Muhamedit.

Xhonturqit me idetë e tyre nacionaliste të shekullit përhapën fjalën se shqipja të bën kaur, bën të marri për grua vëllai të motrën, të bën të shembësh teqe e xhamia, të bën të lësh Kur'anin, argjinesën etj. Madje dy tregtarë në këtë kohë shkruajnë letër në prefekturë kundër hafizit duke e akuzuar se Hafizi ishte duke u mësuar vajzave shqip kundër dëshirës së përgjithshme. Ai është thirrur të heqë dorë nga shqipja, por s'ka pranuar. Atëherë myftiu i Tiranës nxjerr një fetva ku thuhet: "Të mos ligjërohet kërkush me shqiptarët se ata i mëson shejtani". Ndërsa H. Dalliu kudo në kontaktet me njerëzit predikonte konceptin e drejtë të fesë islame, që duhet të kishte çdo besimtar por gjithmonë në gjuhën shqipe. Kulmi arriti në shtator 1910 kur u gjend përpara torturave më të egra për artikullin në formën e një letre të hapur në gazetën "Bashkimi i kombit"

ku dënoheshin xhonturqit. Ndërmjet të tjerash ai shkruan: "*Injoranca nuk zhduket me top, topi zhduket njerëzit*".

Për këto mendime ai u arrestua, e kur e morën i thanë: "*Në mos heqsh dorë prej shqipes, ne do të të them*". Ai është përgjigjur: "*A kujtoni se do ta shuani Shqipërinë me therjen time? Jo. Ta dini se prej çdo pike të gjakut tim mbin një shqiptarë si kepurdhë, prandaj të më vrisni një orë e më parë*". Pastaj dy oficer turq i kanë kontrolluar shtëpinë, të udhëhequr nga një shqiptar dhe i kanë gjetur librin e botuar prej tij. Ata e kanë pyetur: "*Çjanë këto libra kaurrce?*". Ai ka thënë: "*Janë ilmilabet, të gjithë shqip*". Ata i thanë: "*Qysh shkruben ilmilabet me shkronja latine bre qafir boxha? A e shibni boxhën kaurr? Është torturue e rrahun në sy të njerëzve, por nuk është dorzuar.*" Një oficer i thotë: "*Në çengel e ke punën, në çengel*". Hafizi i përgjigjet: "*Nuk shubet bota se varet një hafiz, rroftë atdheu*". Kjo i kushtoi daljen para gjyqit dhe u dënua me 10 vjet burg të rëndë në fortesën e Rodit dhe pastaj e kanë çuar në Jedi Kule të Selanikut bashkë me Jusuf Elezin, Mahmud Fortuzin, Beqir Lugën dhe Mustafa Marën. Në burg pas torturash të shumta, ai i është drejtuar Zotit duke iu lutur: "*Asnjëherë s'kam lanë pa fal xhumanë e sot s'do mundem me e falë. Ti e di o Perëni që unë s'kam pas ndonjë qëllim të lig në zemër, veç se kam dasht të mirën e këtij populli, por njerëzit e ligj më bënë në këtë farë halli. Jepi pra ndëshkimin e tyre pa vonesë*". Është liruar me ndërhyrjen e patriotëve shqiptarë dhe kur është kthyer në shtëpi e kanë pyetur. Ai ka thënë: "*S'ka pendë në botë që ta përsbkeruaj, sepse nuk ishte pa e ndigjue kurrë ajo farë barazimi*". Ndërsa djali i vëllait të tij, Adnan Dalliu, tregon

se Hafizit i kanë shkukur dhëmbët nga torturat, e kanë poshtëruar duke e veshur me rrobe grash, si dimitë etj.

Pas kësaj mbeti i papunë, askush nuk e pranonte si imam të falesh pas tij, nuk e thirrnin në dasma as në farefisni, nuk e përshëndetnin me selam etj., etj., e megjithatë ai nuk u tërhoq nga aktiviteti fetar i tij në gjuhën shqipe.

Hafiz Ibrahim Dalliu i përket brezit të dijetarëve islam shqiptarë, që përfaqëson me dinjitet, si periudhën e rilindjes sonë kombëtare, por ashtu edhe të pavarësisë, duke qëndruar në ballë të shumë aktiviteteve, për mëkëmbjen e arsimit dhe për vënien e një rendi të mirëfilltë demokratik në Shqipëri.

Për këtë arsye figura e H. I. Dalliu vlerësohet e nderohet, kurse veprimtaria e tij studiohet. Fushat e dijes ku u përshi kontributi i tij janë të shumta. Dëshmi e autoritetit të H. I. Dalliu si teolog është dashuria për njerëzit, zemërgjerësia, thjeshtësia dhe durimi, cilësi këto që e bënë atë të gatshëm të flijonte veten e tij për të mirë të atdheut. Këto janë parime të rëndësishme të fesë islame dhe me ta ai pasuronte vazhdimisht jetën e tij shpirtërore, duke ushqyer shpirtin e tij dhe të tjerëve me libra fetare në gjuhën shqipe.

H. I. Dalliu si teolog i thelluar në shkencat e teologjisë dhe njohës i mirë i diturisë së fesë islame, konsiderohet se është autor i 15 veprave të vlefshme fetare, disa nga të cilat përkhithime nga arabishtja e turqishtja, ndërsa shumica janë origjinale. Nga veprat më me rëndësi konsiderohen:

1. “Udha Muhamedane” përkthyer nga arabishtja. Është një libër me vlerë të madhe për kulturën dhe shkencën

islame, që ndikoi në përsosjen morale fetare të besimtarëve myslimanë. Për të ruajtur traditën islame në Shqipëri, këtë libër e ribotoi “Instituti Shqiptar i Mendimit e Qytetërimit Islam”.

2. Texhvidi i përkthyer prej H. I. Dalliu më 1921 në Tiranë, ku për kuptimin e texhvidit thotë: “*Me këndue bukur Kurandin, tue i nxjerrë shkronjat e atij nëpër vende të veta dhe tue i dhanë çdo shkronje tingullin e vetishëm e atë që vjen pastaj*”. Ky texhvid është përdorur nëpër mejtepe e xhamia. Këtu Dalliu përdor tema të reja fetare të kësaj shkence me një gjuhë të standardizuar të kohës së tij.

3. “Besimet e myslimanve” është vepër origjinale e tij, e cila trajton një tematikë shumë të rëndësishme, si nga përmbajtja, ashtu edhe nga nevoja që kishin besimtarët myslimanë shqiptarë.

4. “Ilmihali” trajton çështje të besimit islam në vargje, ku autori në fillim falënderon Zotin (xh.sh.) dhe atributet e tij. Me vargje që shpjegojnë domethënien dhe rëndësinë e Ilmihalit, shihet një specifikë e veçantë e ndikimit të rrethanave kulturore fetare të kohës ku jetoi autori.

5. “Mevludi”(e lemja e të madhit profet dhe jeta e tij), botuar në vitin 1924 me 238 faqe. Ai e fillon veprën me shënimin: “*Këtë vepër ia kushtoj Resulullahit, si miza përdhese që i dhuroi të madhit Sulejman një fletë karkaleci dhe ai ia pranoi*”. Kjo është një vepër e rëndësishme për kulturën myslimane shqiptare, për shkak të të dhënave dhe stilit të rrjedhshëm e shumë prekës për shpirtin e lexuesve.

6. “Dhantia Ramazanit” botuar më 1935, zë një vend të rëndësishëm, për shkak të tematikës së trajtuar, e cila ka të

bëjë me një kulturë filozofike fetare dhe si një nga pesë shtyllat e islamit.

7. “Mësimet teorike dhe praktike të moralit islam”, përkthyer e botuar më 1935, ku bëhet fjalë për moralin, ndërgjegjen, ekzistencën e një ligji moral në islam, burim i të drejtave, detyrave familjare-shoqërore, të drejtat reciproke të besimtarëve myslimanë etj. Këtu H. I. Dalliu përdor një terminologji të veçantë që është më e afërt me myslimanët shqiptarë, me shënime që qartësojnë çështje të ndryshme, duke përdorur edhe terma filozofikë të vetë autorit.

8. “Ç’është islamizmi?”, vepër origjinale e ribotuar nga qendra islamike amerikane më 1929, me titull “Besimi Islam” përmban mësimet e ehlisynet velxhemait.

9. “Ajka e kuptimeve të Kurani Qerimit” apo siç quhet tefsiri i Dalliu u botua më 1929, është përkthim i komentuar i Kur’anit në gjuhën shqipe dhe është i pari i këtij lloji në hapësirën shqiptare. Bashkëkohësi i tij Imam Vehbi Ismaili thotë se ky tefsir është origjinal i Dalliu. Në kopertinë shkruhet: “Ky botim u lexua, u shqyrtua dhe u pëlqye prej këshillit të lartë të Sheriatit. Këtë e merr përsipër Komuniteti Mysliman Shqiptarë”.


Kjo vepër si nga përkthimi i Kuranit ashtu edhe nga komenti i tij, paraqet një ndërmarrje të rëndësishme në kulturën e tefsirit dhe dëshmon intelektin e lartë të H. I. Dalliu, i cili zë një vend shumë të privilegjuar në mesin e komentatorëve të Ballkanit e më gjerë. H. I. Dalliu duke përkthyer Kur’anin në gjuhën shqipe thekson se barazia e gjuhëve përpara Zotit është e barabartë, ashtu siç thuhet në suren “Rrum”, ajeti

22: “Ilojshmëria e gjuhëve tuaja” ose në suren “Ibrahim” ku thuhet: “*Ne nuk kemi dërguar asnjë profet që ai për tua shpjeguar, të mos ketë folur në gjubën e popullit të vet*”. Për besimtarët shqiptarë H. Dalliu ia bëri më të afërt e më të kuptueshme fjalën e Zotit në Kur’an.

Botoi dhe vepra të tjera si: “Degët e imanit”, “Libri i së falmes” etj., etj., nëpër të cilat spikati mendimi i tij për çështjen e fjalës njerëzore e sidomos në atë të problemit fetar.

Veprat e tij në masë të madhe paraqesin përpjekjet për kritikë të jetës, për kërkesa e vendime bashkëkohore dhe për metodën e studimit të problemit fetar të cilat shkaktuan mendime të ndryshme në mësimin e teologjisë.

Teologu i shquar Imam Vehbi Ismaili, i shpërngulur në Amerikë shkruan se Dalliu ka shkruar apo përkthyer afro 10000 faqe me



përmbajtje fetare që do të thotë më shumë se çdo shqiptar tjetër mysliman. Ndërsa Ibrahim Hasnaj thotë se H. Dalli u mund të konsiderohet si njëri nga punëtorët shkencorë dhe teologët më të njohur shqiptarë të asaj kohe, jo vetëm për nga shkrimet e shumta, por edhe nga aktiviteti i tij i palodhshëm në botime. Ai vetë përkthente, vetë korrektonte tekstin arabisht si dhe atë shqip, me një drejtshkrim të saktë të asaj kohe. Botuesit e veprave të Hafizit patën meritë të veçantë në radhitjen e materialeve botuese, duke shprehur një dashuri të thellë për autorin, për të nxjerrë në dritë ato thesare të kulturës islame. Vetë Hafizi ka shpenzuar për botimet e i ka shpërndarë falas derë më derë duke ushqyer besimtarët myslimanë me literaturë fetare në gjuhën shqipe. Shumë shkrime kanë mbetur pa botuar ose në rastin më të keq janë zhdukur qëllimisht.

H. Dalli ishte orator i zoti. Fjala e tij karakterizohesh nga pasioni i thellë për tu futur në botën e brendshme të secilit. Si hoxhë për kohën ishte përparimtar aktiv që bashkoi fjalën me veprën, besimtar i denjë që thërriste për bashkim, për veprim, optimizëm në jetë duke u mbështetur tek Zoti. Ai u mbështet fort në binomin Fe-Atdhe, siç e ka cilësuar në botimin e vet Imam Vehbi Ismaili, themelues i qendrës Islamike të shqiptarëve të

Amerikës dhe Kanadasë. H. Dalli u bë simbol i qëndresës për mbrojtjen e lirisë së atdheut, simbol i luftës kundër prapambetjes e paditurisë, si teolog u bë njeriu që u njoh si pikë referimi për të gjithë ata të cilëve u rrihte zemra për çështje islame larg fanatizmit të kohës. Ai nuk u pajtua dhe me idetë komuniste. Në kohën kur ishte mësues teologjije në Medresenë e Tiranës, në vitin 1948 ai burgoset.

U burgos, u persekutua e ç'nuk përjetoj ky kolos i mendimit të lirë që kërkoi dritën - i dhanë errësirën, që kërkoi besë - i dhanë tradhtinë, që kërkoi bukën - i dhanë urinë, që kërkoi nderin - i dhanë poshtërimin.

Në këtë mënyrë H. Dalli mbetet në historinë e kulturës dhe shkencës islame, një luftëtar konsekuent, një mendimtar i guximshëm, një teolog i shquar dhe një demokrat i zjarrtë. Veprimtaria dhe krijimtaria e Dalliut u la në harresë gjatë regjimit komunist. Figura e tij u vlerësua e u ngrit lart kur erdhi në pushtet demokracia, për të cilën ai punoi shumë. Vepra e Dalliut është një shembull frymëzimi jo vetëm për besimtarët myslimanë, por për të gjithë brezin e ri, për formimin e tyre me traditat e shquara të kombit shqiptar. Ai është simbol i qëndresës së pamposhtur, i atdhetarit të zjarrtë, i pastërtisë morale, që kurdoherë me besimin e patundur tek Zoti, mbrojti interesat e vendit të tij.

Liria në sistemin politik të Islamit

MA. Redi Shehu

Abstrakt

Kur përballim dy sisteme qeverisjeje e bëjmë këtë duke marrë mënyrën parimore të të funksionuarit, dhe nuk marrim përsipër të sjellim në optikën e krahasimit deformimet, që kanë ndodhur gjatë historisë së qeverisjeve. Nëse do të dubeshim të futeshim në këtë rrugë pa krye do të na duhej të analizonim të gjitha demokracitë disfunktionale sot në botë. Pra, krahasimi nuk merr përsipër anomalitë, porse fokuson burimin dhe parimin mbi të cilin ndërtohen konceptet qeverisëse të të dyja llojeve.

Të mësuar me një shterpësi terminologjike politike në lidhje me aktin qeverisës brenda Islamit, si pasojë e sterilizimit të dijes sonë lidhur me koncepte qeverisëse të një rendi botëror, i cili për shekuj kishte administruar jo pak, por më shumë se tre kontinente, krahasimi terminologjik në lidhje me pushtetet merrej për bazë preferenciale, si nga perëndimorët, por edhe nga ne, duke u bazuar mbi atë që njohim më tepër, rendin qeverisës aktual, që quhet Demokraci. I gjithë diskursi ynë pastaj ndërtohet duke krahasuar rrjedhimisht gjithçka me Demokracinë, dhe pse sistemi qeverisës i Islamit daton shumë më herët dhe është më komplementar. Si rrjedhojë e kësaj, norma e saktë e krahasueshmërisë, duhet të fokusohet mes demokracisë dhe rendit qeverisës brenda Islamit, si komponente e tij, e cila përfaqësohet me sistemin politik islam.

Vetëm në këtë formë ne i kemi dhënë status të qëndrueshëm në proporcion të drejtë përballjes krahasuese të këtyre dy koncepteve qeverisëse.

Demokracia është një ndër format e qeverisjes bazuar në institucione qeverisëse të zgjedhura nga populli, të cilat u kthehen po popullit, si institucione administrimi e shërbesash. Ajo nënkuptohet nën termin e vetpërcaktueshmërisë politike dhe përfshin praktikimin e lirë dhe të barabartë të kësaj vetpërcaktueshmërie. Termi vjen nga greqishtja δημοκρατία – (*demokratía*) “qeverisje e popullit” dhe ngërthen në vetvete një seri të drejtash që fillojnë nga të drejtat njerëzore, liritë civile, procese gjyqësore të hapura, barazi para ligjit, pluralizëm mendimi dhe organizimi politik. Shumë njerëz këto të drejta ia atribuojnë demokracisë liberale, e cila ndoshta padrejtësisht barazvlerësohet me të vetmin model të

demokracisë. Por sistemi demokratik i qeverisjes ka disa forma të cilat në thelb secila prej tyre garantojnë të njëjtat të drejta të sipër-përmendura. Kështu përveç Demokracisë Liberale, kemi Demokraci Monarkike, Demokraci Sociale, Demokraci Konsensuale, Demokraci të Drejtpërdrejtë, Demokraci Përfaqësuese dhe Demokraci Religjioze. Kjo e fundit, është një formë e njohur e qeverisjes demokratike me ndikim të një religjioni të caktuar mbi ligjet dhe rregullat e qeverisjes, e cila futet në llojin e dytë të demokracive të atyre religjioze dhe jo demokracive shekullare. Demokraci me religjion shtetëror, që ndikon në sistem dhe vendimmarrje kemi Greqinë, Norvegjinë, Argjentinën në rastin e Kristianizmit dhe Izraelin në rastin e Hebraizmit. Në thelb ajo që është e përbashkët ndërmjet këtyre tipologjive të sistemeve demokratike është ndarja e pushteteve të cilat si kolona kryesore kanë: **Sovranin** (që në rastin e demokracive liberale është teorikisht populli, në ato monarkike mbreti e kështu me radhë), **Legjislativin** (ekuivalenti i Parlamentit apo formë asambleje nga e cila burojnë ligjet), **Ekzekutivin** (përbën trupin qeverisës i cili ka autoritetin dhe përgjegjësinë për administrimin ditor të shtetit) dhe **Gjyqësorin** apo thënë ndryshe Sistemin Gjyqësor, i cili përbëhet nga një zinxhir gjykatash, të cilat merren me interpretimin dhe zbatueshmërinë e ligjit nga institucionet dhe individët e shtetit. Ky është në thelb boshti institucional i sistemeve demokratike, të cilat në esencë të vetën kanë pavarësinë e këtyre pushteteve, duke ushtruar presion kontrollo-balanco për të

shmangur abuzivizmin me pushtetin dhe institucionet.

Sistemi politik i Islamit përbëhet nga shtyllat kryesore të pushteteve, ashtu siç edhe demokracia është e modeluar. Në këtë sistem kemi **Sovranin** (i cili në rendin qeverisës islam nënkupton Unitetin në Njëshmërinë e Zotit, e njohur me terminin **Teuhid**¹, si argument ontologjik i sovranitetit dhe supremacisë së Krijuesit mbi krijesat). **Shūrā ose Mexhlis el Shura** (i cili nënkupton këshillimin dhe marrjen e vendimeve për sa i përket komunitetit me bazë maxhorance, duke shtruar bazat e një, le të themi në terminologjinë perëndimore, Demokracie Përfaqësuese²). Pra, një parlamentarizëm apo kuvendim mbi administrimin e jetës shoqërore të komunitetit. Pjesë përbërëse e saj është edhe **Ixhma**-ja, apo thënë ndryshe konsensusi (si kusht nga ku buron jeta legjislative). **Kalifi** (është institucioni i ekzekutivit, i cili përfaqësohet nga Kalifi, si kreu i ekzekutivit. Terminologjia nënkupton në thelb fjalën “pasues”, apo “mëkëmbës” në kontekstin politik si pasuesi i kreut të parë të shtetit islam, që ishte Profeti Muhamed (a.s.) dhe në kontekstin ontologjik, si mëkëmbës të Krijuesit në tokë.³) Dhe si shtyllë tjetër e rëndësishme në sistemin qeverisës islam është institucioni i **Kadiut** (i cili është themeli i sistemit gjyqësor në rendin qeverisës islam. Institucioni i kadiut apo Gjykatave është institucioni i pavarur i cili merret me kontrollin e

1. “Allah”, *Encyclopedia Britannica Online*, Prill 2013.

2. Esposito, John L., në “*Oxford Dictionary of Islam*”, OUP, 2003.

3. “Khalifah”, në “*Oxford Islamic Studies Online*” (vizituar më 22 Prill 2013).

zbatueshmërisë së ligjeve dhe në gjykimin e tij ka për bazë konsensusin apo Ixbma-në.) Pra, ndërtimi institucional i qeverisjes në Islam është i mirëpërcaktuar dhe me funksione të ndara dhe në këtë pikë do të shtronim pyetjen nëse do të ishte më mirë, që kur krabasojmë të dy sistemet të thubej nëse Demokracia është në përputhje me sistemin politik islam. Është i nevojshëm një shpjegim më i thellë i shtyllave qeverisëse të Islamit për të kuptuar më mirë determinizmin që kanë ato në sistem.

El Teuhid – Sovrani, Njëshmëria dhe Uniteti i të cilit përmbledhet në Zotin Krijues bazuar në argumentet teologjike të ekzistencës së tij, i cili ka sovranitetin e tij mbi institucionet në rendin qeverisës islam. Ky autoritet i Tij (në demokracitë liberale sovraniteti nënkuptohet të jetë i popullit mbi institucionet, apo i monarkut në demokracitë monarkike) mbi institucionet ndërtohet mbi postulatit e një Krijuesi në rrafshin vertikal dhe të mëkëmbësve të tij në tokë në rrafshin horizontal të cilët qëndrojnë në një format të barabartë dhe potencialisht të njëjtë në optikën e Sovranit duke garantuar kështu një barazi të pjesëmarrjes, rolit dhe influencës, që kanë të gjitha krijesat e barabarta karshi të vetmit Sovran. Ky element i barazisë institucionale horizontalisht është pika ku demokracia shprehet në barazinë e individëve brenda sistemit politik. John Esposito në kontekst shprehet:

*Tashmë është e argumentuar se doktrina e el-Teuhid kërkon një sistem demokratik aplikimi sepse të gjithë njerëzit janë të krijuar të barabartë dhe çdo sistem që mbron këtë barazi nuk është islam.*⁴

Shūrā ose Mexhliis el Shura – Ka

dakordësi në mesin e mendimtarëve me faktin që një qeveri, apo qeverisje duhet të ketë format e veta të konsultimit dhe këtë formë konsultimi e realizon në sistemin politik të Islamit, Shura. Duke u bazuar në praktikën e drejtuesve të parë të shtetit islam si dhe të kreut të parë të qeverisjes islame e cila udhëhiqej nën autoritetin e Profetit Muhamed (a.s.), Shura, pra organi këshillimor, merrte trajta vendimmarrëse për sa i përket administrimit të jetës së përditshme të komunitetit. Në librin “*Shura në Traditën Profetike dhe Dijetarët Myslimanë*” Dr. Muhamed Ibn Ahmed Es-Salih në lidhje me tiparin e Shuras shprehet:

*Parimi i shumicës dhe e drejta e opozitës, janë dy shtylla kryesore në demokracinë e pretenduar bashkëkohore. Edhe kjo përputhet me atë që përmendem më sipër, se përfundimi dhe rezultati i Shura-s është detyrues për pushtetin dhe se parimi i shumicës njihet dhe pranohet në Islam, e po kështu, në sistemin e Shura-s është e siguruar edhe e drejta e pakicës për të kundërshtuar.*⁵

Në këtë frymë Shura është një ndër institucionet detyruese të sistemit politik islam, e cila tagrin e vet formues e merr direkt nga Sovrani (Zoti) në mesazhin drejtuar mëkëmbësve të Tij në rrafshin horizontal për ta zbatuar atë. Shura, gjithashtu, ka atributin e zgjedhjes së kreut të ekzekutivit (Kalifit) në bazë të parimit të aprovimit të shumicës. Në jetën e shtetit të parë islam nën autoritetin e Profetit kemi ngjarjen e Uhudit dhe Hendekut, ku në bazë të këshillimit u morën vendime për të organizuar mbrojtjen e qytetit, ku u

4. Esposito John L., “Islami dhe Demokracia”, Oxford University Press, 2001, vol. 22, nr. 6.

5. Dr. Muhamed Ibn Ahmed Saleh, “Shura në traditën Profetike dhe dijetarët muslimanë” (përkth. J.Topulli), Tiranë, 2011.

respektua mendimi i shumicës. Gjatë historisë së parë të shtetit islam në vitin 632, kreu i parë i shtetit pas vdekjes së Profetit u zgjodh në bazë të principit të Shura-s, Ebu Bekri në Sakife, edhe pse një minorancë ishte kundër. Po kështu në këtë frymë, vendimmarrjeje u zgjodhën edhe Kalifët pasardhës, Umer ibn Hatab, Uthmani dhe Aliu. Pra, aplikimi i Shura-s, në themel të vetin, ka luftën ndaj despotizmit, autokracisë dhe diktaturave si dhe është kundra pushtetit absolut të individit kundrejt shoqërisë. Për më tepër idealet demokratike të lirisë së fjalës dhe diversitetit të mendimit shfaqen edhe në fjalët e Profetit Muhamed (a.s.), si autoriteti dhe ndërlidhësi mes Sovranit dhe institucioneve në thënien e tij “Ndryshueshmëria e opinioneve brenda komunitetit tim është një shenjë e mëshirës së Zotit.”⁶

Koncept tjetër mbështetës i barazisë së opinioneve në vendimmarrje përbën edhe **Ixbma**-ja e cila në fjalët e Muhamed Ikkalit perceptohet si “shpirti republikan”, i komunitetit për të rënë në konsensus në ndërtimin e normave shoqërore. *Shura* në vetvete ka nevojë për *Ixbma*-në (konsensusin) në vendimmarrjet e veta. Më tej Ikkal për të rikthyer këto institucione të harruara në vendet myslimane shprehet:

Rritja e shpirtit republikan dhe formimi gradual i asambleve legjislative në tokat myslimane, përbën një hap të madh përpara. Transferimi i pushtetit të Ixbtihad-it nga përfaqësues të shkollave tek një asamble legjislative myslimane, e cila nga pikepamja e rritjes së sekteve kundërshtarë, ishte e

6. Takeyh, R, “Can Islam bring democracy to the Middle East?”, *Foreign Policy, Nëntor/Dhjetor*, 2001, fq. 69.

*vetmja formë që mund të merrte Ixbma në kohët moderne, do të siguronte ndihmesë në diskutimet ligjore... Vetëm në këtë mënyrë mund të vëmë në lëvizje shpirtin e fjetur të jetës në sistemin tonë legal.*⁷

Kalifi – Është jo vetëm post si kreu i qeverisjes por edhe institucion politik shumë i rëndësishëm dhe hallkë kyçe në zhvillimin e, le ta quajmë, demokracisë islame (duke përdorur terminologjinë aktuale). Duhet kuptuar se Kalifi dhe Kalifati si institucion politik i kaloi përmasat e një thjesht qeverisjeje lokale, duke u kthyer në rend botëror qeverisës të paktën për 13 shekuj. Gjithashtu është interesant fakti që marrëdhënia e këtij institucioni me Sovranin (Zotin) është tipike në botëkuptimin e Islamit, i cili e konsideron çdo individ kalif (mëkëmbës të Zotit në tokë), pra potencialisht çdo individ gëzon të drejta të barabarta dhe askush nuk është i privuar nga një titull i tillë. Ky koncept i shpallur dhe aplikuar 14 shekuj më parë është një bazament i fortë për një jetë demokratike (kupto popullore) në kohën kur në vende të tjera monarku merrte shpeshtribute hyjnore dhe të pazëvendësueshme. Kalifi zgjidhet në bazë të vendimmarrjes së Shura-s dhe në varësinë e tij janë administrimi i pushtetit ushtarak, financat, dhe strukturat të cilat ndihmojnë qeverisjen. Nën pushtetin e Kalifit ndodhen Guvernatorët e rajoneve të ndryshme.

Kadiu – Mëshiron institucionin e Gjykatës, i cili ushtron kontrollin për sa i përket zbatueshmërisë ose jo të ligjeve të cilat vijnë nga Sovrani dhe nga Shura. Në gjykimin e vet Institucioni i

7. Esposito, John L. & Voll, John O., “*Islam & Democracy in Muslim World*”, 1996, fq. 29.

Kadiut apo Pushteti i Kadinjve është i mbështetur në Ixhma-në (konsensusin) për sa i përket vlefshmërisë së vendimeve të veta. Jo vetëm kaq por duke iu referuar Ataman në veprën e tij “*Regjistrat e Kadinjve osmanë si burim i historisë sociale*”, ai jep një panoramë të qartë mbi kriteret që duhet të plotësojë një Kadi dhe të drejtat dhe detyrat e tij:

*Një Kadi duhet të jetë në moshë të rritur. Duhet të jetë njeri i lirë, mysliman dhe i shëndoshtë mendërisht. Performanca e tij legislative duhet të jetë në përputhje me ligjin pa futur interpretimet e tij personale. Para tij (kadiut) në gjyq duhet të paraqiten prova në mënyrë që ai të bindet dhe vendimet e tij merren në vende publike, ku publiku mund të ketë mundësi pjesëmarrjeje. Një Kadi nuk duhet të marrë dhurata dhe duhet të tregohet i kujdesshëm në angazhimin e vetvetes në tregti.*⁸

Pra pushteti gjyqësor ka të mishëruara në detaje rolin dhe performancën e vet në realizimin e misionit të vështirë të kontrollit të mirëfunksionimit të sistemit. Përveç kësaj edhe pse vendimet e kadinjve në sistemin gjyqësor të rendit qeverisës të Islamit kishin autoritetin e plotë, përsëri ekzistonte ajo që quhej *Gjykata Mazālim* në të cilën dërgoheshin ankimmimet e palëve për pakënaqësitë e gjykimeve të kadinjve⁹. Pra kjo gjykatë luante rolin e një Gjykate Apeli kundrejt gjykatës së Kadinjve.¹⁰ Po ashtu një tjetër aparat

8. Ataman, Bekir Kemal, “Ottoman Kadi Registers as a Source of Social History”, *University of London, University College London, School of Library, Archive and Information Studies*, 1987.

9. Tillier, Mathieu, “Qādīs and the political use of the mazālim jurisdiction under the Abbāsids”, fq. 42.

10. Tyan, Emilie, “Histoire de l’organisation judiciaire en pays d’Islam” (Leiden: Brill,

shtetëror i ngarkuar me krimet e rënda apo drejtësinë kriminale ishte edhe *Shurtah*. Megjithëse një Kadi mund të ushtronte kompetencat e veta në juridiksionin kriminal, në praktikë ajo i hiqej atij dhe i kalohej gjykimit të Shurtah e cila zhvillonte procedurat dhe dënimet e veta për krimet e rënda.¹¹

Debatet rreth këtij sistemi islam

Debati mes shkollarëve dhe filozofëve të ndryshëm në Perëndim lidhur me atë se sa Islami përputhej me demokracinë, përveç asaj që e cituam më lart se ky debat është ndërtuar në një disproporcionalitet të theksuar, duke vënë përballë dy entitete me përmasa të ndryshme, është karakterizuar edhe nga një pothuaj tifozaletë paragjykes. Kryesisht grupet e mendimtarëve të cilët më shumë kanë debatuar dhe shkruar rreth kësaj teme, ndahen në grupin pro mendimit se Islami përbën thelb demokratik të përfaqësuar nga Eickelman dhe J. Piscatori, J. Espozito dhe J. Voll, Kramer, Salame 1, Beinini dhe Stork, dhe pjesa tjetër e mendimit të kundërt përfaqësohet kryesisht nga Fukujama, Huntington, Lipsset etj. Kundërshtarët e të përbashkëtave mes sistemit politik islam dhe demokracisë shprehen se uniformiteti i Islamit nuk e lejon atë të prodhojë demokraci. Fukujama shkruan:

Është e vërtetë se Islami konsiston në një ideologji koherente dhe sistematike, ..., me kodin e vet të moralit dhe doktrinën e vet politike dhe drejtësisë sociale, por Islami ka

1960), fq. 463

11. Tyan, Emile, Po aty, fq. 465.

mbytur demokracinë liberale në botën islame, *duke u bërë një kërcënim i praktikave liberale...*¹²

Ndërsa Lipset, në të njëjtën gjatësi vale, shkruante se Islami ashtu si Marksizmi ka një koncept të panjohur për liritë politike dhe e bën të pamundur ardhjen e demokracisë në vendet Islame.¹³ Por tipikisht më kundërshtari i përputhshmërisë së Islamit me vlerat demokratike paraqitet S. Huntington me teorinë e tij të famshme të “*përplasjes së qytetërimeve*”, ku përbërësi kryesor i komponentit krahasues në opinionin e tij është kultura (besimi). Ai thotë se Islami dhe kulturat e tjera joperëndimore përbëjnë një pengesë serioze për zhvillimin e idealeve demokratike të Perëndimit. Gjithashtu ai thekson se mungesa e shoqërisë civile dhe rryma islamiste janë pengesa kryesore për demokratizim të Islamit.¹⁴ E përbashkëta e qasjeve të sipërpërmendura është fotografimi i situatës së vendeve myslimane nën deformim qeverisës si pasojë e periudhës postkolonialiste dhe ekzistenca në të gjitha vendet e rajonit e despotëve tiranëve, diktatorëve. Por asnjëri prej tyre nuk i është referuar burimit të Islamit, që rrjedh nga praktikat dhe institucionet e shtetit të parë mysliman, si dhe burimit legjislativ nga vjen mesazhi. Për këtë mbështetësit e teorisë se Islami është në thelb burim

12. Fukuyama, F., “The end of history and the last man”, *New York: Avon*, 1992, fq. 45.

13. Lipset, S. M., “The social requisites of democracy revisited”, *American Sociological Review*, 59(1), 1994 fq. 23-45.

14. Huntington, S. P., “The clash of civilizations and the remaking of world order”, *New York, Simon & Schuster*, 1996, fq. 31; Huntington, S. P., “The West unique, not universal”, *Foreign Affairs*, 75(6), 1996, fq. 28-46.

demokracie (John Esposito & Voll) shprehen:

*Mesazhet e Islamit, suneti dhe hadithi, mund të shërbejnë si burim për ndërtimin e demokracisë. Koncepti islam i Shuras, Ixhmasë, dhe Ixhtihadit (në kuptimin e gjyqimit të pavarur) duken të përputhshme me konceptet dhe idealet demokratike.*¹⁵

Gjithashtu ato theksojnë se Islami thërret për barazi racore dhe tolerancë fetare. Koncepti i *Ixhtihadit* për Espositon është bazamenti i shoqërisë civile, e cila në mënyrë të pavarur gjykon mbi fenomenet sociale. Po ashtu *Ixhmasa*-ja për ndërtimin e konsensusit të opinionit publik lidhur me çështjet qeverisëse, është element i fortë i demokracisë në Islam. Por thelbi i kundërshtarëve të lirive politiko-juridike brenda Islamit politik, është koncepti mbi sovranin, që ekziston në Islam. Ato theksojnë idenë se koncepti i sovranitetit të popullit mbi institucionet (në vendet e demokracisë liberale) konflikton me sovranitetin e Zotit mbi to. Por në fakt nuk shprehen nëse konflikton sovraniteti i popullit me sovranitetin e monarkut në demokracitë monarkike! Mos harrojmë se edhe sot e kësaj dite kemi konceptin e monarkisë së drejtë hyjnore në Perëndim në vende që pretendojnë demokraci. Voll¹⁶ në vështrimin e tij thotë se Sovraniteti i Zotit mbi institucionet në fakt mbush atë vakum shpirtëror që kanë demokracitë liberale, të cilat i hapin rrugë mungesës së sensit moral të qeverisjes, e cila të udhëheq drejt abuzimit me pushtetin. Sovraniteti i Zotit mbi institucionet

15. Esposito, J. L., & Voll, J. O., “Islam and democracy”, *Oxford, UK: Oxford University Press* 1996.

16. Esposito, J. L., & Voll, J. O., Po aty...

në fakt është sovranitet i vetë popullit mbi to, por me një *design* hyjnor, ngase sovraniteti i Zotit mbi krijesat ushtrohet për të mirën e krijesave për hir të krijesave. Qenia e çdo individi, si posedues i cilësorisht *“mekëmbës i sovranit në tokë”* (kalif) bën që institucionet e ndërtuara nën sovranin karakterizohen nga një ekuivalencë dhe jo diskriminim. Pra demokracia ndër-institucionale, ekziston, e cila merr formë nën vullnetin e Sovranit. Ajo që dallon sovranitetin e popullit mbi institucionet është se individët e zgjedhur nga sovranin popull në kushte dhe rrethana të mira financiare dhe lobuese mund të forcojnë pozitën e veta në institucione dhe të diktojnë mbi sovranitetin e popullit të cilin mund ta manipulojë në shërbim të pushtetit personal. Kështu populli nga sovran kthehet në vasal të sovranitetit të individit mbi sistemin duke prodhuar deformim. E kundërta ndodh me sovranitetin e Zotit mbi institucionet sovraniteti i të cilit nuk blihet as korruptohet dhe e bën individin në krye të institucionit si pasojë e frikëbesimit të performojë brenda kuadrit institucional duke iu kthyer po popullit si qeverisje e drejtë.

Kur përballim dy sisteme qeverisjeje e bëjmë këtë duke marrë mënyrën parimore të të funksionuarit, dhe nuk marrim përsipër të sjellim në optikën e krahasimit deformimet që kanë ndodhur gjatë historisë së qeverisjeve. Nëse do të duheshim të futeshim në këtë rrugë pa krye do të na duhej të analizonim të gjitha demokracitë disfunktionale sot në botë. Pra, krahasimi nuk merr përsipër anomalitë, porse fokuson burimin dhe parimin mbi

të cilin ndërtohen konceptet qeverisjeje të të dyja llojeve. Pyetjes habitëse të para pak dekadave (*sepse tani besoj se për këdo është e qartë*), se a përputhet sistemi politik i Islamit me demokracinë, do t'i përgjigjeshim duke cituar një thënie të Rashid Ghanoushit liderit të opozitës Tuniziane në emigracionin i cili thotë:

*Nëse me demokraci nënkuptohet modeli liberal i qeverisjes që mbisundon në Perëndim, një sistem nën të cilin njerëzit zgjedhin lirshëm përfaqësuesit dhe liderët e tyre, në të cilin ka alternim pushtetesh dhe ka liri dhe të drejta njerëzore për publikun, atëherë myslimanët nuk do gjejnë asgjë në religjionin e tyre që do ta kundërshtojë demokracinë, dhe nuk është në interesin e tyre ta bëjnë këtë.*¹⁷

Po ashtu në këtë kontekst John Esposito shprehet:

*Është e qartë që islami nuk mund të konsiderohet trashëgueshmërisht i papërshtatshëm me demokracinë. “Islami Politik” është nganjëherë një program për demokracinë religjioze dhe nuk është një agjendë për luftë të shenjtë apo terrorizëm.*¹⁸

Situata e deformuar në vendet arabo-muslimane e cila është produkt së pari i pushtimeve kolonialiste më pas i pasojave të tyre nën shtypjet diktatoriale e despotike, kanë bërë që këto rajone të qëndrojnë larg institucioneve dhe jetës demokratike. Kjo, në thelb nuk do të thotë se popujt e këtyre rajoneve dhe aq më tepër religjioni që ata mbartin nuk përbën thelb demokratik. Ajo çka është vërejtur në këto rajone është përdorja me anë të retorikës diktatoriale të sovranitetit të Zotit në funksion të

17. Ganoushi, Rashid., “London Observer”, Interview 1992.

18. Esposito John L. & Voll John O., “Islam and Democracy”, Oxford University Press, 1966.

sovrانيتet të tyre personal për të rritur kështu autoritetin dhe abuzivizmin e tyre ndaj institucioneve. Si pasojë e një rrjeti informativ ndoshta pak paragjykues, si dhe disa fobive të vendeve perëndimore mbi ringritjen e sistemit politik të Islamit, parë nga këndvështrimi i frikës, që shkaktoi pushteti i kishës në Evropën mesjetare, pa u futur thellë në burimet dhe shembujt më të mirë

të historisë së politikës islame, është tentuar të paraqitet në format debati një realitet i deformuar aktual i sistemeve politike të vendeve myslimane, të cilat kishin të bënin pak ose aspak me atë që politikisht në islam është quajtur “qeverisje e drejtë”. Si pasojë e kësaj, një perceptim po ashtu i deformuar bazuar mbi të njëjtat fobi, u ngrit për sistemin burimor politik të Islamit.

Referenca:

Ataman, Bekir Kemal, “Ottoman Kadi Registers as a Source of Social History”, *University of London, University College London, School of Library, Archive and Information Studies*, 1987.

Encyclopedia Britannica Online, Prill 2013.

Esposito John L. & Voll John O., “Islam and Democracy”, *Oxford University Press*, 1966.

Esposito John L., “Islami dhe Demokracia”, *Oxford University Press*, 2001, vol. 22, nr. 6.

Esposito, J. L., & Voll, J. O., “Islam and democracy”, *Oxford, UK: Oxford University Press* 1996.

Esposito, John L. & Voll, John O., “*Islam & Democracy in Muslim World*”, 1996.

Esposito, John L., në “*Oxford Dictionary of Islam*”, OUP.

Fukuyama, F., “The end of history and the last man”, *New York: Avon*, 1992.

Ganoushi, Rashid., “London Observer”, *Inteviu* 1992.

Huntington, S. P., “The clash of civilizations and the remaking of world order”, *New York, Simon & Schuster*, 1996.

Huntington, S. P., “The West unique, not universal”, *Foreign Affairs*, 75(6), 1996.

Lipset, S. M., “The social requisites of democracy revisited”, *American Sociological Review*, 59(1), 1994.

Muhamed, Ibn Ahmed Saleh, “*Shura në traditën Profetike dhe dijetarët muslimanë*”, Tiranë, 2011.

Takeyh, R., “Can Islam bring democracy to the Middle East?”, *Foreign Policy, Nëntor/Dhjetor*, 2001.

Tillier, Mathieu, “*Qāḍīs and the political use of the mazālim jurisdiction under the Abbāsids*”.

Tyan, Emilie, “*Histoire de l’organisation judiciaire en pays d’Islam*” (Leiden: Brill, 1960).

Komunikimi përmes objekteve të kultit Islam KOMUNIKIMI METAFIZIK DHE AI VERBAL (Pjesa e II-të)

M.A. Ferit Lika, KMSH

Abstrakt

Intelektuali mysliman paralel me njohjen thelbësore të Islamit dhe pikepamjeve botërore për Islamin, së bashku me elementët e ndërthurura qenësore të tij, duhet të dijë se komunikimi dhe fizionomia e Islamit, një pjesë të madhe i dedikohet objekteve të kultit, nga ku është transmetuar e vazhdon të transmetohet mesazhi i tij. Sipas studiuesit të njohur belg Titus Burchkardt, studimi i artit islam (ku futet edhe arkitektura), apo i çfarë do arti tjetër të shenjtë, mund të çojë drejt një kuptimi pak a shumë më të thellë të realiteteve shpirtërore, që qëndrojnë në rrejtje të një bote të tërë njerëzore dhe kozmike.

1. E Premtja, simbolika dhe komunikimi

Rituali fetar përbëhet nga veprime simbolike që pasqyrojnë domethënie fetare. Përderisa besimi përfaqëson aspektin njohës të fesë, rituali përfaqëson zbatimin e kuptimit fetar. Besimi dhe ritualet gërshetohen ngushtë mes vete. Besimi grupit fetar i jep kuptim ritualit dhe i trajtëson performancat e tij. Kryerja e ritualit e forcon dhe e rikonfirmon besimin e grupit. Ritualit ndihmon në gjallërimin bindjeve fetare. Përmes ritualit, grupi në mënyrë kolektive i përkujton kuptimet e përbashkëta dhe e ringjall ndërgjegjen për vetveten. Grupi e ripërtërin entuziazmin dhe ndjenjën e unitetit, ndërsa individët identifikohen me grupin dhe synimet e tij.¹

1. Meredith McGuin, f. 49, 50.

1.1 E Premtja/Xhumaja

Termi “xhami”, që përdoret për çdo vend falje myslimane, rrjedh nga fjala arabe, mesxhid, që ka kuptimin “vend përmbysjeje”, çka tregon tërthorazi se lutja kanonike në islam përfshin veprime apo gjendje të caktuara fizike,² veprime të cilat përfaqësohen nga *namazi* (rituali i faljes), 5 herë në ditë dhe një herë në javë në grup. Namazi i xhumasë është, rituali i përjavshëm i faljes në xhami të premtëve në kohën e drekës dhe pasohet nga një ligjëratë (*hutbe*) që paraqitet nga një foltore (*minber*), nga një predikues (*hatib*).

Në këndvështrimin sociologjik, feja përfaqëson një lidhje të fortë

2. Burchkardt, T.

mes individit dhe grupit më të gjerë shoqëror. Këta faktorë përbëjnë bazën e bashkimit dhe janë shprehje e kuptimeve kolektive. E premtja për myslimanët, e njohur ndryshe *xhuma* (nga arabishtja, që do të thotë *dita e tubimit*) është një ditë lutjesh të përbashkëta. Myslimanët janë të urdhëruar që faljen e drekës ditën e premtje ta falin së bashku në xhami.³ Falja e ditës së xhuma ndryshon nga falja në një ditë të zakonshme. Atë ditë imami mban *butbe* (ligjëratë) nga *minberi*. Ai zgjedh një temë të ligjëratës së tij probleme nga fusha e fesë ose nga fusha të tjera shpirtërore e shoqërore. Dita xhumasë konsiderohet kongresi javor i myslimanëve.⁴

Xhumaja ka kuptime të tilla si mbledhje, grumbullim në një vend dhe formimin e një bashkimi dhe uniteti. Ka mendime që duhet të falet në një pikë, por ka mendime që duhet të falet në disa pika vende xhami.

“Ne (myslimanët), ashtu siç e ndajmë 24 orëshin në ditë-natë në pesë pjesë duke e ndriçuar dhe zbukuruar në çdo pjesë me namaz, edhe javën e kufizojmë me xhumanë duke i dhënë një formë të caktuar, dritë dhe bukuri shpirtërore. Ne e rregullojmë orën javore sipas xhumasë dhe, kur vjen ai çast, drejtohem me të gjithë zemrën dhe shpirtin kah Zoti ynë, sepse dita e xhuma është dita më e çmuar mes ditëve që ka krijuar Zoti.”⁵ Njerëzit pasi falin namaz gjashtë ditë me radhë

3. “O besimtarë, kur të thirreni për (të falur) namazin (e xhumasë) ditën e premtje, nxitoni për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë!...” Kur’ani, El Xhuma’a 62:9 .

4. Fjalor i Teologjisë, GEER, Tiranë 2006; Balla Xh., Intervistë Lika F.

5. Ekipi i studimeve Akadematike, Udhërrëfyesi i një myslimani (adhurimet), PRIZMI 2010, f. 162.

ngjiten në një ditë të caktuar gjer në një pikë të caktuar për të marrë shpërblim, dhe atë ditë, prehri i atyre që ia kanë dhënë zemrën Zotit, mbushet plot e përplot me margaritarë. Prandaj themi se xhumaja është, në përfundim të një udhëtimi javor, shprehje e arritjes në një lartësi të caktuar për të marrë nga Zoti gjëra të caktuara.

Xhumaja nuk është një adhurim personal dhe individual, por kthimi kolektivisht kah Zoti. Nëpërmjet këtij rituali, njerëzit grumbuj grumbuj mblidhen pranë faltoreve, duke i paraqitur falënderimet ndaj Krijuesit si xhemat (bashkësi). Në këtë namaz ekziston një orë e veçantë që lutja e besimtarit i pranohet “*në të është një orë e veçantë; po qe se një rob mysliman përkon me atë orë, duke qenë në namaz, Allahu ia jep patjetër atë që kërkon prej Tij.*”⁶ Pikërisht kjo është ajo çka i komunikon çdo javë besimtarëve kjo ditë e shenjtë.

2. Ezani/Thirrja

Ezani është thirrja që bëhet nga myezini në xhami për të njoftuar besimtarët për hyrjen e kohës së faljes dhe për t’i ftuar ata në kryerjen e ritualit të faljes. *Ezan* (arabisht *adban*) nga aspekti gjuhësor do të thotë: “kumtim, informim”, kurse *ikamet* do të thotë: “ngritje për namaz”. Fjala *muezin* (arabisht, mu’edh-dhin) do të thotë: “njeriu apo personi i cili e thërret ezanin dhe ikametin”. Thirrja e ezanit dhe ikameti për namazet e detyruara (*farz*) buron nga Kur’ani dhe suneti i profetit Muhamed (a.s.).

Meqë të gjitha vendet ku jetojnë

6. Hadith (fjalë të profetit) transmetuar nga: Buhari, Xhuma; Talat 37, 24; Deavat, 61; Muslim Xhuma, 13.

muslimanët dallojnë nga njëra-tjetra nga aspekti kohor, nuk ka asnjë orë apo çast të njëzetekatërorëshit që në rruzullin tokësor të mos thirret ezani nga minaret e botës islame dhe të mos bëhet ikameti nëpër xhamitë madhështore, e kjo do të thotë edhe të mos falet namaz.

Në momentin kur këndohet *ezani* përmes së cilit tregohet ekzistenca e një Zotit të vetëm, Muhamedit si i dërguari i Tij dhe thirja për namaz, besimtari këndon (në heshtje) një lutje, ku madhëron Zotin dhe i dërgon salavate Profetit. Në thelb ky është një lloj komunikimi, që realizohet mes muezinit dhe besimtarit dhe besimtarit me Krijuesin. Muezini thërret, besimtari përgjigjet, fjalët e muezinit bëjnë që besimtari të vendosë lidhjen e tij me Krijuesin.

Ky zë është ura që lidh dy botët tona, botën materiale me atë shpirtërore, me besimin, që është “gurra e cila ia bën të këndshme jetën njeriut dhe i jep atij shpresa për lumturi. Ai që është larg kësaj gurre është fatmjerë dhe sikur t’i zotërojë të gjitha mjetet materiale, që i duhen në këtë jetë; ai është i mjerë se i mungojnë ndjenjat larta morale, të cilat do ta bënin të lumtur. Në këtë jetë ai nuk ndien ndonjë gëzim shpirtëror dhe kur gjatë shtegut të jetës e trondit ndonjë kob, nuk i gjen vetes tjetër ngushëllim ose rrugë shpëtimi...”⁷

Duke u çliruar nga prangat e hapësirës, kohës, materies, fizikalitetit dhe interesit vetjak është rruga e pozicionimit të vetes në nivelin e zemrës dhe të shpirtit, në këtë moment njeriu bëhet një trup i vetëm zemër-shpirt-trup fizik dhe me këtë unitet dhe forcë që buron prej tij, kapërcen kufizimet e materialitetit dhe

7. Kraja, A., A duhet feja, a e pengon bashkimin kombëtar, f.19.

të menduarit e të vepruarit në mënyrë të rëndomtë, pa një qëllim.

3. Komunikimi përmes Hutbes

Mjaft studiues mendojnë se komunikimi verbal ka qenë dhe është mjaft i përshtatshëm për diskutimin e çështjeve publike, në mikromjedise dhe makromjedise shoqërore.⁸ Prindërit në komunikimet me fëmijët në mjediset familjare, mësuesit e pedagogët në komunikimet përkatëse me nxënësit dhe studentët në klasa ose auditore, nëpunësit e të gjitha niveleve në bashkëpunimet e shumëllojshme zyrtare me njëri tjetrin, udhëheqësit politikë, shoqërore e shpirtëror në komunikimet me pasusit ose simpatizantët në mjediset të gjera publike, parashetrojnë dhe diskutojnë çështje të ndryshme, sidomos ato më të rëndësishmet me anë të fjalës së folur dhe të shkruar. Kështu komunikimi verbal ka një profil publik më të spikatur.⁹

Një komunikim i tillë realizohet më së miri nëpër objektet e kultit, veçanërisht atij islam. Pothuajse çdo ditë nëpër xhami në orare të caktuara zhvillohen biseda, diskutime, orë mësimi mbi çështjet e fesë dhe ato sociale e shoqërore të para në prizmin fetar e jo vetëm. Ndërsa një shembull i suksesshëm i komunikimit verbal është edhe dita e premte (*xhuma*) Shumica e mesazheve që përcillen këtë ditë verbalisht nëpërmjet fjalëve me fillim dhe mbarim të përcaktuar qartë.

3.1. Hutbeja e së premtes

Hutbeja (ligjërata e imamit) është një prej kushteve të vlefshmërisë së namazit

8. Stewart R., L., 2006: 158.

9. Dervishi, Z., fq. 281.

të xhumasë. Hutbe do të thotë t'i flasësh ose t'i thuash dikujt disa gjëra, shkurt, është një lloj ligjëratë që mbahet përpara një auditori të caktuar. Përmes saj, një ditë në javë, besimtarët e mbledhur në një mjedis, sqarohen kryesisht për çështjet fetare, por edhe për çështje të tjera që do t'ua lehtësonin jetën dhe do t'ua përmirësonin marrëdhëniet. Në parim hutbeja është menduar për realizimin e këtij qëllimi, (nga shkollat juridike islame - Hanefi, Shafi, Maliki, Hambeli), prandaj mbahet në një gjuhë të kuptueshme për xhematin.¹⁰ Hutbeja është një metode për predikimin e fesë dhe rregullave të saj kanonike, por edhe një mundësi për të vënë në dukje probleme të ndryshme shoqërore e për të dhënë zgjidhjen për to. Ky lloj predikimi është zhvilluar nga Profeti Muhamed (a.s.), si dhe këshillohet edhe në Librin e Shenjtë, Kur'an "Vazhdo të këshillosh, sepse këshilla u bën dobi besimtarëve" (Kur'an, 51/55)

Që katërmbëdhjetë shekuj më parë e deri më sot predikuesit, ligjëruesit vazhdojnë këtë detyrë të këshillimit përmes *vazhëve* (ligjëratë në xhami përpara se të fillojë namazi i xhumasë) dhe hutbeve të premtëve. Predikuesit mund të jenë profesorë të shquar, akademikë, studiues, hoxhallarë, imamë, vaizë, njerëz të thjeshtë, por kushti i vetëm është që të ketë njohuri të thella rreth fesë dhe rreth asaj çka do të flasim. "Ata janë të rinj e të moshuar, që predikojnë para xhematit me stil e metoda të përzgjedhura. Xhemati mbetet i kënaqur kur ka përpara ligjërues të aftë, të cilët me fjalën e tyre dinë të prekin mendjet dhe zemrat e besimtarëve."¹¹ Detyra

e ligjëruesit nuk është e lehtë, pasi ai predikon para një xhemati heterogjen. Ai ka përpara moshë të ndryshme, individë me arsimim e formim kulturor të ndryshëm. Nga fëmijë të moshës së adoleshencës, të rinj, të rritur e me moshë madhore. Xhemati në përbërjen e tij ka të tëra klasat e shtresat shoqërore ku mund të përmendim mësues, inxhinierë, doktorë, sociologë, filozofë, shtetarë, politikanë, punëtorë, tregtarë, biznesmenë etj. I përmendëm këto fakte për të kuptuar mirë se një predikues duhet të jetë mbi tërë mësuesit, edukatorët e pedagogët.¹²

Vaizi, ose hatibi përmes hutbes mundohet që të shpallë kapacitetin e fesë për t'i dhënë kuptim jetës së njeriut. Kuptimi ka të bëjë me interpretimin e situatave dhe ngjarjeve në një kornizë më të gjerë të referimit.

3.2. Metodologjia e predikuesit

Xhamitë mbushen përplot me kërkuesit e të vërtetës dhe të eturit për fjalë të mirë.

Një person që mban hutbe, duhet të jetë i aftë të tërheqë vëmendjen e besimtarëve që ndodhen në atë xhami edhe pse dëgjimi me vëmendje i hutbes është një detyrim i fesë islame, truri i njeriut nuk është në gjendje të jetë shumë i përqendruar për një kohë të gjatë pa shkëputje, për këtë arsye ligjërimi duhet të jetë i shkurtër, i qartë dhe konciz. Ai (predikuesi) duhet të ketë parasysh se po u flet mendjeve dhe zemrave njëkohësisht. Fjala e tij është e mbushur me argumente bindëse dhe të thëna ëmbëlsisht, lehtësisht të pranueshme nga gjithsecili. Predikuesi lexon citate Kur'anore dhe i ndërlihd ngushtë ato

dhe Predikuesi.

12. Po aty.

10. Udhërrëfyesi i një muslimani, fq. 174.

11. Gazetë: Drita Islame, Xhina, R., Predikimi

me aktualen e njerëzve, komenton citatat Kur'anore në mënyrë të lehtë dhe të thjeshtë, pa u përmbytur në përmendje të mendimeve, pastaj sqaron si duhen zbatuar mësimet dhe kuptimet e tyre.¹³ Ai hulumton në çështjet bashkëkohore, zbërthen problemet dhe ofron zgjedhje të mundshme dhe të duhura. Ai drejton njerëzit kah puna, më shumë se çdo gjë njerëzit kanë nevojë për dikë që i drejton ata drejt asaj se çfarë të bëjnë e si ta bëjnë. Profeti Muhamed (a.s.), ai i cili është shembull për gjithçka dhe për çdo gjë, i fitonte zemrat e njerëzve me buzëqeshje. Në fytyrën e predikuesit rrezaton urtësi, butësi, inteligjencë dhe ëmbëlsi. Ai rrezaton shpresë.

Njerëzit sot, në veçanti rinia, kërkon që t'i kuptosh ëndrrat e tyre, të flasësh me gjuhën e tyre, të dëgjosh kërkesat e tyre, t'i pranosh dëshirat e tyre, t'ua hijeshosh të mirën, t'u lehtësosh rrugën dhe tu kujtosh atyre mëshirën e Zotit dhe paralajmëron për gjynahe. Rinisë duhet t'i nxjerrësh të mirën e fshehur në shpirtrat e tyre që të shndërrohet në punë nxitëse dhe zhvilluese për shoqërinë. Njerëzit sot kërkojnë predikuesin i cili e thotë të vërtetën edhe nëse ajo është e ithët. Ata dëshirojnë të flitet për jetesën e tyre, punët e tyre në detaje, të mendohet me ta për zgjidhjen e problemeve dhe të sugjerohen mënyra për reforma. Predikuesi sot përmbledh dhe shkurton fjalimin e tij, përqendrohet vetëm në një temë në fjalim e tij, sajon një parathënie të shkurtër dhe e përfundon fjalimin e tij me shpresë dhe optimizëm. U kujton njerëzve forcën e tyre të fshehtë, si dhe potencialin e tyre të madhe, dhe detyrat e obliguara për ndryshimin e vendeve

13. Po aty.

të tyre dhe shoqërisë së tyre. Mëson njerëzit se e mira e së mirës është që secili prej nesh ta kryej detyrën e tij dhe u tregoj se si ta kryejnë këtë detyrë.

Predikuesi mëson dashurinë për Allahun, natyrën, jetën, vdekjen, për njerëzit. Besimtari i do njerëzi pasi i sheh ata si vëllezërit e tij, pasi ata kanë të gjithë një qëllim të përbashkët, jeta e përhershme dhe begatitë e saj, dhe kur njerëzit kanë të njëjtin qëllim mes tyre nuk ka smirë e inat, por vetëm paqe e harmoni. "Shoqëria që ngrihet me persona të cilët gëzojnë qetësi dhe siguri, kënaqësi dhe shpresë, si dhe dashuri e respekt, është pikërisht shoqëria e cila e çan rrugën e saj drejt suksesit, lumturisë dhe qëndrueshmërisë."¹⁴

4. Metafizika e Namazit

Njeriu është qenie e dyzuar, me dy jetë: një jetë është ajo tokësore, trupore dhe një jetë tjetër ajo morale shpirtërore. Ndryshe, njeriu është zotëruar i një orientimi shpirtëror e moral në emër të shpirtit dhe të një orientimi tjetër jetësor e moral në emër të trupit.¹⁵ Në asnjërin nga këto dy orientime njeriu nuk i merr njoftimet prej natyrës. Njeriu duhet të përdorë me kujdes mendimin e tij të përqendruar qoftë në shkallën më të ulët, që ai të kryejë sistemimin e punëve të jetës dhe të administrojë ato në përputhje me nevojat.

Njerëzimit i janë siguruar dy rrugë për njohjen e Zotit transcendent. E para, Zoti me mëshirën e Tij, ka dërguar Zbulesë Hyjnore te çdo popull mbi tokë, për t'u mësuar atyre se Zoti transcendent ekziston dhe se ata i detyrohen Atij adhurim dhe bindje.

14. Po aty fq. 201.

15. Lartësimi i Shpirtit, FLLADI, Tiranë 2007 .

“Nuk ka asnjë popull, të cilit Ne të mos i kemi dërguar paralajmërues...”, (Kuran, 35:24, 25:51); E dyta, edhe në rast se zbulesa është shtrembëruar e prishur aq sa të mos njihet më, ekziston një rrugë universale, e hapur për të gjithë *sensus communis*. Çdo ushtrim i kësaj aftësie, nëse bëhet më çiltërsi e ndershmëri, çon në njohjen e Zotit transcendent. Pasi siç sqaron Kur’ani, çdo njeri është i pajisur me aftësinë për të njohur Allahun.

4.1. Lutja/Duà

Rruga për të komunikuar me Zotin transcendent është lutja. Njeriu kërkon qetësinë shpirtërore përmes lutjes dhe pendimit. Lutja manifestohet në dy forma. Njëra është përmes lutjes individuale me vullnet të lirë në çdo kohë dhe në çdo moment; tjetra është lutja e urdhëruar e cila realizohet përmes ritualit të faljes. Ndërkaq lutjet jo zyrtare, gjegjësisht lutjet e lira, krahas asaj që janë manifestim i shpirtërores në çdo vend ku njeriu gjendet, ato janë edhe kërkim prej Allahut dhe shprehje e çdo lloj dëshire *ahireti* (bota e përtejme) dhe të kësaj bote. Kjo lutje nuk ka vend, kohë apo kushte të caktuara. Allahu i Cili i është njeriut më afër se damari i qafës¹⁶, në çdo moment dhe në çdo vend dëgjon lutjet me zë ose pa zë, të fshehta ose haptazi. Këto dy lloje ibadetesh në Kur’an janë të theksuara, e para me shprehjen “*salat*” (namaz), kurse e dyta me shprehjen “*dua*” (lutje). Në aspektin gjuhësor ‘dua’ do të thotë dëshirë e madhe për tek Allahu i Lartësuar.¹⁷ Në gjuhën arabe fjala *dua* vjen në kuptimin e

kërkimit të ndihmës herë në kuptimin e adhurimit dhe herë në kuptimin e lutjes.

Duà-ja realizohet nga njeri në çdo kohë dhe çdo vend dhe në çdo gjendje fizike apo pozicion qëndrimi, si ulur, në këmbë, duke ecur, me zë, nën vete në heshtje, etj. Përmes saj njeriu i kërkon Zotit të tij qetësi shpirtërore, i kërkon lehtësim nga problemet e kësaj bote, i kërkon mëshirë për gabimet e tij, i kërkon falje, i kërkon për këtë botë dhe botën tjetër (e përtejme) sepse Zoti i tij i ka premtuar: “Lutmoni mua se do t’ju përgjigjem...”¹⁸

4.2. Namazi, komunikimi dhe simbolika

Fjala namaz (*salat*) do të thotë “lutje”. Por në këtë rast ndryshe nga *dua*-ja bëhet fjalë për “lutjen me formë”, koha dhe parimet e kësaj lutjeje janë të theksuar në Kur’an, kurse praktikimi i saj besimtarëve iu është paraqitur dhe mësuar nga ana e Pejgamberit (a.s.). Ky është një adhurim (*ibadet*) që njeriun e mbron prej sjelljeve ta papërshtatshme dhe prej punëve të këqija. Besimtari nëpërmjet namazit, del përpara Krijuesit të tij duke realizuar obligimin e caktuar.

Falja rituale (namazi) është në pesë fragmente të veçanta kohore, detyrë për çdo mysliman mashkull e femër dhe është elementi përbërës më i rëndësishëm i islamit pas shehadetit, Fjalës së Dëshmisë. “Gjendjet apo qëndrimet gjatë faljes që janë: qëndrimi në këmbë me fytyrë nga kible-ja, gjatë të cilit adhuruesi reciton fjalët e lutjes së shpallur në Kur’an; më pas kërrusja dhe përmbysja. Domethënia e këtyre tre qëndrimeve, që lidhen në një rend lëvizjeje dhe pushimi shoqëruar nga

16. Ne e kemi krijuar njeriun dhe Ne e dimë ç’i përshpërit atij shpirti i vet. Ne jemi më pranë tij se damari i qafës së vet.”, Kur’an, Kaf, 50:16.

17. Shih fjalorin “Lisānul arab”, vëll. 4 f. 360.

18. Kur’ani, El Gafir, 40:60.

shqiptimi i shenjtë, është e qartë: Në qëndrimin në këmbë që e dallon njeriun nga kafshët, besimtari i flet Zotit, ose Zoti flet përmes tij; kërrusja është një akt nderimi nga besimtari për çfarë është e Pashëmbëlltyrtë, sakaq përmbysja është dorëzimi i vetes vullnetit të një Zoti të gjithëpushtetshëm.¹⁹ Gjithashtu përmbysja, në të cilën balli prek tokën, dhe një pozicion uljeje në tokë, i cili është pozicioni normal i prehjes dhe meditimit. Përfshirja e trupit në aktin e adhurimit sjell angazhimin e njeriut në krejtshmërinë e tij, ai duhet të lutet me tërë qenien dhe vetëdijen e tij. *“Përfshirja e trupit në lutje hyp që ai të shenjtërohet, pasqyruar kjo në abdesin përpara lutjes; të vësh në kontakt gjymtyrët me ujën, një imazh i njësisë së kryebërshme, shërben pak a shumë, për analogji dhe sipas qëllimit, si një formë e rivendosjes së gjendjes së dëlirësisë.”*²⁰

Gjesti i kthimit gjatë lutjes drejt një pike të vetme, e parrokshme si e tillë, por e gjendur mbi tokë dhe e njëvlershme, në njësinë e saj, me qendrën e çdo bote, është shprehës i shkrirjes së vullnetit njerëzor në Vullnetin Universal,²¹ “dhe tek Allahu do të kthehen të gjitha çështjet”, (Kur’an, 3/109). Takimi i të gjithë gjesteve të adhurimit mbi një pikë të vetme bëhet i dukshëm në afërsi të Qabesë, ku moria e besimtarëve përkulet në faljen e përbashkët nga të gjitha anët drejt një qendre të vetme, të barabartë pavarësisht racës apo pozitës së kësaj bote.

19. Topbash, O., Kur’an ve Sünnet İkliminde, İslam, İmân, İbadet ERKAM, Stamboll 2000 (Islami, Besimi dhe Adhurimi në Klimën e Kur’anit dhe Sunnetit, ERKAM, Stamboll 2002).

20. Po aty, f. 20, 21.

21. Burchkardt T., Arti i islamit, gjuha dhe kuptimet.

Kryerja e vetëdijshme e namazeve nga besimtarët do të sjellë rregull në jetën e tij të parregullt dhe ekuilibër në zemrën e tij të çoroditur; duke ia ngritur në këmbë ndjenjat e rrënuara, do t’u lëshojë një dritë mendimeve të tyre të turbullta. Për rrjedhojë njeriu do të gjejë mundësinë për të parë drejt. Namazi i falur në mënyrë të vetëdijshme duke dalë pesë herë në ditë para Krijuesit, ka cilësinë për t’ia përfutur të gjitha këto njeriut, i bart edhe i përfaqëson këto kuptime. “Ndërkaq në sigurimin e përsëritshmërisë janë disa kushte që duhen plotësuar. Së pari duhet qetësia e zemrës, pastaj, konceptimi i çështjes dhe, pastaj, lidhje pas Allahut me frikë dhe shpresë dhe, në fund fare, vajtje në audiencë para Allahut i turpëruar dhe i shqetësuar.”²²

Namazi është lidhja e njeriut me Zotin e tij, me të zemra merr fuqi dhe shpirti ndien qetësi dhe vendosmëri.

Sipas të gjitha tezave spiritualiste, shpirti kërkon një mjet për t’u kapur dhe të shkojë deri te “kroi i lumturisë” dhe rruga për të arritur atje është përmes namazit, Një e vërtetë e pamohueshme në këtë tezë tonë, është se miraxhi²³ ka qenë një mjet për t’u lartësuar drejt në mbretërinë e Amshimit dhe miraxhi i besimtarëve (mu’minëve) është namazi. Lumturia e vërtetë arrihet përmes komunikimit metafizik përmes lidhjes së tij me transcendenten, një komunikim vertikal me krijesën dhe Krijuesit, që realizohet përmes rrugëve që Qenia Superiore ka vendosur.

Duke kthyer trupin nga kah Qabeja në namaz, duhet që edhe zemra të

22. Po aty, f. 72.

23. Miraxhi është ngjitja e profetit Muhamed pranë Zotit dhe komunikimi i drejtpërdrejtë me të.

kthehet kah Allahu. Sepse kibleja e zemrës është Allahu! Me anë të tekbrit, duke e shqiptuar atë saktë, duhet të ndihet në zemër madhështia e Allahut. Duke ngritur pëllëmbët gjer në veshë, të hidhen plotësisht punët e kësaj bote, zemrat duhet t'i mbështjellë vetëdija dhe kënaqësia e ndodhjes para Allahut dhe duhet filluar namazi me gjendjen shpirtërore të daljes prej kësaj bote të vdekshme dhe hyrjes në botën e pavdekshme të ahiretit. Në qëndrimin në këmbë (kijam), duke e mbajtur shikimin të vend i sexhdes, duke mos e harruar për asnjë çast qenien para pranisë hyjnore, duke bartur zemrën drejt kulmit të ndjenjës së dobësisë, nevojtarisë dhe nënshtrimit para Zotit. Në këndimin (kiraat), duke i kënduar ajetet e Kur'anit saktë, shtruar dhe duke i dalluar fjalët një e nga një. "Ai që Këndon Kur'an, do të thotë së bisedon me Zotin"²⁴ Fjalët në ruku duhen kënduar me ndjenjë rëndësie e madhështie duke menduar për kuptimin e tyre.

Ndërsa përsëritja e sexhdes duhen kënduar duke menduar për madhësinë a Allahut brenda mendimit dhe ndjenjës së sexhdeja është casti kur robi ndodhet më afër me Zotin, të bëhet sexhde më shumë me shpirt se sa me trup "Bëj sexhde dhe afrohu" (Kur'ani el-Alak: 19) Në qëndrimin ndenjor (ka'de), duhet ndenjor me vetëdijen e audiencës hyjnore dhe me qëndrimin lutës e me qafë përkulur. Në mbarim të namazit jepet selam, i cili duhet bërë sikur po ndahet me engjëjt djathtas e majtas gëzimi dhe kënaqësia e madhe e një bashkimi hyjnor të përjetuar nëpërmjet namazit.²⁵

24. Hadith.

25. Topbash, O., f. 242, 243, 244.

4.3. Namazi me xhemat

(rëndësia, lidhja, komunikimi me Zotin dhe përgjigja në unison ndaj imamit)

Mënyra Islame e faljes përshin mendjen dhe trupin. Myslimanët gjatë faljes nuk janë të ulur në stad ose të gjunjzuar herë pas here. Ata rrinë në këmbë, përkulen, përuken në tokë, ulen në tokë (në këmbën e tyre të majtë) dhe mbajnë kontakt fizik me ata që i kanë afër në anën e djathtë. Lëvizjet e tyre janë të sinkronizuara, duke ndjekur ato të imamit, i cili njofton lëvizjet e tyre janë të sinkronizuara, duke ndjekur ata të imamit, i cili njofton lëvizjet e pozicionit, duke thirrur "Allahu Ekber" (Allahu është më i madh).²⁶

Namazi i falur pesë herë në ditë luan rol të madh në disiplinimin e jetës së besimtarit. Kryerja e vazhdueshme e namazit në kohë të caktuara e mëson besimtarin me disiplinë shpirtërisht dhe trupërisht, materialisht dhe kuptimisht. Veçanërisht lidhja pas imamit në namazet me xhemat u mëson besimtarëve disiplinën. Kur imami thotë "Allahu Ekber", atëherë është ai që flet dhe që i lutet Zotit me zë të lartë. Në të njëjtën kohë ai kryen detyrën e dorëzimit për besimtarët. *Tekbiret* e imamit, si direktiva, e bën tërë xhematin të ulet e të ngrihet. Nga ky këndvështrim, në xhemat ka një disiplinë morale e shpirtërore të lartë e sublime.²⁷

Namazi me xhemat mund të falet edhe në shtëpi me pak persona, por më i vlefshëm është ai që realizohet në xhami në një grup më të madh, këtë e potencion fuqishëm islami, në mënyrë që njerëzit të jenë të bashkuar dhe sa më pranë njëri tjetrit. Falja në xhami në faltore

26. Hofman M. f.50.

27. Udhërrëfyesi i një muslimani, f. 71.

me xhemat është një shenjë dalluese dhe simbol i fesë islame. Feja islame i ka dhënë rëndësi të madhe bashkimit dhe unitetit. Nxitja e faljes së namazit në mënyrë të përbashkët, pesë herë në ditë, konsiderimi i domosdoshmi faljes kolektivisht të namazit të xhumasë një herë në javë dhe të namazeve të bajrameve dy herë në vit, kanë kuptimin edhe të një preteksti që myslimanët të takohen dhe të bisedojnë hallet, si dhe të ndihmojnë njëri tjetrin.

Sa ç'është një adhurim individual dhe shpirtëror, namazi ka edhe aspektin e tij socializues. Veçanërisht domosdoshmëria e faljes së namazeve të detyruara (farze) me xhemat është me rëndësi përse i përket faktit, që tregon dimensionin e përmbajtjes shoqërore të tij. Në Islam, xhamitë kanë kryer një rol dhe shërbim të madh në bashkimin e individëve myslimanë në shoqëri, në formimin tek ta të vetëdijes së kolektivit, sepse xhamitë nuk janë ndërtuar vetëm që individët të kryejnë aty adhurimin e namazit.

Në Islam namazi nuk është vetëm një adhurim ai ka luajtur një rol qendror në shoqërizimin e individëve dhe formimin e qyteteve. Siç dihet qytetet e para në Islam janë ndërtuar përreth faltoreve dhe xhamive. “Njëri prej qëllimeve të sistemit islam-adhurim është që, duke refuzuar grupet e statuseve shoqërore të ndryshme mes njerëzve dhe strukturat klasore, të formohet një model shoqëror, që krijon një barazi të mbështetur në thjeshtësinë dhe modestinë; i varfër-i pasur, zotëri-shërbëtor, dijetar-i paditur, aristokrat-qytetar i mesëm, kryetar i shtetnënshtetas i zakonshëm, vihen në të

njëtin status.”²⁸

Përkundër konflikteve klasore në historinë njerëzimit ngjarjeve të përgjakura, formimit të getove politike, kulturore dhe etnike, që dimë nga historia e Perëndimit, në historinë e Islamit nuk mund të bëhet fjalë për ndonjë konflikt, apo diferencim të këtij lloji, apo në këtë kuptim. Një prej shkaqeve më të rëndësishme të kësaj është fryma e barazisë dhe vëllazërisë, që u kanë përfutur individëve namazet e falura në xhemat. Sepse pavarësisht nga pozita kulturore dhe shoqërore që gëzon, çdo besimtar, në sajë të këtyre namazeve e përfiton idenë dhe kënaqësinë e bashkimit, unitetit dhe mendimit të përbashkët.

Natyra kolektive e fesë është element qendror. Sipas Durkheimit, ritualet dhe simbolet fetare janë përfaqësimet e grupit social. Me pjesëmarrjen e tyre në rituale grupore, njerëzit ringjallin lidhjen e tyre me grupin, mësojnë dhe i rikonfirmojnë kuptimet e tyre të përbashkëta. (Durkheim, 1965:257)

4.4. Komunikimi me Zotin

Nëse një njeri beson në ekzistencën e një Zoti transcendent, ai bindet se mund të jetë një botë e papërshkrueshme dhe jo materiale, ku realiteti nuk mbaron në kufijtë e perceptimit tonë mjaft ndjeshëm të dyshimtë.²⁹ Përmes kryerjes së ritualit të faljes së namazit, realizohet një komunikim i heshtur që refuzon grupet e statutet e ndryshme shoqërore mes njerëzve dhe një komunikim i drejtpërdrejtë me Zotin. Njeriu (besimtari) i ka dalë para Krijuesit të tij dhe po i drejtohet direkt Atij pa

28. Po aty, fq. 73, 74.

29. Hofman M. f. 37.

ndërmjetës, duke i kërkuar mëshirë e falje. Në të njëjtën kohë, adhurimit të namazit që konsiderohet titull i veçantë i afërsisë ndaj Allahut dhe që ka thellësi shumë të ndryshme, mund t'i themi edhe "lidhje e brendshme shpirtërore" me kuptimin përqendrim në mendimin e adhurimit dhe kalim i jetës përballë Zotit.

Komunikimi me Zotin arrihet edhe përmes Librit të Shenjtë. Kur'ani për myslimanët është një libër që përmban fjalën e Allahut. Ai i është zbritur Muhamedit (a.s.), të Dërguarit të Allahut, pjesë-pjesë për 23 vjet. Kur'ani është para së gjithash një libër me këshilla dhe parime fetare dhe etike.³⁰ Kur'ani (Libri i Shenjtë) është pjesë e çdo rituali lutjeje (namazi), apo edhe lutjeve të lira (duà), ai është Fjala e Zotit dhe për të komunikuar me autorin padyshim, që mënyra më e mirë është ta bësh këtë me atë gjuhë që Ai ka folur dhe kjo arrihet përmes këndimit të Kur'anit, që është recitimi i tij në mënyrë ritmike dhe melodike. "Në këtë mënyrë fjala e shpallur kumbon në rendin muzikor, çka padyshim është lidhja më e fortë e mundshme ndërmjet ritit dhe artit."³¹

Përmbajtja e Namazit, Fjala e Dëshmisë, përshëndetja e profetit, është pothuaj si një dritare hyjnore e hapur për zemrat tona për ta parë kah e vërteta. Nga kjo dritare ashikët e

dashurisë hyjnore i afrohen Zotit me besim dhe dituri dhe duke vëzhguar të fshehtën hyjnore, sodisin shfaqjet dhe të vërtetat e larta.³²

Si përfundim mund të themi se namazi është "mjete" apo rruga më efiçente për të komunikuar me Zotin, për t'i folur Atij drejtpërdrejt.

Përfundime

Në përfundim do donim të theksonim se religjioni/feja si formë e vetëdijes shoqërore, me forcimin e vetëdijes së solidaritetit, me kontrollin e shoqërisë, afrimin e përgjegjeve për shumë pyetje dhe mistere, dhe me ndihmën psikologjike që u jep njerëzve ka arritur të mbijetojë dhe të jetë një nga vlerat kryesore të njerëzimit; Ka arritur të bëhet pjesë e kulturës së shumë popujve dhe të ketë ndikim në moralin, mënyrat e sjelljes dhe vetëdijen e popujve; Feja, në kuptimin e ngushtë sjell paqe, jep shpresë, iu jep njerëzve identitet dhe qëllim jetësor; Njerëzit besimtarë, dinë se për çfarë kanë ardhur në këtë botë, pse jetojnë dhe e dinë se çfarë kërkon ajo Qenie e Mbinatyrshme Supreme dhe e Shenjtë; Fetarët kanë një familje më të qëndrueshme, më të përgjegjshme për komunitetin dhe për jetën e tyre, më të lumtur dhe mbi të gjitha, janë realistë.

30. El-Attas, Sejid Muhammed Nakib, Islami dhe shekullarizmi, LOGOS-A, Shkup 2006, f. 603, 604.

31. Po aty fq. 88.

32. Topbash, O., Islami, Besimi dhe Adhurimi në klimën e Kur'anit dhe Sunnetit, ERKAM, Stamboll 2005, f. 235

Daut Boriçi - Personalitet i shquar i historisë, kulturës dhe i arsimit shqiptar

Prof. dr. Njazi KAZAZI
Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”,
Departamenti i Gjuhësisë



1. HYRJE:

Figurat e shquara të kombit që kanë lënë gjurmë në historinë shqiptare do të përkujtohen gjithnjë me respekt e mirënjohje të thellë. Vitet e fundit ato po nxirren edhe më shumë në dritë, po ridimensionohen dhe po u jepet vendi që meritojnë. Kështu ndodhi edhe me Daut Efendi Boriçin, “Mësues i Popullit” (1825-1896), që me rastin e 100-vjetorit të ndërrimit jetë u përkujtua në një veprimtari shkencore dhe me një

botim prej 88 faqesh të Muzeut Historik të Shkodrës.¹

Për hir të së vërtetës, për Daut Boriçin është shkruar jo pak. Ai ishte një nga atdhetarët e shquar të Rilindjes Kombëtare, mësues, inspektor arsimi, kryetar i Degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Shkodrën. Por qe edhe didakt i njohur, dorës së të cilit i përkasin edhe tekstet shkollore: **Gramatika, një fjalorth turqisht-shqip dhe tri abetare shqipe.**

Për Daut Boriçin është shkruar që herët në revisten “Dituria”. Lumo Skëndo jep dy informacione të rëndësishme për krijimtarinë e Daut Boriçit në fushën e teksteve shkollore. Në rastin e parë në rubrikën “Bibliografia shqiptare” në vitin 1927, boton të dhëna për abetaren që i ka dërguar z. Sheuqet Muka, drejtor i shkollës Plotore në

1. Muzeu Historik, Shkodër, 1996, U mbajtën këto kumtesa: 1. Nexhmi Bushati-Epok, mjedisi, familja dhe shkollimi. 2. Astrit Boriçi-Daut Boriçi dhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit. 3. Islam Dizdari- Daut Boriçi “Mësues i Popullit”. 4. Prof. dr. Tomor Osmani-Vëzhgime gjuhësore në veprat e Daut Boriçit. 5. Prof. dr. Shefik Osmani, Dr. Njazi Kazazi-Njëri nga të tre...6. Faik Luli “Mësues i Popullit”-Studime dhe vlerësime për Daut Boriçin.

Shkodër, si dhe pak të dhëna jetësore, kurse në rastin e dytë, në vitin 1928 në rubrikën “Letër nga këndonjësit” jepen përshkrime për tri broshura, dy abetare dhe një gramatikë e vogël shqipe, si dhe fletë e madhe me të dhëna biografike të shkruara nga dora e Daut Efendisë, të dërguara nga korrespondenti i revistës z. Hamdi Bushati.²

Punime për këtë personalitet janë bërë nga shumë figura, në mes të të cilëve përmendim: Xhafer Belegu, Prof. Dr. Jup Kastrati, Prof. Dhimitër Shuteriqi, Prof. Dr. Shefik Osmani, Islam Dizdari, Nexhmi Bushati, Prof. Gazmend Shpuza, Prof. Dr. Kujtim Bevapi, Prof. Kahreman Ulqini, Dr. Mikel Prennushi, Prof. Dr. Tomor Osmani, Prof. as. Dr. Ludovik Shllaku, Prof. Vehbi Bala, Xhevat Repishti, Prof. Dr. Vehbi Hoti, Prof. Bedri Dedja, Prof. Dr. Hysni Myzyri, Prof. Dr. Musa Kraja, Mentor Quku, Lec Zadeja, Anila Dushi dhe një shkrim pa emër autori në revistën DI (Dituria Islame), korrik, 2012 etj., etj.


E gjejmë edhe në botimin: “Encikopedi - 100 personalitete shqiptare të kulturës Islame, shekulli XIX-XX”.³

2. Vështrim për abetaret shqipe

Daut Efendi Boriçi pati veprimtari të dendur në fushën e arsimit dhe të shkollës. E gjejmë si drejtor i shkollës

2. Cituar sipas Faik Lulit, në kumtesën e shënuar: “Bibliografia shqiptare” në revistën “Dituria” nr. 4, vëll. II, Tiranë, 1927, fq. 190 dhe “Letër nga këndonjësit”, në rev. “Dituria”, nr. 5, mars 1928, vëll. III, fq. 193.

3. Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Editor: Genti Kruja, Andrin Rasha e grup autorësh, Tiranë, 2012, fq. 307 (në faqet 37-41 për Daut Ef. Boriçin).



Ruzhdije të Shkodrës më 1865 dhe si inspektor i arsimit fillor në zonën e Shkodrës, në vitet 1870-1879, ku fitoi autoritet dhe u bë popullor në sajë të qëndrimit të tij parimor dhe dha ndihmesë të veçantë për edukimin e nxënësve dhe të masave të popullit me ndjenjat atdhetare, si dhe për mbrojtjen e territorit shqiptar nga rreziku i copëtimit në mes të shteteve fqinjë.

Veprimtaria e gjerë organizative e konkretizuar me përpjekjet për të hapur shkollë në Lezhë, Tiranë, Kavajë, Krujë, Ulqin e Dibër, si dhe përgatitja e botimeve për mësimin e gjuhës shqipe, (kryesisht të Abetareve shqipe për të cilat po flasim) e fajësoi atë para Portës së Lartë e cila ndërmoi një serë masash kundër tij. Me vendimin e gjyqit ai u internua në Amfihsar (Turqi), ku qëndroi nga viti 1880 deri më 1888.

Gjatë punës për hartimin e historisë së “Abetareve shqipe...” në bashkëpunim me Prof. Dr. Shefik Osmanin⁴, ne jemi marrë edhe me

4. Shih botimin: Prof. Dr. Shefik Osmani-Prof. as. Dr. Njazi Kazazi: “Abetaret shqipe

abetaret e tij, por tani po japim në mënyrë të përmbledhur punën që ka bërë Daut Efendi Boriçi në këtë fushë.

“Shqiptari me mënyrën e shkronjave që kam kallzue në alfabetin shqip, mbrenda pak kohe mundet me shkerue gjubën e vet”. Këtë deklaronte, si kredo politike, në librin e tij **“Abetare shqip”** më 1869.

Pas “Ëvetareve..” të Naum Veqilharxhit, pas abetareve të Kristoforidhit dhe atyre të Daut Efendi Boriçit, shpalojsej programi i madh i zhvillimit të arsimit në gjuhën shqipe.

Boriçi në mes të 37 shkronjave, 7 i hartoi vetë, nga ato fonema që i korrespondonin shqipes. Me këtë hap që bëri, ai provoi se shqipja ka veçoritë e veta, se alfabetet e grafitë e tjera nuk i plotësonin kërkesat gjuhësore të saj, se nga ana didaktike duheshin hedhur hapa të tjerë. Ndaj vepra e Boriçit përputhet me atë të Veqilharxhit dhe me atë të Kristoforidhit, duke përbërë atë trinom, që ka për bazë abetaret e para, mbi të cilën është ndërtuar tërë fondi i artë e abetareve shqipe.

Në shtypin tonë janë dhënë mendime për abetaret dhe ribotimet e bëra nga ky autor.⁵

dhe trajektorja e tyre historike-pedagogjike”, Botim i MASH dhe shtëpisë botuese “Idromeno”, Tiranë, 2000, fq. 367.

5. Jup Kastrati, Figura të ndrituna të Rilindjes Kombëtare, Shkodër, 1963, fq. 130-133; “Abetarja shqipe e Daut Boriçit e viteve 1861 ose 1969”, në “Mësuesi”, 18. 04.1964.-Dhimitër Shuteriqi, Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850, Tiranë, 1976, fq. 281.-Vehbi Bala, “Nëntori”, 1978, Nr. 6, fq. 85. -Kujtim Bevapi, “Të dhëna mbi disa abetare shqipe të Rilindjes Kombëtare dhe alfabetet e tyre”, “Revista pedagogjike”, 1978, Nr. 4, fq. 134-140. -Tomor Osmani, Histori e alfabetit të gjuhës shqipe, Tiranë, 1987, fq. 150-151 dhe Udha e shkronjave shqipe-Histori e Alfabetit,

Daut Efendi Boriçi hartoi dhe botoi këto abetare shqipe:

-**“Abetare shqip”** me shkronja arabo-turke, litografuar në Stamboll, më 1861. Ribotim i saj më 1869.

-**“Abetare shqip”**, e ndryshme prej së parës.

-**“Abetare shqip”** e ndryshme prej dy të parave.

Nga transkriptimi i plotë i abetares së parë të viteve 1861 dhe 1869, mund të themi se ajo është një abetare shqip-turqisht, me shkronja arabo-turke dhe me krijime origjinale të autorit, pa asnjë shënim në frontespis, pa vit e vend botimi, siç bëheshin nga një herë këto lloj botimesh në Lindje.

Abetarja e Daut Efendi Boriçit ka këto veçori themelore:

Është hartuar sipas metodës sintetike. Pikënisje janë marrë njësitë e vogla të gjuhës, tinguj-shkronjat. Kështu teksti me paraqitjen e të gjitha shkronjave të alfabetit të cilat vendosen në katër kolona ku shkronja është në pozicione të ndryshme: më vete, në fillim, në mes dhe në fund të fjalës. Alfabeti i kësaj abetareje ka 37 shkronja, nga të cilat 28 janë marrë të alfabetit arab, 2 i ka marrë nga osmanishtja dhe për të plotësuar nevojat e gjuhës sonë 7 shkronja i ka krijuar vetë. Si mësues dhe si didakt, mendojmë se ka bërë një punë të kujdesshme me shkronjat e reja që më tepër përdor shenja të vogla si: shtim ose heqje pikash, shenja didaktike etj. (Shih pasqyrën nr. 1).

Përpjekja e Boriçit për t’ua fëmijëve dhe më gjerë gjuhën shqipe me shkronja arabo-turke, duke qenë medresist i Stambollit dhe punonjës i administratës osmane, mendojmë se

Shkodër, 1999, fq. 254-259.

TABELË KRAHASUESE E ALFABETEVE

Pasqyra nr. 1

OSMANISHT	ARABISHT	TE KRIJUARA NGA DAUT BORIÇI	KORRESPONDON ME ALFABETIN SHQIP
ا	ا		e/a
ب	ب		b
پ	-		p
ت	ت		t
ث	ث		th
ج	ج		xh
چ	-		ç
-	-	خ	c
ح	ح		h
خ	خ		kh
د	د		d
ذ	ذ		dh
ر	ر		r
	-	رّ	rr
ز	ز		z
-	-	ژ	zh
س	س		s
ش	ش		sh
ص	ص		s(f)
ض	ض		d(f)
ط	ط		t(f)
ظ	ظ		dh
ع	ع		ayn
غ	غ		gh
-	-	غ	g

Personalitete

ف	ف		f
ق	ق		k(f)
ك	ك		k(q)
گ	-		g (e lehtë)
-	-	غ	ng
ل	ل		l
-	-	ل	gj
م	م		m
ن	ن		n
-	-	ن	nd
و	و		v
ه	ه		h
ي	ي		j

duhet konsideruar si përpjekje e madhe në kushtet e pushtimit, gjetje e një rruge efektive për të mbajtur gjallë dhe për të shkruar gjuhën shqipe.

Porosia e tij drejtuar nxënësve shqiptarë: **“... xen me shkru shqip...”** që lexojmë në faqen 32 të abetares, është vazhdim i kredos së tij politike, është plan-programi i punës së tij për ta bërë gjuhën shqipe si gjuhë mësimi.

Për të arritur tek fjalët, autori përdor rrugën tradicionale, duke kaluar nga shkronjat në rrokjet. Kështu fillon me rrokje të thjeshta (*po, jo, si, ku* etj.), në fjalë njërrrokëshe (*mish, det, Reç-emër fshati*) dhe vijon me fjalë, por më tepër se tre-katër dhe me bashkëtingëllore të njëpasnjëshme si: (*shejt, mret*).

Shkalla e vështirësisë vjen duke u rritur, por shembujt janë ndërtuar edhe me vlera edukative.

Për përvetësimin e mekanizmit të lexim-shkrimit, autori përdor rrugë që ndiqen edhe sot, leximi i fjalëve me

çifte, me ngjashmëri ose nëpërmjet shëmbëllimit, si: *bjeshkë(ë)-pjeshkë(ë); Pashkë(ë)-bashkë(ë); kumbull-kungull, krue-gzue* etj.

Në abetaren e Daut Efendi Boricit gjejmë kryesisht fjalë të fjalorit aktiv të moshave dhe mjediseve të ndryshme shkodrane.

Po konkretizojmë me fjalorin që përdor Borici në abetaren e tij, sipas fushave: - nga mjedisi i afërt, - nga mjedisi i largët, - nga bota e kafshëve, - nga bota e bimëve, - pjesë të trurit të njeriut, - mjete pune, - ushqime të njeriut etj.

Studiuesit e ndryshëm kanë dhënë mendime për gjuhën e autorit, vlerat e saj.⁶

Botimi i një abetareje shqipe në vitin 1861 (1869) është nga ngjarjet më të shënuara në historinë tonë për disa

6. Jup Kastati në art. e cituar ka theksuar se nga 296 fjalë, vetëm 5 janë turke: hajr, mejtep, okë, qejf, zor.

arsye:

Së pari: Me sa dimë deri tani, kjo është e para abetare shqipe që botohet në zonën e Veriut. Boriçi, me sa duket, nuk i njihje “Ëvetaret...” e Veqilharxhit. Po ashtu mendoj se nuk ishte në korrent të punës që sapo kishte bërë ose po bënte Kristoforidhi. Mungesa e ndonjë teksti pararendës ishte në dëm të punës së tij. Abetaret turke që i njihje mirë, i shërbenin fare pak, për arsye e veçori të tjera që ka gjuha shqipe.

Së dyti: Abetarja, ndonëse e botuar me alfabet arabo-turk, është me përmbajtje krejtësisht shqiptare dhe me krijime origjinale të autorit. Kjo dëshmon për një hop në fushën e arsimit kombëtar, me bazë gjuhën shqipe.

Së treti: Duke e parë në një vështrim më të gjerë, vërejmë se në fjalorin e saj përfshihen edhe emra të besimit katolik (Kel) si dhe emra të festave fetare të këtij besimi (Pashkë). Prania e këtyre emrave në një tekst të shkruar nga një klerik-musliman, por që edhe më vonë do të kishte edhe postin e Kryetarit të Degës së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit për Shkodrën, dëshmon për përpjekjet e bëra për ngritjen e rrjetit arsimor pa dallim feje.

Së katërti: Abetarja e Boriçit përshkohet nga fizionomia e edukatës morale të kohës. Mesazhet që ajo transmeton i përkasin moralit klasik, të cilat jepen në formë këshillash, shpesh

katégorike, si: *Mos rri pa punë, Shko në shkollë, Mos prito, Ndigjo keshillat e mira, Kur t’flasish mendo, Mos rrej* etj.

Së pesti: Në kuadrin e mësimëve për edukimin atdhetar, arsimor e qytetar, që përmban ky tekst mësimor, është edhe porosia e dhënë në mënyrë urdhërore: “...*xen me shkruë shqip*”.⁷ Kjo do të thotë se Daut Efendi Boriçi njeh si gjuhë mësimi gjuhën amtare, shqipen. Kështu në atë kohë, kur Shqipëria ishte e pushtuar, ai vë turqishten si gjuhë të dytë duke shkruar: “...**edhe turçen xen**”.⁸

Së fundi: Botimi i një abetareje në gjuhën shqipe, më 1861 ose më 1869, si tekst i litografuar, me tirazh të konsiderueshëm, kopjet e të cilit i gjetëm pas më shumë se një shekulli në disa familje dhe në fondet e bibliotekave, të bindin se në shkollat e trevës së Shkodrës dhe territoreve që mbulonte D. Boriçi, si drejtues i vijaletit të Shkodrës, është përdorur abetarja e tij.

3. Përfundime:

Në përfundim mund të themi se i takon Daut Efendi Boriçit merita e realizimit të kësaj detyre të madhe të programit kulturor të shqiptarëve në agim të Rilindjes sonë Kombëtare.

7. “Abetare...” fq. 32.

8. Po aty, fq. 32.

“SHPATA ISLAME”

**Pse, a ende dyshoni se feja islame është
përhapur me shpatë?!**

Lexoni dhe do të dini të besoni!

“Nuk ka dhunë në fe” (Kur’an, 2, 256)

Abstrakt

Në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë së botës së atëhershme, arabët përbënin një pakicë shumë të vogël. Një grimë e kësaj pakice vendosi ta çonte “Shpatën” tej kufijve të shkerëtirës arabe, te perandoritë e fuqishme romake dhe perse, te brigjet e Mesdheut, te bregdeti i Malabarit dhe shumë më tej se East Indies Islands. Popujt, njëri pas tjetrit vijuan t’i dorëzoheshin kësaj “Shpate” dhe të pranonin Fenë. Kaq i mprehtë ishte tehu i kësaj “Shpate”. Ajo, thjesht fitonte zemrat; trupat dorëzoheshin vetiu.

Kjo është “Shpata” e së Vërtetës, shkëlqimi i thjeshtë i së cilës zhduk gënjeshtrën, mu ashtu siç fsbin drita errësirën.¹

1. Marrë nga *Islam in Concept*, Riyadh, 1992.

Të parët e paktë që përqafuan fenë “e re” pranë Profetit Muhamed (paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!) qenë bashkëshortja e tij, Hatixhja, shërbyesi i tij, Zeidi dhe kushëriri i tij njëmbëdhjetëvjeçar, Aliu.

Midis atyre që e pranuan më pas këtë besim në Mekë, qenë tregtari i ndershëm, Ebu Bekri, njeriu i hekurt i Arabisë, Omeri i madh, tregtari i druajtur, Osmani, xhaxhai trim i Profetit, Hamzai dhe familja e skllavit pagan, Bilal. Ata, thjesht nuk mund t’i rezistonin “Shpatës” magjike të një Profeti të përvuajtur dhe të vetëm.

Pakica e papërfillshme e besimtarëve të kësaj feje të re shumë shpejt u përzu nga Meka bashkë me “Shpatën” e tyre. Në qytetin ku ata emigruan, në Medine, njerëzit mirëpritën jo vetëm mbajtësit e “Shpatës”, por edhe vetë “Shpatën”. “Shpata” nuk pushoi së punuari edhe atje dhe forca e saj magnetike vijoi “t’i tërhiqte” njerëzit nga vetja, derisa e tërë Arabia përqafoi Besimin. Në krahasim me pjesën tjetër të popullsisë së botës së atëhershme, arabët përbënin një pakicë shumë të vogël. Një grimë e kësaj pakice vendosi ta çonte “Shpatën” tej kufijve të shkerëtirës arabe, te perandoritë e fuqishme romake dhe

perse, te brigjet e Mesdheut, te bregdeti i Malabarit dhe shumë më tej se East Indies Islands. Popujt, njëri pas tjetrit vijuan t'i dorëzoheshin kësaj "Shpate" dhe të pranonin Fenë. Kaq i mprehtë ishte tehu i kësaj "Shpate". Ajo, thjesht fitonte zemrat; trupat dorëzoheshin vetiu.

Kjo është "Shpata" e së Vërtetës, shkëlqimi i thjeshtë i së cilës zhduk gënjeshtrën, mu ashtu siç fshin drita errësirën.

A është çmprehur kjo "Shpatë"? Jo, ajo nuk mund të çmprihet. Ajo vijon edhe sot "të shpojë" zemrat e një numri të pambarim burrash dhe grash, pavarësisht nga përpjekjet këmbëngulëse të atyre personave, të cilët duan që të mbizotërojë errësira, kështu që të mund t'u rrëmbejnë njerëzve ç'kanë të mirë ata.

Lexoni më poshtë përshtypjet e disa personaliteteve, të cilët kohët e fundit, "u mundën" nga e njëjta "Shpatë". Ata janë nga vende të ndryshme, flasin gjuhë të ndryshme dhe kanë të kaluar të ndryshme. Janë dhënë, gjithashtu, adresat e tyre. Ndoshta, ju mund të doni t'i pyesni ata, si ndihesh, kur goditesh nga "Shpata" e së Vërtetës.

1. Leopold Vais (Leopold Weiss, tani, Mohammad Asad) (Burrë shteti i Austrisë; gazetar dhe autor; ish - korrespondent i jashtëm i "Frankfurter Zeitung"; autor i "Islam at Cross-Roads" (Islami në udhëkryq) dhe "Road to Makkah" (Rruga për në Mekë) dhe përkthyes i Kur'anit. Ka përqafuar Islamin më 1926).

"Feja islame më duket si një vepër e përkryer arkitekturore. Të gjitha pjesët e saj janë konceptuar harmonishëm për të plotësuar

dhe mbështetur njëra-tjetrën. Asgjë nuk është e tepërt dhe asgjë nuk mungon. Përfundimi: një ekuilibër absolut dhe një kompozim solid".¹

2. Ahmed Hoult (Ahmed Holt) (Kontraktues civil britanik. Ka udhëtuar në shumë vende në kërkim të së Vërtetës së Zotit. Ka harxhuar shumë kohë për punë kërkimore dhe studime krahasuese për Judaizmin, Krishterimin dhe Islamin. Ka përqafuar Islamin më 1975).

"Shpata e Islamit nuk është shpatë çeliku. Unë e di këtë nga përvoja ime, sepse shpata e Islamit ka goditur thellë në vetë zemrën time. Ajo nuk më solli vdekje, ajo më solli një jetë të re. Ajo më solli vetëdijshmëri, ajo më solli zgjim: Kush jam unë, çfarë jam unë dhe për çfarë jam unë këtu".²

3. Bogdan Kopanski (tani, Bogdan Atallah Kopanski) (Me prejardhje polak, tani, amerikan. Doktor në filozofi, histori dhe shkencë politike. Ka bërë një udhëtim shumë interesant në vende islame e ka përballuar vështirësi të mëdha; është burgosur dy herë nga regjimi komunist polak (më 1968 dhe më 1981-1982). Ka përqafuar Islamin më 1974.

"Kur isha dymbëdhjetë vjeç, flaka tej besimin e palogjikshëm dhe kontradiktor të Kishës. Dy vjet më pas, më 1962, unë u magjepsa nga lufta ngadbënjimtare e muxhabidinëve myslimanë algjerianë kundër kolonializmit francez. Kjo që "shigjeta" e parë e Islamit ... Në shkollën e lartë, në ditët e para të arsimimit tim në universitet, unë isha një shembull tipik i "brezit kryengritës" të të Kuqve ... Rruga ime për tek e Vërteta e Kur'anit ishte e ngadalshme dhe e pashtëruar ... Më 1974, unë

1. Adresa: Dar al-Andalus, 3 Library Ramp, Gibraltar, Morocco.

2. Adresa: 23 Welland Garden, Perivale, Middlesex UB6 8SZ, U.K.

vizitova Turqinë. Atje shkrova disertacionin tim për gradën shkencore “Mjeshtër i Arteve” për Sulltanin dhe politikën e Kalifit Sulejman Kanuni ndaj Mbretërisë Polake. Atje unë u preka thellë nga zëri më i bukur i njerëzimit: EZANI, thirrja për t’u falur. M’u ngritën flokët përjetë. Një forcë e panjobur magjepsëse më drejtoi për te mesxhidi (xhamia) i vjetër në Stamboll. Atje, turq të moshuar, me mjekër e fytyrëqeshur më mësuan gusulin (larjen a pastrimin e përgjithshëm të trupit). Me lot në sy pranova Shehadetin dhe fala namazin tim të parë. I fshiva nga mendja ideologjitë gjepurishte ... Për të parën herë në jetën time, mu shtendos mendja dhe ndjeva kënaqësinë e dasburisë për Allahun në zemrën time. Isba mysliman”³

4. Vengatakalam Adijari (tani, Abdullah Adijar). Indian, shkrimtar dhe gazetar tamil. Ka punuar për shtatëmbëdhjetë vjet si redaktor lajmesh në të përditshmen e Dr. M. Karunanidhit “Murasoli”. Ka punuar me tre ish-kryeministra të Tamil Nadusë. Ka marrë çmimin “Kalaimamani” (Margaritari i Madh i Arteve) nga qeveria e Tamil Nadusë, më 1982. Ka përqafuar Islamin më 1987).

“Në fenë islame unë gjeta përgjigjet e dubura për pyetje ngacmuese, që më vinin në mendje për teorinë e krijimit, statusin e gruas, krijimin e gjithësisë etj. Historiku i jetës së Profetit të Shenjtë më joshi shumë dhe ma lehtësoi punën për krabasimin e tij me udhëheqës të tjerë botërorë dhe filozofitë e tyre”⁴.

5. Herbert Hobom (Herbert Hobohm, tani Aman Hobohm). Diplomati gjerman. Misionar dhe

punonjës i fushës sociale. Intelektual që ka shërbyer në misionin diplomatik gjerman, në vende të ndryshme të botës. Tani punon si atashe kulturor i ambasadës gjermane në Riad. Ka përqafuar Islamin më 1941).

“Kam jetuar në sisteme të ndryshme jetese dhe kam pasur mundësinë të studioja ideologji të ndryshme, por kam ardhur në përfundimin që asnjë sistem e asnjë ideologji nuk ka aq përsosmëri sa Islami. Asnjëri nga ato sisteme nuk ka një kod të plotë të një jete fisnike. Vetëm Islami e ka këtë e kjo është arsyeja që njerëzit e mirë e përqafojnë atë. Islami nuk është teorik; ai është praktik. Ai parakupton përulje të plotë ndaj vullnetit të Zotit.”⁵

6. Ket Stivëns (Cat Stevens, tani Yousuf Islam) (Anglez. Më parë, i krishterë. Këngëtar me famë botërore i muzikës pop. Ka përqafuar Islamin më 1973).

“Është gabim ta gjykosësh fenë islame me syzet e sjelljes së disa myslimanëve të këqij, të cilët na i paraqitin gjithnjë në mjetet e informimit masiv. Kjo është njëllëj si ta gjykosësh një makinë si të keqe, kur drejtuesi i saj është i pirë dhe e përplas atë për muri. Feja islame i udhëheq të gjithë njerëzit në jetën e përditshme – në përmasat e saj shpirtërore, mendore dhe fizike. Por, ne duhet të gjejmë burimet e këtyre mësimëve: Kur’ani dhe Syneti i Profetit. Atëherë, ne mund ta shohim idealin e fesë islame”⁶.

7. Zonja Magëret Makës (Ms. Margaret Marcus, tani Maryam Jamilah) (Amerikane; më parë, izraelite. Eseiiste dhe gazetare. Autore e shumë librave. Ka përqafuar Islamin më 1962).

3. Adresa: 3013 Harrel Drive 203 Grand Praire Tx 75051 USA.

4. Adresa: 1 Ashok Avenue, Rangarajapuran, Kodambakkam, Madras, India.

5. Adresa: Cultural Attache, German Embassy, P.O. Box 8974, Riyadh-11492, Saudi Arabia).

6. Adresa: Chairman, Muslim Aid, 3 Furlong Road, London, No.7 U.K.).

“Autoriteti i moralit dhe i Sheriatit islam buron nga Zoti i Plotfuqisbëm. Ëndja dhe lumturia në fenë islame janë vetëm rrjedhojat natyrore të kënaqësisë emocionale për detyrën, që me ndërgjegje e përmbush dikush për hir të Zotit, për të siguruar shpëtimin. Në fenë islame, gjithmonë detyrat theksohen para të drejtave. Vetëm në fenë islame është përmbushur kërkesa ime për vlera absolute. Vetëm në fenë islame gjeta, më në fund gjithçka që është e vërtetë, e mirë, e bukur dhe që i jep kuptim dhe drejtim jetës dhe vdekjes së njeriut”.⁷

8. Vilfrid Hofman (Wilfried Hofman, tani Murad Hofman). (Gjerman; Doktor në drejtësi, Harvard). Shkencëtar i shkencave shoqërore dhe diplomat. Tani, ambasador gjerman në Algjeri. Ka përqaftuar islamin më 1980).

“Duke u përpjekur për disa kohë për gjithnjë e më shumë saktesë e shkurtësi, jam munduar të hedh në letër, në mënyrë sistimore të gjitha të vërtetat filozofike, të cilat, për mendimin tim, mund të vërtetësohen jashtë çdo dyshimi të arsyesbëm. Gjatë kësaj përpjekjeje, unë u kthjellova se qëndrimi tipik i një agnosticisti nuk është qëndrim i mençur, se njeriu, thjesht nuk mund t'i shpëtojë vendimit për të besuar, se shihet qartë krijueshmëria e asaj që është përreth nesh, se feja islame, pa dyshim e gjen veten në harmoninë më të madhe me tërë realitetin. Kështu, unë e kuptoj jo pa tronditje se, hap pas hapi, pa marrë parasysh veten time dhe pothuajse, vetvetiu, me zemër dhe me mendje, jam bërë mysliman. Por, ka mbetur pa u bërë hapi i fundit: të bëj formalitetet e kthimit në fenë islame. Dhe, ia mbërrita kësaj: sot, unë jam mysliman”.⁸

9. Keiziës Klei (Cassius Clay, tani

Mohamed Ali Clay) (Boksier amerikan. Tri herë kampion i botës, peshë e rëndë. Më parë, i krishterë. Ka përqaftuar fenë islame më 1965).

“Kam pasur shumë çaste të bukura në jetën time. Por, ndjenjat që kam provuar ditën e Haxhit, kur qëndrova në kodrën Arafat, janë krejt të pashoqe. E ndieja veten të fisnikëruar në atë atmosferë të papërsbkrueshme shpirtërore, kur mbi një milion e gjysmë haxhinj i luteshin Zotit t’ua falte mëkatet dhe t’u dhuronte bekimet e Tij më të zgjedhura. Ishte një ndjenjë jetëdhënëse të shikoje njerëz të ngjirave të ndryshme, raca dhe kombësi, mbretër, kryetarë shtetesh dhe burra të thjeshtë nga vende shumë të varfra – të gjithë vetëm me ihram⁹ në trup - duke iu lutur Zotit, pa ndonjë shfaqje krenarie ose ultiësie. Ishte një shfaqje praktike e konceptit të barazisë në fenë islame”. (Speaking to the daily “Al-Madinah” / Intervistë për të përditshmen “Al-Madinah”, Jeddah, 15 July, 1989).¹⁰

Këto ishin përshtypjet e disa njerëzve, të cilët i kishte goditur “Shpata” e së Vërtetës.

Sa për propagandën që shpata e çeliktë, shpata e dhunës na paska qenë një mjet për përhapjen universale të fesë islame, po japim më poshtë thënie të disa jomyslimanëve të shquar, që e hedhin poshtë këtë pretendim të pambështetur.

1. M. K. Gandi: “... Unë u binda më shumë se kurrë se nuk qe shpata, që në ato ditë i hapi truall fesë islame në skemën e jetës. Qe thjeshtësia e paepur e Profetit, mosvlerësimi i vetes në mënyrë absolute, përkuqdesja

9. Ihrami është petk i paqepur në trajtën e dy peshqirëve të mëdhenj në ngjyrë të bardhë. (shënim i përkthyesit)

10. Adresa: 1200 E, 49 St., Chicago, ILL 60615, USA.

7. Adresa: C/O Mr. Mohammad Jusuf Khan, Sant Nagar, Lahore, Pakistan.

8. Adresa: Embassy of the Federal Republic of Germany, BP 664, Alger-gare, Algeria.

skrupuloze për zotimet e veta, përkushtimi i tij i zjarrtë ndaj shokëve dhe ithtarëve, trimëria e tij, guximi i tij, besimi i tij absolut në Zotin dhe në misionin e vet. Këto dhe jo shpata çanin para tyre, këto dhe jo shpata bënin që të kalobej çdo vështirësi”. (Young India, 1924).

2. Eduard Xhibën (Edward Gibbon): “Suksesi më i madh i jetës së Muhamedit u ndikua nga forca e pastër morale, pa goditjen e shpatës”. (History of the Saracen Empire, London, 1870).

3. A. S. Tritën (A. S. Tritton): “Piktura e ushtarit mysliman, që marshon me shpatën në njëren dorë dhe Kur’anin në dorën tjetër, është krejt gënjeshtër”. (Islam, London, 1951, f. 21).

4. Dë Lasí Ou’Liri (De Lacy O’Leary): “Historia e bën të qartë se legjenda e myslimanëve fanatikë, që mbulojnë botën dhe që i kanë detyruar të mundurit të pranojnë fenë islame me majën e shpatës, është një nga mitet më fantastike e më absurde, që e kanë përsëritur ndonjëherë historianët”. (Islam at Crossroads, London, 1923, f. 8)

5. K. S. Romakrishna Rao: “Problemi im që ka të bëjë me shkrimin e kësaj monografie, është më i lehtë sepse tani, në përgjithësi, nuk ushqehemi me atë lloj historie

(të shtrembëruar) dhe nuk na dubet shumë kohë për të nxjerrë në pah keqinterpretimet tona për fenë islame. Për shembull, teoria fe islame dhe shpatë nuk dëgjohet më në asnjë qoshe, që ia vlen të përmendet. Parimi i fesë islame, se “nuk ka detyrim në fe”, është i mirënjohur”. (Mohammed, the Prophet of Islam, Riyadh, 1989, f. 4).

6. Xheims A. Miçnë (James A. Michener): “Asnjë fe tjetër, që e njih historia nuk është përbapur kaq shpejt sa feja islame... Përndimi ka besuar gjerësisht se këtë valomë e pruri shpata. Por, asnjë dijetar i sotëm nuk e pranon këtë ide dhe Kur’ani është i qartë (eksplicit) në mbështetjen e lirisë së ndërgjegjes”. (Islam – The Misunderstood Religion, Readers’ Digest (botim amerikan), May, 1955).

7. Lorëns E. Braun (Loarence E. Broune): “Rastësisht, këto të dbëna, të përcaktuara mirë, e shporrin idenë që nxitet kaq gjerë në shkrimet e krishtera se myslimanët, kudo që shkuan, i detyruan njerëzit ta pranonin fenë islame me majën e shpatës”. (The Prospects of Islam, London, 1944).

Përktheu
Prof. Dr. Hajri Shehu

“Zani i Naltë” – Revistë e orientimit drejt reformave dhe progresit shoqëror

Adem Bala

Dalja në dritë e revistës “Zani i Naltë” ka qenë një ngjarje e shënuar, një shprehje dhe tregues i qytetërimit.

“Zani i Naltë” u lind kur ende vazhdonin paqartësitë, kur lufta dhe progresi nuk zhvillohej në terren të butë, kur u shfaqën një mori rrymash mes të cilave vetëtinin vlera të vërteta e të guximshme për kohën, të cilat nxitnin progresin, duke u mbështetur në vlerat më aktive të mendimit islam dhe të atij shqiptar.

“Zani i Naltë” i shpërndau këto vlera të seleksionuara dhe të përshtatshme për psikologjinë, moralin dhe idealet e shoqërisë shqiptare. Me informacionin e gjerë polemizues revista shpejtoi ritmet drejt përparimit. Kështu “Zani i Naltë” u kthye në një vend takimi, në një derë, në një fushë, në një rrugë që të çonte drejt progresit.

Në fushën e veprimtarisë shoqërore “Zani i Naltë” me shumë kurajë civile hapi tribunën e debatit për koncepte e praktika vërtet të diskutueshme për shumë probleme, që koha i shtronte për zgjidhje. Kësisoj “Zani i Naltë” lexuesit i zgjeroi vizionin demokratik me joshjen drejt zhvillimeve shoqërore.

Me artikujt – manifest, revista dha edhe shpresë, edhe besim, edhe siguri për brezat e ardhshëm, kur pohonte:

“Mos të kujtojë brezi i ri se për përparimin e njerëzisë, për mbarëvajtjen e jetës sociale brenda në kufij të moralit, nuk jemi përkrahësit e zhvillimit të gjithmbarshëm”.

“Neve e dimë më shumë se të tjerët se me përdredhjen e kohës, ndryshohen edhe urdhërat, por këto urdhëra lëndorë duhet të përputhen kurdoherë me nevojat zhvillimtare tue mbrojtun shtyllën e moralit” (nr. 3/1926).

Shkrimet me temë shoqërore shtruan terrenin ku hidheshin themelet e reformave me synimin, që zhvillimet shoqërore të bëheshin pa sforcime, natyrshëm e në rrugë të ndershme. Kështu “Zani i Naltë” u shndërrua në një zëdhënëse të progresit, për të mos e lënë Shqipërinë të binte atje, ku e keqja rrezikonte të shndërrohej në një institucion kombëtar.

Shkrimet e “Zanit të Naltë” synonin çlirimin e shqiptarit nga pesha e rëndë e jetës: nga injoranca, nga varfëria dhe nga zakonet e mbrapshta dhe shkatërrimtare.

Me një pendë gjithë zemërimi H. Ali Korça godet krenarinë false të ushqyer nga traditat kur shkruan: “Një që s’ushqen dot fëminë e vet, marton gocën i jep 400-500 napolona pajë, prej të cilave më të shumta janë lecka që t’u frysh i merr era. Ç’duhen gjithë

ato lecka, pra? Përse aju që qit gocën e vet të shesë shtëpinë? Ç’duhet ky luks i qelbët për këtë komb që s’ngopet dot me bukë? Ç’duhet kjo fantazi për këtë popull të ngratë që s’ka as dituri, as mjeshtri?” (5/28)

Në momente kyçe “Zani i Naltë” ftonte për bashkëpunim personalitete të shquara, që mendimi i tyre përparimtar të imponohej mbi frymën mbytëse të pasionantëve fanatikë. Në nr. 6 të vitit 1932 Mehdi Frashëri shkruante: “Jemi të rrethuem me popuj që duen me na hup, prandaj përparimi i shpejtë për ne shqiptarët asht një nevojë jetese. Ai popull që rrëzohet me kambët e veta, s’ka të drejtë të ankohet”.

Kishte ardhur koha e thirrjes së madhe për reforma, duke ngritur zërin kundër pasioneve të nxehta... “Zani i Naltë” mori në supet e veta këtë mision të rëndësishëm dhe me zë të lartë propagandoi idetë e nismëtarëve të Kongresit Mysliman Shqiptar: “Një ndryshim të tillë – shkruanin ata – neve shqiptarët duhet ta ndiejmë me shumë për nevojë ... se nuk mund të qëndrojmë indiferentë para ndryshimeve sociale, se ashtë frikë që harmonia qytetare na hedh jashtë rrethit të saj dhe kështu fati ynë do të qëndrojë në errësi dhe demoralizim”.

H. Ali Korça është ndër më të shquarit e thirrjes për ndryshime. Në shkrimet e tija kërkonte “të mirësohet bujqësia ... të shtohet mbjellja e orizit, pambukut, linit. Të mirësojmë farnat e drithnave, – shkruante ai – të bashkojmë kapitalin dhe të bajmë fabrika shoqënisht ... disa zot tokash të bashkohen e të bajnë machina – përfundonte ai. E këto H. Ali Korça i shkruante më 1926. Këtu e gjen rrugën e shpëtimit social demokraci i madh kur përfundon: “...

kësi soj pak nga pak populli shqiptar fillon me u shkundë prej varfënisë. Në qoftë se do çohemi prej këtij gjumi kaq të rëndë, do të mundemi të jetojmë edhe pak”.

Kështu zëri për reforma nuk mbeti një “zë në shkretëtirë”. Do të dalë S. Vuçiterni e do të lëshojë kushtrimin “... për me mujtë me rrojtë e me sigurie ekzistencën tonë, ma tepër se kush do kemi nevojë të bajmë reforma, me ndihmën e të cilave të mundemi me përmirësue gjendjen tonë shoqërore”.

Qenë zërat e patriotëve, që bënë çmos për të drejtuar shoqërinë shqiptare drejt progresit... Prandaj e hodhën vështrimin drejt Evropës: “Ne jemi një vend europian, – shkruhej në Zanin e Naltë – dhe si i tillë duhet të marrim nga qytetnimi perëndimor ç’ka asht ma e mirë, por jo ç’ka asht e keq”.

Një vend të veçantë në “Zanin e Naltë” i është kushtuar raporteve të shtetit me shoqërinë, duke e shikuar shtetin si një arritje të rëndësishme për kombin. Prandaj reformat shtetërore për ndryshimet politiko-juridike-sociale, “Zani i Naltë” i mbështeti si përpjekje pozitive të shtetit të ri shqiptar. Kësisoj “Zani i Naltë” rrezatonte përgjegjshmëri të plotë ndaj problemeve sociale që kalonte kombi. Këto shanse drejt progresit, “Zani i Naltë” i kishte të frymëzuara nga i shquari Vehbi Dibra, që hapi dyert e mendimit përparimtar kundër formulave të fanatizmit, kur me fjalën e hapjes së Kongresit, tha: “... dera e pikëpamjeve nuk asht e mbyllun dhe jemi gati për me i mejtue disa çashtje fetare, se me ndërrimin e kohës ndërrojnë edhe gjykimet, tue bamë reforma, pa i prekë themelet fetare”.

Në këtë kuadër u projektuan në

Shqipërinë tonë një varg zhvillimesh të rëndësishme, ku shquhen prirjet progresiste të “lëvizjes feministe” që u shfaq si një shqetësim i shoqërisë së kohës për një rol dhe vlerësim më njerëzor të femrës shqiptare. Në nr. 3, më 1926 “Zani i Naltë” do t’i thurte himn figurës dhe personalitetit të gruas: “Gruaja asht krijuem me një fuqi madhështore të cilën mund ta përdorim edhe në një mënyrë të dobishme për të gjithë, kaq sa vlefata e një kombi bazohet me atë të grave”, – shkruhej atje.

“Zani i Naltë” trajtoi me forcë të drejtën e pamohueshme të femrës shqiptare për arsimin: “... të hapim shkolla varfnore mashkullore e femnore, – shkruan S. Vuçiterni – që të mësohen e të edukohen e mbasi të kenë krem shkollën të jenë të zot secili prej tyre m’u marrë me lloj mjeshtrije qi asht si gjymtyrë të dobishme të bahen të dejun m’u përzi me shoqërinë njerzore.”

E vazhdon: “Asht detyrë e domosdoshme të mejtohem i jo pak, por shumë, edhe për mirërritjen e varzave tona, në prehen të cilave nesër do të rritet e do të marrë mësimet ma para, shpresa sa e njomë, aq e gjallë e ardhshmerisë”.

“Zani i Naltë” ka ngritur zërin që, gruas shqiptare t’i sigurohet e drejta e punës si realitet i rolit parësor të saj në shoqëri, si nënë dhe grua. “Asht për t’u përmend, – shkruan “Zani i Naltë” – se nuk ka ndalim për gratë e reja me mësue dituni e mjeshtri... si dhe me shkue me ushtrive mjeshtrinë ndër vendet e punimeve”.

Pa dyshim, një ndër problemet më të rëndësishme, që është trajtuar në “Zanin e Naltë” ka qenë pasqyrimi i atyre përpjekjeve kolosale, që kanë

bërë forcat përparimtar në luftën për emancipimin e femrës myslimane shqiptare. Kurse F. Vokopola, në nr. 3, 1937 shkruante: “Le të shpresojmë se me marrjen pjesë të gruas në lamën e aktivitetit njerëzues, atdheu i jonë do të përparojë me hapa gjigande drejt sferave të lumnisë landore e shpirtnore”. Në nr. 6 të revistës, F. Vokopola në “Zanin e Naltë” do të shkruante me frymë aq liberale sa do t’ia kishte lakmi edhe çdo revistë laike e kohës: “... të rinjtë e të rejat që janë candidate për martesë, të kenë kujdes me zgjedhë të dashunin e tyne e të mos të gabohen nga influenza e parë e pasionit”. “Zani i Naltë” po merrte përsipër edhe thirrje të tilla.

Në shumë artikuj të revistës është ngritur si problem për zgjidhje parimi Islam i barazisë së plotë të gruas me burrin, atë që sot e quajmë “e drejta politike” e personit, deri në të drejtën e gruas për të marrë pjesë në drejtim. “Nuk ka dallim për një grua, m’u bamë njeri i shteti – shkruante “Zani i Naltë” – dhe tue u interesue në punë politike, me dhanë mendimin e vet për modifikimet që duhen me u bamë në formulim të ligjeve”.

“Zani i Naltë” me një luftë pa kompromis e kërkoi progresin...

Ata që në “Zanin e Naltë” hodhën firmën e përparimit, kurrë nuk do të harrohen. Më të shquarit shkëlqyen si frymëzues, si pararendës dhe si bartës ndryshimesh të mëdha. Ata e kryen në mënyrë të shkëlqyer detyrën e tyre, duke e pasuruar biografinë, traditën dhe historinë e shtypit shqiptar, duke bërë që bashkëkohësit, ne sot, por edhe brezat e ardhshëm t’i nderojnë me respekt për atë që bënë dhe për atë që lanë.¹

1. Artikull i botuar në gazetën “Drita Islame”, nr. 23 (154), dhjetor 1998, fq. 2 dhe 4.

“Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar”

Prof. As. Dr. Gentiana Skura - Universiteti i Tiranës



Botimi që sot kemi nderin të promovojmë “Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar” është një pasqyrim i plotë për ndihmesën e dijetarëve e klerit mysliman për kombin shqiptar e shqiptarinë. Ky botim mbështetet në kumtesat e konferencës shkencore me të njëjtin titull të një viti më parë.

Në kuadër të 100 vjetorit të Shqipërisë përpos shumë aktiviteteve të organizuara nga subjekte politike dhe jo vetëm, brenda dhe jashtë vendit, një kontribut të veçantë dhanë dhe komunitetet fetare me organizimin e evenimenteve dhe konferencave, kontribut ky, i cili nxori në pah përpjekjet

madhore të myslimanëve, katolikëve dhe ortodoksëve në shtetformimin shqiptar e po ashtu në vazhdimësi për zhvillimin shoqëror.

Është pikërisht kontributi i klerikëve fetarë, që neve nuk njohim përgjatë historisë tonë, konflikte të bazuara në besimet fetare. Pa asnjë dallim, klerikët myslimanë, ortodoksë dhe katolikë janë përpjekur në të gjitha mënyrat vetëm për një shoqëri me parime patriotike, për një shoqëri bashkëkohore, për forcimin e ndërgjegjes kombëtare, dashurisë për gjuhën dhe traditat shqiptare, dashurisë për atdheun e dashurisë për njëri-tjetrin, janë përpjekur për krenarinë tonë kombëtare.

Më në veçanti kjo vepër bën ekzaminimin e përpjekjeve madhore të klerit dhe dijetarëve myslimanë që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, krijimi i shtetit shqiptar me firmëtarin Hafiz Ismet Dibrën, Luftërat ballkanike, periudhës së mbretit Zog, si dhe qëndrimi ndaj bolshevizmit. Janë theksuar në detaje shumë interesante historike përpjekjet dhe kontributi i dijetarëve në formimin e shtetit shqiptar, ngritjen e vetëdijes kombëtare, albanologjisë, kontributit të zhvillimit të shoqërisë shqiptare brenda

dhe jashtë kufijve, si dhe ruajtjes së gurit tonë të çmuar - bashkekzistencës dhe harmonisë ndërjetare.

I bazuar në kumtesat e 28 studiuesve nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi të mbajtura në konferencën e shtatorit të vitit të kaluar, vepra në fjalë sjell panoramë të plotë të këtij kontributi jo vetëm në aspektin historik, por edhe në ndihmesën për zhvillimin e shkencës shqiptare, filozofisë, arsimin, për të mos lënë më pas patriotizmin dhe kontributin në politikë. E ndarë në 7 seksione/kapituj kjo vepër paraqet rolin e dijetarëve fetarë në Lëvizjen Kombëtare, mbrojtjes së trojeve shqiptare, rolit të tyre në çështjet kombëtare, rolit dhe kontributit në gjuhën shqipe, kontributit për bashkekzistencën dhe harmoninë fetare, si një vlerë unike, vlerë për të cilën neve krenohemi në çdo rast përpara perëndimorëve dhe jo vetëm. Është pikërisht kontributi i klerikëve, që edhe sot e kësaj dite ne shqiptarët ushqejmë respekt për “tjetrin” çfarëdo qoftë, sepse në çdo rast klerikët myslimanë do të theksonin se “Kristiani e myslimani janë vëllezër të pandarë”¹, sepse për dijetarët myslimanë, binomi Fe-Atdhe ishte i pandashëm.

Vepra “Kontributi i prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes kombëtare” ka një vlerë ende më të rëndësishme, pasi mund të konsiderohet si një shenjë mirënjohjeje për të gjithë dijetarët dhe klerikët myslimanë, për punën e palodhshme për Shqipërinë e tyre dhe tonën bashkë. Është një përpjekje për vënien në vend të këtyre figurave tashmë historike, të harruara, të nëpërkëmbura nga sistemi monist.

1. Haxhi Vehbi Dibra, Kuvendi i Vlorës, 28 nëntor 1912.

Po ashtu kjo vepër është një ndihmesë e madhe për studiuesit dhe studentët. Vlen të përmendet së fundmi interesi ndaj studimeve me tematikë fetare, apo dhe studimet për dialogun ndërjetar.

Përveç botimeve të mëparshme të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, por edhe komuniteteve të tjera në vend, kjo vepër është fundamenti për sa i përket kontributit të dijetarëve dhe klerit mysliman përgjatë shekullit XX; themel për vazhdimësinë e mëtejshme në të ardhmen.

Edhe njëherë shpreh konsideratat e mia, dhe shpresoj që botime të tilla të kenë vazhdimësi.

Ne shqiptarët krenohemi për mirëkuptimin dhe harmoninë ndërjetare dhe ndjehemi mirë në çdo vend qofshim.

Do ishte me shumë interes që botime të tilla të shoqëroheshin edhe në gjuhën angleze. Kjo, për faktin se duam të jemi shembull para botës jo vetëm me kumtesa nëpër organizime e takime shkencore apo politike, por t'i tregojmë asaj se vlera e çmuar e harmonisë ndërjetare shqiptare e ka themelin pikërisht te puna dinjitoze, mundi dhe përpjekjet historike të klerikëve të shquar, t'i tregojmë botës, që e sotmja e ka zanafillën shekuj më parë, e duhet të jemi mirënjohës, por edhe krenarë sepse atëherë kur popuj të tjerë konfliktoheshin e ndiznin luftërat në baza fetare, përkundrazi ishte roli ekzistencial i dijetarëve dhe klerikëve fetarë shqiptarë, kontributi i tyre që flisnin dhe nxisnin përpos besimit fetar dashurinë për atdheun dhe harmoninë mes shqiptarëve.

Dy fjalë për një botimi të veçantë shkencor

Dr. Tonin Çobani

Këshilli Kombëtar i Radio Televizionit, Tiranë



Botimi i materialeve të Konferencës Shkencore mbi “Kontributin e prijësve myslimanë në formësimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar” (Tiranë, 28-29 shtator 2012) shënon një ngjarje të rëndësishme kulturore, sepse synon në mënyrë të qëllimtë të vërë në një emërues të përbashkët veprimtaritë e një kombi, tek i cili religjionet nuk janë të një-njëshëm me shtetin që kremton 100-vjetorin. Me emërues të përbashkët unë kuptoj *identitetin kombëtar shqiptar* të tre religjioneve kryesore: myslimanë, katolikë dhe ortodoksë. Dhe *identiteti kombëtar shqiptar* për mua është gjuha shqipe, historia dhe kultura e shprehur në atë gjuhë, si dhe çdo gjë tjetër që ka të bëjë me emancipimin e shoqërisë shqiptare në vizionin e saj drejt së

ardhshmes. Për këto arsye, njohja dhe studimi i vazhdueshëm i kontributeve intelektuale, që i kanë shërbyer *pikërisht formësimin të vetëdijes dhe identitetit kombëtar*, në vetvete janë kulturë e madhe për shqiptarët në trojet e veta: në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Mal të Zi, prej kah janë tubuar kumtuesit në këtë Konferencë Shkencore.

Në historinë e institucioneve tona religjioze, mund të flitet edhe për veprime autoqefalie të plota a të pjesshme, por autoqefalia nuk u kthye ndonjë herë në një emërues të përbashkët. Veçse po, e përsëris, në emërues të përbashkët ka qenë gjithmonë *identiteti kombëtar shqiptar*. Dhe kjo nuk është pak. Në Lezhë në vitet 1896-1897 jetonin thujse fare pranë e pranë Hafiz Ali Ulqinaku (ose Gjoka) dhe At Gjergj Fishta, atëherë në moshë të re. Në një anekdotë historike thuhet se, kur e pyetën Fishtën përse Hafizi i Lezhës e quan veten Hafiz Gjoka, Fishta u përgjigj: Gjokë, Gjokë sepse e ka mendjen okë, duke nënkuptuar kështu fisnikërinë e tij atdhetare dhe impenjimin intelektual në shërbim të gjuhës shqipe. Dhe nuk ka se si të ishte ndryshe: Hafiz Ali Ulqinaku mori pjesë në dy beteja për mbrojtjen e Ulqinit, shkroi abetare shqipe, përktheu poezi dhe botoi vargje origjinale, hartoi fjalorët shqip-turqisht dhe anasjelltas. E çfarë tjetër pritet sot prej një intelektualit të merituar?

Në vazhdim të anekdotës, rreth 50 vjet më vonë, në varrimin e At

Gjergj Fishtës e merr fjalën një Hafiz relativisht i ri, Hafiz Ali Kraja (ose Tari). Po shënoj vetëm disa prej fjalëve të tij pa shtuar asnjë koment: “Vepra jote, o poet,- deklaroi në ligjëratën e vet Hafiz Ali Kraja (ose Tari),- ka për të formue një faqe të shkëlqyeshme në historinë politike të Kombit. Të jesh i bindur, o poet, se shqiptari me “Lahutën e Malcis” ka për të qenë gjithmonë kryelartë, siç janë grekët me “Iliadën” e persianët me “Shahnamenë”. Sot djelmnia intelektuale me Lahutën tande në dorë, të nep besën shqiptare, tue u betue se idealin tand të naltë, që shpreh për kombësinë shqiptare, do ta ruajë dhe do ta mbrojë si gja të shenjtë morale”¹. Prandaj materialet e Konferencës Shkencore, që sot i kemi të botuara, plotësojnë, nga njëra ana, informacionin e munguar për shkak të disa qëndrimeve të panatyrshme shtetërore antifetare dhe, nga ana tjetër, zëvendësojnë informacionin e keqinterpretuar për shkak të fanatizmit ekstremist apo të laicizmit ekstremist.

Më lejoni të ndalen shkurtimisht, gjithmonë sipas këndvështrimit tim, te dy ekstremitetet: fanatik dhe laicist. Në parantezë duhet të shtoj se, kur shteti i kundërvilhej fesë si botëkuptim, shkatërronte institucionet e saj dhe persekutonte egërsisht klerikët dhe këdo që guxonte të shfaqej sado pjesërisht njeri që beson, ekstremitetet (fanatik-laik) rrafshohen ose nuk ekzistojnë. Por, kur feja është e lirë, si ka ndodhur te ne qysh në fillim të viteve '90, fanatizmi, jo vetëm në ekstremet e veta, është pothuajse po aq i papranueshëm sa çdo kundërvënie institucionale ndaj fesë, ndaj objekteve të kultit, klerikëve dhe besimtarëve. Me këtë dua të them se të

gjithë ata prijës myslimanë, që hapën shkolla për mësimin e shqipes, hartuan dhe botuan abetare, gramatika e libra shkollore etj., nuk ishin fetarë fanatikë, aq më pak, ekstremistë. Po ashtu të gjithë ata shqiptarë që vendosën që në krye të herës të kishin një shtet laik, nuk do të thotë se ishin domosdoshmërisht laikë në jetën e tyre private e aq më pak laikë ekstremistë a antifetarë.

Vlerë e veçantë e emëruesit të përbashkët (*identiteti kombëtar shqiptar*) të religjioneve, është pikërisht harmonia fetare ndër shqiptarë. Dhe kjo del nga fryma e përgjithshme e materialeve që botohen, si dhe nga kumtesa të veçanta që përfshihen në kapitullin: *Toleranca fetare dhe liria e fesë*. Unë do të doja të shtoja se kjo vlerë unike, me të cilën mburren sot politikanët shqiptarë, është e lidhur pikërisht me punën në vazhdimësi të prijësve myslimanë (pa përjashtuar edhe ata të besimeve të tjerë) që luftuan për Atdhe e Fe.²

Duke përfunduar shtroj pyetjen: Përse studime të tilla dhe botimi i tyre është i rëndësishëm te ne edhe në fazën e tanishme? Sepse kur mësonim Naim Frashërin, p.sh., bektashizmin e tij e reduktonim në panteizëm, ndërsa patriotizmin e flaktë të Fishtës e shpërfillshim si nacionalizëm a shovinizëm në dëm të fqinjëve. Vlera universale si bektashizmi a filozofia e Shën Francekut të Asizit, kur janë vërtetë vlera e jo ekstremitete, nuk i bien ndesh zhvillimeve bashkëkohore, përkundrazi u shërbejnë, madje edhe shumë.

2. Kontributi i prijësve mysliman për gjuhën shqipe -kapitulli III, Roli i dijetarëve fetarë në lëvizjen kombëtare shqiptare – kapitulli I, Feja dhe atdheu – kapitulli II dhe Kontributi i dijetarëve mysliman në mbrojtje të trojeve shqiptare - kapitulli V.

1. 100 personalitete shqiptare të kulturës islame, shek. XIX-XX, botim II, Tiranë 2013, f. 29.

Abstracts in English

Editorial

1. *Long life to “Zani i Naltë” magazine*

Besnik Mustafaj

Abstract

“Zani i Naltë” a scientific and cultural magazine, a publication of the Albanian Muslim Community, had at the end of this autumn its 90-th anniversary of foundation... Like “Hylli i Dritës” and many other good things made by the fathers of Albania independence, with the goal of accompanying and taking care of mental and spiritual recovery of the Albanian nation, “Zani i Naltë” experienced its own tragedy for more than half a century because of the fascist regime, and later, of the communist one. But it did not die, because good and fair things in which are embodied the consciousness and dream for peace and prosperity of the nation, never die. Since its birth, this magazine was defined as the scaffold for the Islamic science, sociology, psychology, literature, history, morality and national literature. It comes out regenerated, with exactly the same sublime aim.

Islamic Sciences

2. *Qur’anic letters and their pronunciation*

M.A. Elton Karaj

Abstract

Tajwid is the science that deals and analyzes in details the reading of Qur’an, the Holy Book letters. It is one of the most deeply analyzed and elaborated sciences over the centuries, due to its importance. The reading of Qur’an is one of the fundamental aspects of a Muslim worship and furthermore, it is a worship act in itself. By this viewpoint, believers have shown a great attention in the theoretical studies and for the practical application of the knowledge that tajwid science offers.

3. *“We will reveal to you (Muhammed) a ponderous (high) word”*

Prof. Dr. Ahmed Abbadi

President of Mohammedan Scholars League, Morocco

Abstract

The verse: “We will reveal to you (Muhammed) a ponderous (high) word,” contains an important concept that is the concept of settlement and establishment (revelation)...

It was revealed to the Messenger of Allah, and through him, being communicated and interpreted to the other people. This message was revealed by Allah's help through the passing of this ponderous word to the honoured Prophet (a.s), and through him to the other worlds, and by means of the transmission of this ponderous word through the Prophet's own being, which caused him tremendous sufferings. Thus, through numerous examples we have managed to express our multidimensional definitions, being able to accept and hear the clarity of the word's burden of this ponderous message, embodied in the personality of the honored Prophet.

Studies

4. The contribution of the Albanian Ulama of Macedonia in the Albanian language and education

Prof. Dr. Avzi Mustafa

Abstract

During all the course of events that determine the fate of Albania and Albanians throughout history, no doubt, the Albanian Ulamas in the today's Macedonian territory deserve a respectable place, which should take place in the annals of history, and which is an important part of the Albanian people contribution and glory.

In different circumstances, the Albanian ulema, that in the majority of cases were also teachers in schools of different categories, were distinguished for a dignitous stance, they never allowed the religion become an obstacle in our people's progress. They understood very well the hadith of our Prophet, which they repeated in every circumstance, in both languages Arabic and Albanian: "Hubul vatan min el iman" (Love for the country comes from faith). Especially the Renaissance period, which was also an enlightenment movement, aimed at raising national awareness, and influenced religion not hinder, but rather to put itself in service of the nation.

5. Use of personal Muslim names in Albania: comparison of three historical periods

Ilir Akshija, M.D., M.Sc.

University Hospital Center, Tirana

Abstract

Evidence indicates the relationship between names and religious affiliation, especially in the elder portion of the Albanian population. This assumption is supported from studies who analyze the frequency of religious provenience names and their geographical spread. In this study, we built a net of data from admissions at the largest Albanian hospital, split in three historical periods and analyzed the evolution of personal Muslim names use. The fortunate characteristic of Albania is that represents the point of encounter for three religious categories, Muslims, Christian Catholics and Christian Orthodox. What happened and the trend of using Muslim names in the Albanian population is discussed taking in consideration three, well distinguished, historical periods; 1904-1945, 1946-1991 and 1991-2011.

Language and Literature

6. *Perpetuation of Nezim Berati between his Albanian Divan*

Assoc. Prof. Dr. Rahim Ombashi

Faculty of Humanities, Hëna e Plotë - Beder University, Tirana

Abstract

Mass acceptance of Islam by the Albanians does not represent a betrayal to fellow or Christian neighbors, is justified as a political imperative, not only, a call taken to reinforce their particular identity. Sociology of religion reveals Ottoman heritage in Albania created and maintained a significant Islamic spiritual culture, which included extensive penetration of Sufism and Albanian Muslim consciousness, which continues to be a strong element of Islamic culture in the Balkans. Islamology general influenced the poetic works of alamiadist Nezim Frakulla with themes, ideas, thoughts, philosophy, morality, ethics, to which convergence. His religious consciousness raised linguistic consciousness, enlightenment, political, social, aiming was like Rumi ... With quantum resonance method his albanian divan indicates discursive interactions in philosophy, events, findings poetic, proverbs, messages go from the outside world of the interior, which means it Sunni official religious lines to overtly mystical Sufi views, with a trend in the domestic foreign trust, and mysticism, esoteric religious faith stands as Islamic poetry, which is built on foreign vocabulary. Nezim knew to observationing, had thrifty imagination, dexterity processing, assimilating the object of turning homeland in poetry, ditiramb Albanian song miss Berat, Albania, because it feels musical interpretation of words between the social communication. With the right T. S. Eliot states that no art is more national than poetry.

Key words: identity, sociology of religion, sufism, alamiado, divan.

7. *Said Najdeni and the early periods of the Albanian education in Dibër*

Mois Kamberi, Durrës

Abstract

As in many regions of Albania, at the end of the XIX century and in the early XX century, the educational and cultural movement in Dibër took larger proportions, turning Dibër into a determinant territory of the Albanian education widespread in northeastern Albania and in other Albanian provinces.

The prevalence of Albanian schools, the Albanian language learning, the distribution of the Albanian books and newspapers in Dibër and its highlands on the eve of the Ottoman constitution and even after this period, was obvious. The educational and cultural movement in Dibër had reached a high degree, which led to the creation of a social stratum of educated and aware people, who would become the main support for the Albanian National Movement program's implementation.

8. *The Albanian clergymen contribution for the Albanian school, language and writing*

Xhemal Balla

Abstract

The Albanian clergymen, without religion and regional distinction, along to the other Rennaisants, have had a powerful contribution in the entire Albanian people progress towards the freedom and indipendence. They stood close to the people during all their difficulties. When needed, their embraced the weapons during the age-long wars against the Slavic occupators and pashas injustices, and furthermore, they were elected in charge of the new Albanian state, by guiding the Albanian Union of Prizren, the National Assembly of Vlora, the New Albanian State Senate established by Lushnja Government etc, but at the same time, they were closer to the Albanian people in field of education and teaching process of the new generations.

Clergymen gave a valuable contribution in the Albanian language cultivation through several aspects:

1. Through the libraries established inside the educational institutions or in their proper houses.
2. Through the lessons in open schools at most of cities and villages.
3. Through books publishing for schools account, among which primers and gramatic books for the Albanian language learning.

Our Islam culture personalities, even in this difficult sphere gave their precious contribute where we can state names such as: *Hasan Vogli, Hafiz Ali Ulqinaku, Hafiz Ali Korca, Hafiz Ibrahim Dalliu*, and to the youngest scholars such as *Imam Vebbi Ismaili, Haxhi Vebbi Gavoçi etc.*

Islamic Law

9. *The freedom inside the Islamic political system*

M.A. Redi Shehu

Abstract

When we compare two systems of government, we do this by taking into consideration the principial methods of their functioning, and do not undertake bringing into the light of comparison the distortions that have occurred throughout the history of governments. If we had to get into this impasse, we would have to analyze all dysfunctional democracies in the world today. So, such a comparison doesn't deal with abnormalities, but focuses in the source and principles on which are built the governing concepts of both types.

Communication Science

10. Communication through the Islamic objects of worship Metaphysical and verbal communication (Part two)

M.A. Ferit Lika, (Albanian Muslim Community)

Abstract

The Muslim intellectual, along with the essential knowledge of Islam and the global views of Islam, along with his combined essential elements, should know that communication and physiognomy of Islam, is dedicated at a broad scale to the cult objects, from where its message has been transmitted and still continues to transmit. According to the well-known Belgian researcher Titus Burchardt, the study of Islamic arts (including architecture), or whatever other sacred art, can lead to a broader meaning of the deep spiritual realities that lie at the root of an entire human and cosmic world.

Personalities

11. Daut Boriçi – An outstanding personality of history, culture and education in Albania

Prof. dr. Njazi Kazazi

University of Shkodra “Luigj Gurakuqi”, Department of Linguistics

Abstract

Notable figures who have left their traces in our nation's history, will always be recalled with deep respect and gratitude. In recent years they are being more outstanding, re-dimensioned and are taking the place they deserve. This also happened with Daut Efendi Boriçi (1825-1896), a “Honorable Teacher”, who at his 100-th anniversary of death, was remembered through a scientific activity and through an 88-page edition, published by Shkodra's Historical Museum.

Translations

12. “THE ISLAMIC SWORD” – Are you still in doubt that Islam has been propagated by sword? Read and you will believe!

Abstract

Compared with the other part of the ancient global population, Arabs made a very small minority. A small number of this minority decided to send the “Sword” outside the Arabic desert borders, to the powerful Persian and Roman Empires, to the Mediterranean shores and the Malabar coast and further, in East Indies Islands. All nations one by one surrendered to this “Sword”. It simply acquired the hearts, while the bodies were surrendered automatically.

This is the “Sword” of the Truth, which brightness cancels the lie, exactly like the light cancels the darkness.

Retrospective

13. “Zani i Naltë” – A magazine of orientation towards the reforms and social progress

Adem Bala

Abstract

The publishing of the “Zani i Naltë” magazine has been an notable event, an expression and sign of civilization.

“Zani i Naltë” magazine, was born when the uncertainties were still present, where the war and the progress didn’t occurred on a soft ground, where appeared a number of currents, in which there fleshed real and couragous values for that time, which stimulated the progress based upon the most active values of the Islamic and the Albanian thinking.

“Zani i Naltë” delivered those suitable and selected values for the Albanian people psychology, morality and ideals. By means of the wide and polemical information, the magazine fastened of the steps towards the progress. So “Zani i Naltë” became a meeting point, a door and a wide field on a path that brought towards the progress.

Activities

14. “The Muslim leaders’ contribution in the formation of national consciousness and identity”

Prof. As. Dr. Gentiana Skura – Tirana University

Abstract

This publication we today have the honor to promote, entitled “The Muslim leaders’ contribution in the formation of national consciousness and identity”, is a comprehensive reflection about the Muslim scholars and clergymen help and contribution on the Albanianism and Albanian nation’s progress. This publication is based on the scientific conference papers by the same title, held a year ago.

15. Two words about a particular scientific publication

Dr. Tonin Çobani

National Council of Radio and Television, Tirana

Abstract

The publication of the Scientific Conference materials on “The Muslim leaders’ contribution in the formation of national consciousness and identity” (Tirana, 28-29 September 2012), is an important cultural event, because it aims to put in a common denominator the activities of a nation whose religions are not unified with the state that celebrates its 100-th anniversary. With the concept “common denominator”, I understand the Albanian national identity of the three main religions: Muslims, Catholics and Orthodox.

Rregullat e shkrimit

Artikulli duhet të prezantojë një punë studimore, kërkimore, shkencore dhe të evidentojë elementë të qartë të origjinalitetit.

Çdo shkrim duhet të ketë një strukturë, që duhet të përmbajë në mënyrë të detyrueshme elementët e mëposhtëm:

1. Titulli i artikullit të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë koncize dhe të përmbledhur. Titulli të mos jetë më i gjatë se 35 karaktere.

2. Të vendoset emri i autorit me titujt shkencorë përkatës dhe poshtë emrit të jepet pozicioni zyrtar i tij/saj.

3. Poshtë këtyre, në krye të shkrimit me një paragraf të veçantë mund të jepet një abstrakt i shkurtër, duke radhitur të gjitha nënçështjet.

4. Artikulli duhet të jetë i strukturuar me disa nënçështje në varësi të tematikës që shtron.

5. Nënçështja e parë e çdo artikulli duhet të jetë “Hyrja”, në të cilën të jepet qëllimi dhe objektivat, që e kanë shtyrë autorin për të shkruar artikullin dhe rëndësia e botimit të tij.

6. Të gjithë titujt e nënçështjeve të jenë me “Bold” dhe shkrim “Italik”, “Times New Roman 12”. Datat të shkruhen sipas modelit: Data – Muaji – Viti, titujt e nënçështjeve do të paraprihen nga numrat 1, 2, 3, etj.

7. Në fund të artikullit duhet të vendoset një nënçështje e posaçme me titull: Sugjerimet apo Konkluzionet.

8. Çdo artikull duhet të ketë të evidentuar edhe Bibliografinë. Çdo artikull duhet të ketë të paktën 10 referenca dhe vepra.

9. Çdo artikull duhet të ketë footnote-a dhe referenca për çdo material dhe autor që ka studiuar dhe referuar duhet vendosur në formë citati, në thonjëza, shprehjet e marra ekzaktësisht nga materialet e tjera të botuara më parë.

10. Footnote-a duhet të shkruhet me shkrim “Times New Roman 10” dhe të përmbajë: autorin, titullin e veprës, shtëpinë botuese, datën dhe vendin e botimit, faqen nga është marrë citati.

11. Nëse autori është konsultuar me një site interneti duhet të shënohet edhe data e aksesueshmërisë: p.sh. akses më 10 Maj 2008. Në fund të footnote-s vendoset pikë dhe footnote-a jepet me «Justify».

12. Artikulli duhet të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 15 faqe kompjuterike.

13. Shkrimi i artikullit duhet të jetë “Times New Roman” me “Spacio 1” dhe i gjithë teksti të jetë “Justified”. Artikulli duhet të respektojë elementët gramatikorë dhe gjuhësorë dhe të jetë i shkruar me “ë” dhe “ç”.